




**"PËR NJË
QEVERISJE TË MIRË VENDORE,
SIKUR TË ISHA KRYETAR BASHKIE..."**



SHOQATA E BASHKIVE TE SHQIPERISE



**“PËR NJË
QEVERISJE TË MIRË VENDORE,
SIKUR TË ISHA KRYETAR BASHKIE...”**

HYRJE

O, si nuk kam një grusht të fuqishëm! -shpërthen Migjeni tek "Recitali i Malcorit".

Ah sikur ... - shpërthejnë njerëzit në momente dhe situata të ndryshme kur vërejnë se diçka nuk shkon dhe se shumë gjëra mund të rregullohen dhe përmirësohen për të patur një qytet më të pastër, për më shumë parqe, shkolla, lulishte, fusha lojrash dhe për të krijuar një harmoni të qytetarëve me ambjentin.

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë ka inkurajuar gjithmonë forma të pjesëmarrjes qytetare në bashkitë shqiptare për të rritur kontributin e individëve në qeverisjen vendore dhe për të përmirësuar përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e këtyre organeve ndaj qytetarëve.

Për të dëgjuar se çfarë thonë të rinjtë dhe për ta përcjellë këtë zë pranë qeverisjes vendore, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë me mbështetjen e NDI (National Democratic Institute) dhe në bashkëpunim me Znj. Orsiola Kurti organizoi projektin "Për një Qeverisje të Mirë Vendore, Sikur të Isha Kryetar Bashkie...". Ky projekt u zhvillua në periudhën para zgjedhjeve vendore si një kohë e përshtatshme për të nxitur pjesëmarrjen dhe angazhimin e të rinjve në qeverisjen vendore.

Projekti pati si qëllim njohjen e të rinjve me qeverisjen vendore, me specifikat e saj dhe për të bërë sado pak dallimin midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore, kryetarit të Bashkisë dhe këshillit bashkiak. Projekti "Për një Qeverisje të Mirë Vendore, Sikur të Isha Kryetar Bashkie...", i cili pati në qendër të vet konkursin e eseve me të njëjtën temë, synoi gjithashtu promovimin e ideve të të rinjve në lidhje me probleme të ndryshme të qeverisjes vendore dhe se çfarë ndryshimesh mund të ndërmerren për të ofruar shërbime sa më cilësore duke qenë më pranë qytetarëve, veçanërisht nevojave, kërkesave dhe prioriteteve të tyre.

Ka shumë mënyra për të udhëhequr -thotë Rudolph Juliani në librin e tij "Udhëheqja", por çdo udhëheqës gjykohet nga qytetarët e tij. Në këtë rast roli i kryetarëve të bashkive është gjykuar nga të rinjtë si qytetarë të bashkive në kushtet e një shoqërie demokratike pjesëmarrëse vendore.

Pozicionimi i të rinjve në këpucët e një kryetari bashkie i vendosi ata përpara përgjegjësisë për të menduar në mënyrë kritike mbi qeverisjen vendore dhe problemet që duhen zgjidhur në çdo komunitet vendor.

Shoqata e Bashkive i është mirënjohëse së pari të gjithë të rinjve që morrën pjesë në këtë projekt. Ata kontribuan përmes shkrimit të eseve të tyre duke dhënë mendime të vëra, që mund t'u vijnë në ndihmë kryetarëve të bashkive shqiptare dhe mund të gjejnë zbatim të mundshëm në praktikë. Gjithashtu falenderojmë të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues për gjykimin e tyre dhe një falenderim i shkon gjithashtu edhe Znj. Orsiola Kurti për koordinimin e projektit.

Fatos HODAJ

Drejtor Ekzekutiv i SHBSH-së

FILLIMI

1.

Thonë se politika ka nevojë për njerëz të cilët njohin mirë artin e mashtrimit, dekonspirimit dhe demoralizimit të elitave, bërthamave centrorë të fushave jetike të një shoqërie.

Thonë se pushteti “drejtohet” mirë kur ka në krye njerëz të cilët dita-ditës fitojnë parazitisht dhe arbitrarisht duke “vetëprojektuar” kulla pasurore, standarte të larta jetese, duke “legalizuar” në favore të tyre prona të pafundme hapësinore, duke injoruar padrejtësisht trashëgiminë familjare, duke shpërbërë në njësi më të vogla e të papërfillshme reaktantët elitarë ku nga bashkëveprimi i tyre do të kishte natyrisht produkte të tjera e të ndryshme nga këto të sotmet.

Thonë se risia më e frytshme, fati më i madh në jetë është të bëhesh politikan, sepse thonë se nëpërmjet këtij profesioni siguron komponentë të lartë jetese, të cilët të detyrojnë automatikisht t'i nënshtrohesh “presionit” kulturor të shtresës së lartë.

Kështu do të vazhdojnë të thonë, të mendojnë e të shpresojnë për aq kohë sa ne të vazhdojmë të jetojmë në “integritetin” e këtyre pseudopolitikanëve, të cilët nuk bëjnë gjë tjetër veçse i ngjasojnë çdo ditë e më shumë popujve të Zullullandit, jo nga “injanca” por nga impotenca politike, nga mungesa e aftësive për të drejtuar dhe nga padëshira për të ndërtuar një histori serioze politike, jo duke u shndërruar në “gaztorët” e kancelerive të huaja, jo për t'i atribuar këtij populli damkën e njerëzve të paintegritet, sepse ne meritojmë më shumë, “ata” meritojnë më pak sepse nuk janë gjë tjetër veçse amatorët më të këqinj të politikave të mëparshme.

Fatkeqësisht jetojmë me moton e tyre shterpë: ha, merr dhe mos ik”

Çfarë pretendojnë këta pseudopolitikanë se politika është burimi më i pastër për të ndërtuar kapitale gjithmonë e më shumë progresiste për të ardhmen e familjarëve të tyre?

Pretendojnë se të merresh me politikë do të thotë të ecësh me forcat e punën e të tjerëve, të pështysh në rrugën e “të marrëve” të cilët ecin somnambul në një drejtim që shihen veçse frëngjij shpresash e fatësh, sepse na vjen keq ta pranojmë por jeni ju “të nderuar” pseudopolitikanë që i keni bërë këta të “marrë” të besojnë se janë të pafuqishëm t'ju luajnë prej istikamit të pushtetit, prej perandorisë së ideve inovatore.

Politika nuk është një silogjizëm, të cilin ju duhet ta privatizoni medoemos , e ju nuk jeni “pajisje” të pariparueshme të këtij mekanizmi të gjallë e aktiv siç është pushteti dhe politika.

Ju nuk jeni “mikroçipat” e vetëm të këtij mekanizmi, sepse nëse do të ishte kështu, bota do të kishte marrë fund.

Ky organizëm jetik (politika) ka nevojë të sintetizojë elemente e ide të reja, projekte bashkëkohore, “burra” të vërtetë shteti, të cilët të ndërmarrin iniciativa serioze, t frytshme dhe të efektshme.

Politika është një mision i domosdoshëm për të bashkërenduar veprimtarinë shoqërore, për t'i dhënë asaj një hartë orientuese dhe për ta integruar në reaksionet e vrullshme europiane.

Nuk është politika “misioni” apo qëllimi në vetvete për të shpërdoruar besimin, të drejtën e votës, respektin dhe dëshirën e kësaj shoqërie.

Nuk është politikë pezullimi i çështjeve kombëtare për të luajtur “kush bën poza më të bukura” në parlament.

Nuk është politikë mohimi i rotacionit politik, hedhja baltë mbi arritjet evidente, sofistikimi i të bërit korrupsion dhe zhdërvjelltësimi në trampolinën e mashtrimeve.

Vizioni i një politikani nuk mund të matet me qëndrimet apo dëshirat e një elektorati të thjeshtë, dekorimi i platformave nuk mbushet me premtimet e vdekura tashmë, fjalimet politike nuk vlejnë më nëse kthehen në objekte që nuk i shërbejnë standartizimit të komunitetit.

Kreu i shoqërisë civile në një qytet është një politikan dhe si i tillë mendohet të jetë hallka lidhëse në zinxhirin e gjatë politik midis qytetarit, kërkesave të tij, objektivave dhe projekteve të qeverisë.

Deri më sot kemi menduar e kemi ecur nën slloganin “rotacionin mos e prano” dhe kjo i ka bërë dëm shëndetit shoqëror, sepse diagnoza politike e përcaktuar në raste të tilla vetëm sa i ka dhënë frymë dhe jetë ca orë e ditë më shumë shoqërisë, por nuk i ka siguruar kurrë jetëgjatësi në standart, integrim dhe progres.

Ndaj është koha dhe momenti që duhet të ndryshojmë dhe ndryshimi vjen nga idetë, nga kapacitetet elitare, vjen nga aftësia për të pranuar faktin se kjo shoqëri nuk është në legjitimitetin tënd të përjetshëm, se kjo shoqëri evoluon, rritet, kërkon të “ushqehet” më mirë. Janë ndryshimet fiziologjike të kohës që e kërkojnë këtë sepse kjo shoqëri duhet të motivohet, stimulohet, duhet orientuar dhe drejtuar sepse në rast të kundërt të dënon historia dhe breznia.

Në detyrën e një Kryetari Bashkie çelësi i çdo suksesi qëndron në profesionalizmin e stafit të tij dhe kjo nënkupton jo në radhitjen në bazë fuqie e ndikimi elektorat, por në bazë meritokracie dhe përmbushje kriteresh.

Është logjike të pranohen veprimtarët apo bashkëbiseduesit e një force të caktuar politike por jo të bastardohen dhe të kompromentohen deri në atë pikë sa të “Zylo” e “Zylarë”, në zyrat shtetërore të një administrate që duhet të meritojë respektin e qytetarëve.

Profesionalizmi i punës, përbërja e një stafi bashkëkohor dhe të aftë është një ndër “nenet” në strategjinë e një Kreu Bashkie.

Puna e tij nuk do të jetë solo dhe si e tillë duhet të ketë përqendrimin dhe motivimin maksimal prej bashkëpunëtorëve të tij.

Përsa i përket organizimit civil, duhet t'i drejtohet shumë fushave, duke filluar nga shërbimet publike, ku si objektiv kryesor të jetë forcimi dhe vënia e kapaciteteve menaxhuese të bashkisë.

- Urbanizimi i lagjeve në brendësi, për të krijuar kushte të përshtatshme për përmirësimin e nivelit të jetesës, për tu dhënë fund rrugëve të “lodhura” prej

pluhurit e baltës.

- Rehabilitimi i trotuareve të qytetit duke i pajisur në mënyrë uniforme me ndriçim dhe mundësisht me vendosjen e ndonjë veprë arti.
- Forcimi i ndriçimit mbi monumentet historiko-kulturore dhe institucionet e qytetit.
- Rehabilitimi i zyrave shtetërore në mënyrë të tillë që punonjësi të ndjejë rëndësinë e të qenurit administratë, pajisja e tyre me mjete elektronike për të mos e lodhur zyrtarin me metoda të vështira dhe jo bashkëkohore.
- Sjellja në normalitet e institucioneve kryesore, të cilat qytetari i viziton shpesh, vendosja e tabelave me emërtimet përkatëse të çdo institucioni duke i dhënë fund epokës së anonimatit institucional.
- Të ndryshojë metoda e pastrimit të qytetit, të shihen mundësitë e shtimit të firmave të pastrimit me qëllim rritjen e konkurrencës dhe cilësisë së pastrimit.
- Të synohet që në qytet të ketë përparësi mbjellja e drurëve të lartë e me kurorë të madhe për të zbutur efektet negative që vijnë nga shtimi i trafikut, por edhe kundër rrezatimit diellor gjate stinës së verës.
- Të ndërtohen tualete publike pranë lulishteve dhe zonave muzeale që njerëzit të mos ndotin me duart e tyre mjedisin e gjelbërt.

2. Mbrojtja e territorit dhe urbanizimi brenda kornizave administruese të Bashkisë

- Transparencë në dhënien e lejeve të ndërtimit.
- Dhënia e mundësisë qytetarit për të qenë pjesëtar në mbledhjet e KRT-së.
- Vrojtimi i çdo dosjeje me profesionalizëm e korrektësi, për të mos shkaktuar padrejtësi dhe efekte negative sociale.
- Të këmbëngulet që çdo projekt i paraqitur për leje ndërtimi të ketë të përfshirë daljet e emergjencës, hidrantet e ujit, parkimet e domosdoshme, gjelbërimin dhe trotuarët rreth tyre.
- Të fillohet gradualisht me prishjen e mureve rrethues prej betoni që u marrin frymën banesave nëpër lagjet e qytetit duke i dhënë fund getozimit.

3. Përmirësimi i kushteve të tregtimit.

- Për tregtimin e bagëtive dhe të shpendëve të caktohet një vend në periferi të qytetit.
- Duke qenë një qytet port dhe bregdetar, të ndërtohet një merkato e madhe peshku, për të garantuar pastërti e cilësi në shërbimin ndaj qytetarit.
- Të gjitha tregjet e qytetit të kompletohen me kushte duke krijuar dy qendra të mëdha tregu, secila me ambjente të përshtatshme për të zhvilluar një tregti normale të produkteve bujqësore dhe blegtorale.

- Të synohet që në këtë qytet të vijojnë panairt e larmishme të rrushit dhe të produkteve të tij.
- Të këmbëngulet në ndërtimin e një thertoreje moderne për të ndaluar përfundimisht therjen dhe tregtimin e mishit në kushte të papërshtatshme.

4. Sistemi i kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza.

- Të synohet ndërtimi i impiantit të pastrimit të ujërave të zeza dhe vënia në punë e rrjetit të kanalizimeve.
- Të kompletohen të gjitha pusetat e rrugëve dhe trotuareve me kapakët atje ku mungojnë dhe të merren masa për sigurimin e kapakëve me çelësa të posaçëm.

5. Problemet sociale, arsimi dhe shëndetësia.

- Të synohet në ndërtimin e shkollave të reja për të plotësuar kërkesat e qytetarëve por edhe për të përmirësuar kushtet në shkollat ekzistuese, vendosjen e një numri normal të nxënësve në klasa.
- Të sigurohen financime për ndërtimin e kopshteve, përmirësime në kushtet e nevojshme që fëmijët të kalojnë orë të këndshme.
- Të stimulohen nxënësit me rezultate të shkëlqyera, fitues të olimpiadave dhe talente në fusha të ndryshme të artit, sportit dhe kulturës.
- Të zhvillohen diskutime të vazhdueshme midis Kreut të Bashkisë dhe të rinjve të qytetit për tu informuar rreth gjërave që kanë nevojë për përmirësim.
- Të nxitën të rinjtë nëpërmjet fushatave të ndryshme rinore, të cilat të kenë për qëllim një aktivitet më të pasur rinor, debate publike apo edhe seminare për problemet kombëtare dhe botërore.
- Bashkëpunimi i Bashkisë me qendrat shëndetësore për përmirësimin e kushteve.
- Ndërtimi apo ngritja e një qendre mjekësore ditore për të gjithë pensionistët për të kryer shërbime të thjeshta mjekësore, me një çmim më të ulët. Kjo qendër të financohet nga donatorë të huaj në kuadrin e bashkëpunimeve që mund të vendosë Bashkia me ta.
- Stimulim dhe hapja e vendeve të punës për të gjithë të rinjtë e infermierisë që do të punojnë në këto qendra.
- Përsa i përket sektorit të Shërbimeve Sociale të fillohet që me ndërtimin e stafit me profesionistë të fushës përkatëse.
- Ndërtimi i një qendre rehabilituese për të sëmurë invalidë dhe për personat me aftësi të kufizuar duke ofruar shërbime shëndetësore dhe integruese duke krijuar vende pune për psikologë dhe sociologë.
- Lidhja me donatorë ose investues vendorë për të dhënë në mënyrë periodike ndihma në ushqime ose në vlerë monetare familjeve me një nivel minimal jetese e të ardhurash.

- Bashkëpunim me investues të huaj që nëpërmjet financimeve dhe projekteve në kuadrin e nxitjes për punësim të hapen vende të reja pune duke lejuar apo nxitur ndërtimin e fabrikave, uzinave.
- Në disa prej bareve të qytetit të ndërmerret një iniciativë e re për të gjithë të moshuarit, pensionistët: ofrimi i kafes me gjysëm çmimi gjatë gjithë ditës dhe furnizimi i këtyre bareve më të përditshmet mediatike.

6. Kultura, arti dhe sporti.

- Do të synohet në ndërtimin e një kinemaje bashkëkohore për të gjithë qytetarët.
- Gjatë verës, të ngrihet një kinema verore në një vend pranë buzës së detit duke lokalizuar aty një mini bar restorant që komuniteti të shijojë freskinë e natyrës nëpërmjet larmishmërisë së aktiviteteve.
- Të konsolidohen Festalet për fëmijë, i Polifonisë, panairi i librit, takimet kombëtare të humorit.
- Të organizohen festivale rinore dhe për fituesit të sigurohet vajtja automatike në festalet rinore kombëtare.
- Do të mbështeten të gjithë krijuesit e rinj duke krijuar minikonkurse në shkallë rrethi për të nxjerrë në pah vlerat letrare, artistike.
- Zhvillimi i turneve të vazhdueshme të Trupës së Teatrit të qytetit, për të shkëmbyer eksperiencën dhe për të mos lënë në errësi artistike qytetin.
- Do të synojmë në vlerësimin e figurave të shquara.
- Të mbështeten orkestra frymore dhe orkestra simfonike e qytetit për t'i dhënë më shumë jetë evenimenteve festive.
- Të sigurohet mbështetje e nevojshme financiare duke tërhequr biznesin e gjithë qytetit në ndihmë të futbollit.
- Të punohet më shumë për mbështetjen e ekipeve zinxhir të futbollit të moshave, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së nxjerrjes së talentëve të reja.
- Përmirësimi dhe ndërtimi i terreneve të reja sportive.

7. Transporti publik.

- Kompletimi me semaforë e tabela orientuese në sistemin e sinjalistikës rrugore.
- Të përcaktohen në mënyrë definitive vendqëndrimi i taksive dhe autobuzëve.
- Të punojmë në uljen e minutazhit të qëndrimit të qytetarëve në stacionet e autobuzit duke përlogaritur më drejt lëvizjen e tyre.
- Të ndryshojë pajisja e qytetarëve me bileta urbane duke i shitur ato në stacionet e autobuzave.

8. Sektori i dekorit.

- Pranë sektorit të dekorit në Bashki të punësohet një piktor i arsimuar dhe me vizion, ku do të parashtrihen ide konkrete për paraqitjen e qytetit.
- Përpara çeljes së sezonit turistik të gjitha godinat përgjate rrugëve kryesore të riparohen dhe lyhen një herë në dy –tre vjet, sipas shijeve të qyteteve bregdetare turistike.
- Do të rishikohen vetëvendosjet e reklamave në qytet, ku nuk do të lejohet asnjë reklamë duhani përpara shkollave dhe kopshteve si dhe mbi tarracat e pallateve.
- Do të synohet që gjatë festave të fundvitit qyteti i Vlorës të vezullojë nga ndriçimi dekorativ dhe joshës, i ngjashëm me qytetet e tjera evropiane.

9. Masa konkrete në funksion të sezonit turistik.

- Paketa turistike e Vlorës do tu shpërndahet agjensive të huaja turistike me qëllim njohjen me resurset e qytetit dhe tërheqjen e turistëve përmes këtyre agjensive.
- Do të prodhohen harta me adresat e rrugëve, restoranteve, hoteleve, plazheve dhe objekteve kulturore-arkeologjike dhe historike të qytetit në shërbim të turistëve.
- Çelja e sezonit turistik do të konceptohet si një festë mbarëpopullore.
- Do të bashkëpunohet për prodhimin e materialeve promovuese për turizmin dhe shpërndarjen e tyre në çdo eveniment turistik brenda dhe jashtë vendit.
- Do të përsoset higjiena dhe pastërtia në plazhet publike të qytetit duke shtuar koshat e mbeturinave dhe tualetet tip kabine.
- Në plazhin e vjetër do të ngrihet një qendër shëndetësore në afërsi të ish-Kampit të Pionerëve me qëllim ardhjen në ndihmë të pushuesve dhe banorëve të zonës.
- Do të krijohen njësitë e emergjencave civile gjatë sezonit turistik dhe kulla vrojtimi, të cilat do të kenë në dispozicion mjete lundruese për të shpëtuar jetë njerëzish që rrezikojnë mbytjen në det.
- Në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë do të organizohen vizita me përfaqësuesit e hoteleve dhe restoranteve të qytetit në qytetet turistike të detit Adriatik dhe Jon për thithjen e përvojës së shërbimit dhe nxitjen e aplikimit të çmimeve brenda llogjikës konkurruese rajonale.

10. Në politikën e jashtme do të synohet:

- Afirmimi i qytetit të Vlorës në qarqet ndërkombëtare si qytet mesdhetar turistik i virgjër.
- Pjesëmarrja në konferencat ndërkombëtare dhe rajonale për problemet e turizmit, mjedisit dhe zhvillimeve ekonomike.

- Binjakëzimi me qytetet më në zë turistike të Adriatikut dhe Mesdheut në përgjithësi.
- Do të përhapen përmes internetit resurset që ofron qyteti i Vlorës dhe zona përreth në fushën turistike, historike, arkeologjike.
- Do të nxiten operatorët turistik të marrin pjesë në Panairët Ndërkombëtare.

11. Për rritjen e zhvillimit ekonomik të Vlorës.

- Turizmi do të mbetet shtylla kryesore për zhvillimin e Vlorës. Për këtë do të punohet që Vlora të kthehet në një qendër të njohur të turizmit në botë, ku numri i turistëve të vijë duke u rritur.
- Tregtia do të ketë të gjitha hapësirat e nevojshme për zhvillimin e saj duke krijuar të gjitha lehtësitat dhe infrastrukturën. Do të lidhen marrëveshje bashkëpunimi me qytetet e rajonit në fushën e tregtisë pa kufinj në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë.
- Do të mbështetet industria e ndërtimit për të cilën do të krijohen lehtësitat dhe hapësirat për punë dhe investime.
- Do të këmbëngulet në zgjerimin dhe modernizimin e Portit të Vlorës në Skelë dhe atij të Triportit në afërsi të Zvërnecit. Porti i Skelës duhet të kthehet në port turistik të trageteve dhe jahteve në funksion të zhvillimit të transportit detar dhe atij të peshkimit, si një nga portat hyrëse të Korridorit të 8-të.

12. Bashkëpunimi me shoqërinë civile.

- Bashkëpunimi me shoqërinë civile të jetë një zë i rëndësishëm në politikat e bashkisë. Në këtë kuadër të thithet mendimi i shoqërisë civile përmes OJF-ve që operojnë në qytetin e Vlorës, duke u mbështetur në:
- Mbledhjen e bordeve konsultative pranë Kryetarit të Bashkisë çdo 6 muaj.
- Në këto borde të përfshihen intelektualë të njohur të fushave të ndryshme.
- Të shikohet mundësia e mbështetjes financiare të projekteve të OJF-ve në fushën e mjedisit dhe çështjeve sociale.
- Pranë Bashkisë të funksionojë më së miri zyra për Marrëdhëniet me Publikun duke e kthyer këtë institucion në një hartë të rëndësishme orientuese dhe informuese për të gjithë qytetarët, ku ata të gjejnë një zyrë profesioniste, të ndershme dhe të përkushtuar.
- Të gjithë qytetarët të pajisen me nga një kartë vizitori në momentin që hyjnë në këtë institucion duke e kthyer Bashkinë në një vend ku nuk lejohen hyrjet dhe daljet e paautorizuara.
- Punonjësit të kenë një mënyrë të veshuri serioz dhe institucional me kostume.
- Secili prej tyre të jetë i pajisur me kartë identiteti nëpërmjet të cilës të kontrollohet disiplina në orar.

- Të krijohen debate të hapura publike me përfaqësues të shoqërisë civile për të evidentuar dhe përmirësuar arritjet dhe ato që duhet të arrihen nga Bashkia dhe Kreu i saj.
- Testime të herëpashershme të profesionalizmit të stafit bashkiak dhe trajnimet e ndryshme për proges insitucional.
- Për specialistët të hapen konkurse pune ku pas një interviste dhe testimi korrekt të punësohet një person me kushte të domosdoshme dhe të nevojshme për një zyrtar të ditëve të sotme.

Në përfundim të këtyre çështjeve do të nënvizoja urimin tim realisht si një qytetare e thjeshtë, që platformat dhe fjalët plot ngjyra të fushatave elektorale të mos kthehen në misone antike, të vjetëruara, por të ecim me hapin e kohës, kërkesave të saj dhe përpjekjeve tona për të fituar integritetin europian, për të cilin sigurisht që nuk duhet të presim vulën politike.

Sikur të isha Kryetare Bashkie do të vlerësoja të shkuarën do të punoja për të tashmen duke menduar dhe ngritur themelet për një të ardhme më të sigurt.

Secili ka meritën e vet, kush më shumë e kush më pak, por të gjithë kanë ecur në gjurmët e njeri-tjetrit, duke parë vazhdimisht të njëjtën tabelë qitjeje.

Ines Stasa

Vlorë

2.

Sikur të isha kryetar bashkie do të mundohesha të bëja gjithshka është e mundur për qytetin tim. Do të mundohesha të sillesha si një pjesëtar i shoqërisë qytetase dhe si i tillë do të mundohesha të jepja shembullin tim personal. Historia ka treguar që çdo udhëheqës ka arritur majat e suksesit dhe dashurinë e respektin e njerëzve nëpërmjet shembullit personal. Nuk është një rastësi që disa nga udhëheqësit më të mëdhenj kanë dalë nga gjiri i popullit të thjeshtë. Dhe kjo sepse ata ishin dhe janë në gjendje të njohin atë që një qytetar të thjeshtë e shqetëson. Dinë të sillen e të thonë fjalën e mirë. Gjejnë atë fjalë që të tjerët kanë nevojë të dëgjojnë. Gjejnë e bëjnë atë gjë që të tjerët kanë nevojë të shohin e prekin.

Kështu pra, duke u sjellë si një pjesëtar i një grupi dhe duke i dhënë rëndësinë e duhur postit që do të zotëroj, jam i bindur që do të mund të jepja më të mirën nga ana ime. Kjo nuk arrihet për një kohë të shkurtër. Por me pak durim dhe besim nga ana e bashkëqytetarëve të mi do të arrija në konkluzionin e dashur nga të gjithë:

NJË QYTET TË QETË E TË PASTËR KU AMBJENTI RRETHUES DO TË ISHTE I PËRSHTATSHËM PËR TË GJITHË.

Jetojmë në një kohë e në një vend ku “rrota” e historisë po rrotullohet shumë shpejt. Jetojmë në një kohë e në një vend ku mundësitë për të bërë apo krijuar të mira për qytetin dhe për veten tonë janë të mëdha. Jetojmë në një moment ku mund të japim diçka nga vetja jonë. Është një çast kur të gjithë ne mund të japim një dorë për “shtëpinë” tonë. Është një moment kur ne të gjithë mund të tregojmë vlerat tona prej qytetari shembullor e të nxjerrim në pah ndjenjat tona për qytetin. Dhe nesër apo në një moment tjetër, kur gjithshka të ketë marrë drejtimin e duhur e sikur dikush të pyesë, kush ishte që bëri diçka kaq të bukur? Ne mund të përgjigjemi:

- Ne ishim! Ishim ne!

Dhe do të mund ta themi me krenari. Do të mund ta themi me kënaqësi. Dhe në veten tonë qetësia dhe kënaqësia do të jetë më e madhe se kurrë. Në këtë mënyrë do të mund të ecim kryelartë rrugëve të qytetit tonë. Do të mund t’u themi fëmijëve e miqve tanë për zotësinë tonë të përbashkët. Do të mund të flasim pa frikë se mos na kapin në gabim. Sepse ne jemi ndërtuesit e së ardhmes.

Asnjë nuk kërkon që kjo të arrihet sa hap e mbyll sytë. Asnjë nuk kërkon që të bëjmë hapa vigane e të nxituar. Le të bëjmë atë që është e nevojshme. Qoftë edhe pak. Por të saktë. “PAK E SAKTË”. Një shprehje popullore e vogël që në rastin konkret vlen shumë.


ROLI I LIDERIT ! LIDERSHIPI !

Kryetari duhet të zotohet të jetë i paanshëm dhe i drejtë. Duhet të zotohet të jetë një Udhëheqës apo Lider karizmatik.

Por çfarë është lidërsipi në vetvete?

Lidershipin mund ta klasifikojmë si një proces nëpërmjet të cilit influencohen aktivitetet individuale ose të grupit, duke i orientuar drejt vendosjes së objektivave dhe realizimit të tyre. Është drejtimi, orientimi, komandimi i bashkëpunëtorëve drejt përmbushjes me sukses të objektivave.

Vetë Lidershipi është i përfshirë në Menaxhim, i cili ka për bazë katër shtylla. Planifikimin, Organizimin, Koordinimin dhe Kontrollin. Menaxhim do të thotë të çosh deri në fund diçka për të cilën je përgjegjës. Një Menaxher i zoti duhet të jetë dhe një Lider i zoti.



Kryetari duhet të jetë një Lider direkt, organizativ, strategjik. Duhet të jetë i ndershëm, i respektuar nga të tjerët, kompetent, i kujdesshëm, inteligjent. Duhet të jetë një lider demokratik; të marrë vendime së bashku me vartësit. Ti bëjë thirrje pjesëmarrjes në grup të vartësve e njëkohësisht bashkëpunëtor, e të jetë i orientuar drejt “lidhjes”; dëgjon vartësit, i mbështet e i inkurajon në impenjimet e tyre. Favorizon ndërhyrjen e tyre në zgjidhjet e problemeve dhe në procesin vendimmarrës.

Dëgjon, Përgëzon, Lehtëson.

Kryetari si Lider apo Udhëheqës i një institucioni që mbështetet në njerëz me mendime dhe ide të ndryshme, duhet të jetë njëkohësisht edhe fleksibël. Zgjedhja e mënyrës së veprimit dhe sjelljes nga ana e tij varet nga disa faktorë.

Faktorë që varen direkt prej tij; mund të përmendim besimin te bashkëpunëtorët, tendenca e tij për figurën e Liderit etj.

Faktorë referuar bashkëpunëtorëve (vartësve); nevojë për “pavarësi” (iniciativa, por brenda kufinjve), nevojë për përgjegjësi, dëshirë për të qënë prezent etj.

Faktorë referuar situatës; efikasiteti i grupit, natyra e problemit, tipi i organizimit etj. Ai duhet të jetë në gjëndje të luajë role të ndryshme në varësi të situatës.

Lidershipi nuk duhet pare si një gjë që u bën personave, por si një gjë që bën me personat.

Strategjia e liderit duhet të mbështetet e të rregullohet mbi pjekurinë e vartësve dhe natyrës së detyrës që duhet kryer. Si strateg, ai jep instruksione specifike e kontrollon nga afër ekzekutimin e tyre. Drejton e Kontrollon. Lehtëson e mbështet sforcot e bashkëpunëtorëve për realizimin e objektivave të vënë dhe ndan me ta përgjegjësinë. Por ai, njëkohësisht, edhe delegon zgjidhjen e problemeve duke i lënë të sillen të lirë në zgjidhjen e tyre. Kuptohet jo problemet e një rëndësie të veçantë por ato që i japin mundësi vartësit të shprehet lirshëm e me iniciativë.

Si përfundim mund të themi që zotësia për të ndikuar tek të tjerët në mënyrë dinamike e nëpërmjet një pakti reciprok, duke synuar identifikimin dhe arritjen e objektivave të përbashkët, e bën një kryetar bashkie një Lider të zotë dhe të respektuar.

SHËRBIMET PËR KOMUNITETIN!

Shërbimet për komunitetin janë të ndryshme. Ato variojnë dhe pikërisht këtu qëndron dhe mundësia për të bërë diçka. Ku më shumë e ku më pak.

Këto shërbime, jo vetëm ai urban, evoluojnë në ç'do kohë. Evoluojnë në kohë, në masë, në vende të ndryshme. Sa më i madh të jetë një qytet aq më shumë kohë do të duhet të mbarohet një punë e marrë përsipër. Po kështu edhe masa e mjeteve dhe materialeve që duhen përdorur janë në përpjestim të drejtë me qytetin. Njëkohësisht, kjo vlen edhe për faktorin njeri (burimet njerëzore). Qëndron në zotësinë e Kryetarit, si Lider dhe Strateg, ta shfrytëzojë këtë faktor në mënyrë sa më ekonomike nëpërmjet shfrytëzimit dhe shpërndarjes së forcave me kujdes dhe maturi. Kjo arrihet nëpërmjet futjes së doktrinave të reja botërore në doktrinën aktuale të një bashkie. Marrjes shembull së sukseseve duke, jo i kopjuar, por përmirësuar dhe përshtatur akoma më tej në dobi të qytetit. Edhe futja e mjeteve teknologjike të brezit të fundit, do të ishte një risi në shërbim të qytetarëve.

Më poshtë disa prej tyre:

1. Transparenca.

Të krijohen kënde lajmërimesh për shpenzimet e bëra nga ana e institucionit. Të shpjegohet dhe shfaqet, në vija të trasha, bilanci. Të tregohen aktivitetet e institucionit. Të shpallen aprovimet e akteve, vendime e tekste ligjore. Dekrete, urdhëresa, njoftime për sipërmarrësit dhe rezultatet e arrira. Përveç këndeve, krijimi i shërbimit telefonik dhe të faqes së internetit me shpjegime të mëtejshme për kuriozitetet dhe pyetjet e qytetarëve, me apo pa pagesë.

2. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve me karakter vendor, të trotuareve dhe shesheve publike.

Mbas identifikimit të akteve rrugore që duhen ndërtuar apo rindërtuar, duhet ngritur një grup pune për ndjekjen nga afër të punimeve. Një grup pune të përbërë nga specialistë të fushave të ndryshme. Këtij grupi mund t'i bashkangjitet një grup i vogël prej 4 ose 5 studentësh të asaj fushe. Këta të fundit me të drejtë praktike pune por pa të drejtë vendimi. Rruga e re do të ndërtohet sipas standarteve të parashikuara me ligj.

Të ngrihet një grup pune tjetër për identifikimin e rrugëve të ndërtuara më parë por që kanë nevojë për rehabilitim e sistemim. Këto dy grupe të bashkëveprojnë e të japin informacion të vazhdueshëm mbi cilësinë e punës dhe vazhdimësisë së saj. Secili grup duhet të dalë në terren e të "prekin me dorë" gjendjen. Të kontrollojnë punimet me frekuenca të ndryshme kohore. Të shfrytëzojnë efektin surprizë gjatë zhvillimit të aktivitetit të tyre. Mbas rregullimit, rehabilitimit, ndërtimit të rrugëve duhet të krijohen ndërrmarje për mirëmbajtjen e tyre, pastrimin e gjelbërimit e tyre. Në këtë mënyrë do të kishim më shumë vende pune. Për pastrimin e rrugëve dhe trotuareve mund të përdoren makina të posaçme për këtë punë.

3. Funksionimin e transportit publik urban.

Siç u tha edhe më sipër, transporti publik varion nga qyteti në qytet. Në qytetet e mëdha do të duhej një shtim i autobuzëve. Autobuzë të përshtatshëm të mbajnë një numër relativisht të lartë pasagjerësh. Autobuzë të përshtatshëm për kategori të caktuara apo të veçanta njerëzish. Si përshtatshëm gra shtatzëna (vende të posaçme me hapësirë të bollshme dhe mundësisht afër derës), prindër me fëmijë dhe si rrjedhim vend për karrocën. Të përshtatshëm për njerëzit me handicap fizik. Si përshtatshëm të paralizuarit, të verbërit, invalidët, etj. Mund edhe të krijohet një transport i vecantë shtëpiak, i pajisur me linjë telefonike, për këtë kategori të fundit me një kosto të pranueshme nga të gjithë.

4. Administrimin e varrezave dhe garantimin e shërbimit të varrimit.

Ky është një problem që vihet re në të gjithë botën dhe, fatkeqësisht, është një problem në rritje të vazhdueshme. Një ide mund të jetë zhvillimi i krematoriumeve. Megjithatë në kulturën tonë kjo është një ide krejtësisht e papranueshme, kjo nuk do të thotë që nuk do të pranohet si ide. Kultura nuk është diçka statike, përkundrazi është shumë dinamike dhe e ndryshueshme. Ajo zhvillohet gjithmonë e më shumë me kalimin e kohës dhe i përshtatet nevojave të njeriut. Një tjetër mendim mund të jetë ajo e varrezave familjare me kate. Domethënë, në një "godinë" dy e më shumë arkivole.

5. Administrimin e parqeve, lulishteve dhe zonave të gjelbëruara publike.

Një ide për parqet dhe lulishtet, do të ishte dhënia e një firme private përgjegjësi për mirëmbajtjen dhe rregullimin e tyre me anë të një kontrate dy palëshe ku të dyja palët zotohen për të përmbushur zotësinë e marrë. Pala private, gjelbërim të vazhdueshëm e pastërti ndërsa institucioni të paguajë për këtë shërbim. Në rast të kundërt kontrata quhet e pavlefshme. Kështu do të kemi vazhdimisht një ambient rrethues vazhdimisht të gjelbërt. Normalisht që ekspertet e bashkisë do të bëjnë kontrolle të vazhdueshme në këto zona.

6. Shërbimin e dekorit.

Parandalim të akteve vandale si, shkrime nëpër mure dhe fshirjen e tyre, afishime të jashtë ligjshme etj. Parandalimi arrihet me anë të policisë bashkiake. Sinjalizim e ndihmë firmës private për raste të sinjalizuara nga qytetarë për braktisje të mjeteve e automjeteve, grumbull mbeturinash të palejuara, etj, nëpër parqe e lulishte. Kontroll, rregullim, e zëvendësim të "orendive" urbane.

7. Grumbullimin, largimin dhe përpunimin e mbeturinave.

Një nga problemet që në botën e civilizuar zë vendet e para në diskutimet e institucioneve shtetërore. Me të mbushen faqet e gazetave e lajmet në televizion. Kjo pasi me të është e lidhur ngushtë simbioza njeri-ambient. Po kështu edhe në vendin tonë. Por diçka mund të bëhet. Fillimisht mund të veprohet me ndryshimin e mentalitetit qytetar për një ndarje të diferencuar të mbeturinave. Kjo arrihet nëpërmjet reklamave

dhe njoftimeve në median e shkruar dhe të folur. Të sensibilizohet qytetari me filmime e fletushka të shpërndara në të gjithë qytetin. Të sensibilizohet gjithashtu edhe për prodhimin e tepërt të mbeturinave. Pastaj të shpërndahen kosha me udhëzime për përmbajtjen e tyre. Grumbullimi i mbeturinave bëhet me kamiona të veçantë. Në orët e vona të natës ose herët në mëngjes. Në këtë mënyrë edhe trafiku do të ketë disa makina më pak. Në vendgrumbullimin e mbeturinave duhet të krijohet një fabrikë për bluarjen dhe tretjen e tyre. Qytetet e vogla mund t'i transportojnë në qytetet e mëdha mbeturinat e tyre. Me intervale kohore të ndryshme, në varësi të prodhimit qytetas.

8. Ambjenti.

Edhe përsa i përket ambjentit janë të shumta politikat që ndiqen. Përveç grumbullimit e përpunimit të mbeturinave, një nga to është, më shumë ambjente të gjelbra. Në qytetin e Tiranës, por jo vetëm aty, vihet re një shtim i ambjenteve të gjelbra dhe një punë e mirë për t'i shtuar e zgjeruar këto ambjente. Por dihet që hapësirat e gjelbra nuk arrijnë të asimilojnë pluhurin e rrugëve të ngritur nga makinat dhe pluhurin e krijuar nga ndërtime të shumta që po karakterizojnë qytetet tona. Një mënyrë për të ulur nivelin e pluhurave mund të jetë ajo e ndalimit të qarkullimit rrugor në akse të caktuara rrugore. Në akse të tjera të ndalohet me orare të ndryshme. Mundësisht dhe sidomos kur mungojnë për një kohë të gjatë rreshjet. Edhe larja e rrugëve me makina të posaçme është një ndihmë për një ajër më të pastër. Dëmtim të rrugëve dhe si rrjedhojë më shumë pluhur, ndikojnë edhe makinat e tonazhit të rëndë që firmat ndërtuese përdorin për transportin e materialeve të rënda. Rrotat e këtyre makinave plot baltë e material tjetër, gërryejnë rrugën dhe balta e depozituar nga rrotat çon në një amortizim të shpejtë të rrugës. Kështu me një urdhëresë të veçantë, duhet detyruar firma ndërtuese të pastroje rrugën, me fondet e saja. Kontroll rigoroz i makinave të vjetra dhe sidomos shkarkimeve të tyre. Duhet të kontrollohet edhe karburanti i përdorur nga këto makina direkt në pikat e shpërndarjes.

9. Fëmijët.

Aktivitete të ndryshme kulturore-edukative për fëmijët e moshave të ndryshme të organizuara në bashkëpunim me teatrot e kukullave për fëmijë apo institucionet e tjera kulturore. Shfaqje të filmave të animuar nëpër kinema, lagje apo parqe, mbasditë, gjatë stinës së ngrohtë. Krijime të këndeve të lojërave në lulishtet e parqet. Ekskursione të organizuara për të njohur qytetin, historinë, njerëzit, institucionet e ndryshme etj.

10. Kultura. “Një libër një mik”.

Mund të jetë një nga sloganat e ditëve kulturore të organizuara nga bashkia. Promovime të librave të ndryshëm. Të shkrimtarëve vendas dhe atyre të huaj. Biblioteka të hapura dhe lehtësime për të tërhequr libra. Panairë për promovime librash, revistash e gazetash kulturore. Takime me shkrimtarë e gazetarë për të gjitha moshat. Skonto për hyrjet në teatro, muze, qendra kulturore etj. Për më të vegjëlit mund të organizohet e “Djela e Përrallave”. Organizimi i maratonave të ndryshme për një “Qytet Pa Makina” është njëkohësisht jo vetëm një moment kulturor ku lidhjet ndërmjet njerëzve konsolidohen më shumë por edhe një shtysë për të sensibilizuar mentalitetin qytetar përkundrejt ambjentit.

PJESËMARRJA QYTETARE NË VENDIM-MARRJE !

Ashtu si u tha më sipër, qyteti është shtëpia jonë. Dhe si e tillë ne jemi pjesëtarët e një familjeje të madhe. Të gjithë kemi të drejtën dhe duhet të themi fjalën tonë. Krijimi i një faqe web ku çdo qytetar mund të informohet mbi iniciativat e reja të bashkisë dhe me anë të një forumi apo me sondazhe të ndryshme t'i jepet mundësi të thojë apo të shprehë mendimet e tij. Në një pjesë të veçantë të faqes do instalohet një rubrikë pyetje-përgjigje me kryetarin ku qytetarët të kenë mundësi të komunikojnë çdo ditë me të. Një numër telefoni falas ku qytetari të sinjalizojë probleme të ndryshme që mund të ketë qyteti. Një takim personal i kryetarit të bashkisë me qytetarët, dy herë në javë në një "kuvend qytetar", mbas orarit zyrtar të punës. Ndoshta ditët më të përshtashme do të ishin e marta dhe e enjtja. Kjo do të thoshte një orar i tejzgjatur për kryetarin, por në këtë mënyrë do të ketë mundësi të japë një shembull personal për zellin dhe vullnetin që ai ka për zgjidhjen e problemeve të qytetit. Krijimi i kutive postare vetëm për institucionin e bashkisë, ku edhe ata më të ndrojturit, me anë të letrave anonime, të mund të thonë mendimin e tyre. Pjesëmarrja e intelektualëve, nëpërmjet thirrjeve të ndryshme në mediat lokale, në dhënie këshillash, mendimesh, vërejtjesh për një zgjidhje sa më cilësore. Por jo vetëm ata. Edhe qytetari i thjeshtë mund të marrë pjesë, me dëshirë, në një diskutim, në një nga lokalet e institucionit. Mund të organizohet një mbledhje dy herë në javë, me prezencën e kryetarit të bashkisë. Shërbimet e institucionit duhet të jenë cilësore. Në mënyrë të tillë edhe suksesi i arritur do të jetë më i madh.

MBYLLJE.

Këto edhe më shumë mund të bëhet për qytetet tona. Edhe shërbimet që u përmendën më sipër mund dhe janë për t'u përmirësuar. Ka mjaft shërbime që mund të kryhen në të mirë të qytetarëve e vizitorëve të ndryshëm. Duke patur parasysh edhe burimet financiare që në këtë ese nuk u morën parasysh, jo për mungesë idesh dhe mendimesh por për arsye se duke mos qenë i prekur direkt dhe pa pasur njohuri reale mbi buxhetin, më çoi në "injorimin" e tyre. Por dua të theksoj se të gjitha shërbimet e sipërpërmendura do të zhvillohen në raport me buxhetin e bashkisë. Edhe shërbime të tjera do të krijoheshin e zhvilloheshin në bashkëpunim me institucione të tjera shtetërore. Shembulli më konkret është turizmi. Po kështu edhe burime financiare do të kishte me shumë. Bashkëpunimi dhe binjakëzimi me bashki europiane për shkëmbim praktikash apo trajnim personeli do të ishte një shans më shumë për mbarëvajtjen në punën që bashkia do të ketë.

Në këtë ese shumë mendime dhe ide mund të mos jenë të sakta. Shumë ide dhe mendime mungojnë. Ndoshta ngaqë nuk erdhën në momentin e duhur, ndoshta ngaqë nuk u gjetën fjalët e duhura për t'i shprehur, arsyet janë të ndryshme e të shumta. Por mendoj se një njeri, qoftë ky kryetar apo jo, duke qenë në kontakt direkt me problemet, dhe jo si një palë e tretë, do të mund të mendojë e prodhojë idera për zhvillimin e mëtejshëm, sa më mirë, të qytetit. Por si do që të jetë, jam i mendimit që në këto momente, në qytetet tona po bëhet dhe do të bëhet një punë e jashtëzakonshme që edhe ato të quhen Qytete Europiane.

Enkeleid Kasa

Universiteti i Romës

3. Për një qeverisje të mirë vendore, Sikur të isha unë kryetar bashkie...

Sot më shumë se kurrë në Shqipëri ka nevojë për një pushtet vendor të fortë, të sigurt me kompetenca të gjera dhe eficient kundrejt qytetarëve.

Kjo reformë decentralizuese e pushtetit në Shqipëri është mëse e domosdoshme për të rifituar kohën e humbur ku mbizotëronte centralizimi i pushtetit ku qytetari dhe pushteti kishin një distancë shumë të largët.

Tashmë nuk është nevoja të flasim për dobishmërinë e decentralizimit apo rritjen e kompetencave të pushtetit vendor, në këtë mënyrë të kemi dhe ankthin e një politike të tillë kur nuk dimë se si do të shkojnë punët nëse pushteti vendor merr kompetenca të gjera.

Qytetet europiane na japin përgjigje hamendësive të tilla.

Më 18 shkurt 2007 zhvillohen zgjedhjet për pushtetin vendor në Republikën e Shqipërisë.

Qytetari në këto zgjedhje duke lënë mënjanë karakterin e tyre politik, dhe duke anashkaluar simpatitë dhe antipatitë për liderët kryesorë politikë, dhe të bëjë të mundur që ai x(iks) në fletën e votimit të jetë në përputhje me politikat e zhvillimit, me rrugën e shtruar, gjelbërimin, ndriçimin, me arsimimin e fëmijëve të tyre.

Çfarë do të bëja po të isha unë kryetar bashkie?

Një pyetje e bukur, interesante dhe e vështirë për t'iu përgjigjur.

Interesante për vetë faktin se ta shohësh veten në atë post mendon, ëndërron për më të mirën e mundshme për qytetarët, e mendon qytetin me një zhvillim të gjithanshëm, me një paqe sociale, me njerëz të lumtur që bredhin në qytetin e bukur dhe të gjelbëruar... kjo është liria e mendimit poetik.

E vështirë për t'iu përgjigjur pyetjes për vetë faktin ç'ka ofron Shqipëria sot, se çfarë pushteti aktual ka bashkia, çfarë duhet bërë, si duhet bërë, çfarë duhet ndryshuar, si duhet punuar apo nga duhet të fillojmë.

Dilema të panumurta paraqiten realisht.

Megjithatë asgjë nuk është e pamundur: Le t'ia fillojme ...

Ditën që do të fitoja zgjedhjet për kryetar bashkie veprimi i parë që do prisja ishte një telefonatë nga rivali im politik që doli i humbur në këto zgjedhje.

Kjo telefonatë do të doja të ishte një telefonatë urimi për detyrën time dhe njëkohësisht të bashkohej me planin tim për zhvillimin e qytetit.

Rëndësia e kësaj telefonate është e domosdoshme, e nevojshme për të bashkuar qytetarin shqiptar nga ndarjet politike që me aq fanatizëm i ruan.

Plani im si kryetar i ardhshëm i bashkisë do të konkretizohej duke zhvilluar tre "ture" të rëndësishme për zhvillimin e qytetit, e ndërthurur në tre aspekte, ku me këmbëngulje dhe me ndihmën e Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë, nuk do të dorëzohesha deri në aprovimin e këtyre tre kërkesave.

1- “Turi” i parë do ishte drejt qeverisë dhe drejt organit legjislativ. Së bashku me kryebashkiakët e tjerë do ti bënim presion, që në këtë rast ka rol pozitiv, qeverisë e parlamentit në mënyrë që disa kompetenca që janë shumë pranë qytetarit dhe zhvillimit të qytetit t’i kalonin bashkisë të tilla si: Policia ndërtimore, ajo rrugore, ujësjellësi, politikat arsimore etj,

Fjala etj do të thotë që nuk do kërkonim as më shumë e as më pak se sa kompetencat dhe pushteti që kanë bashkitë europiane.

2- Turi i dytë do ishte drejt qytetarëve, drejt ndërgjegjes së tyre për të afruar dhe harmonizuar kërkesat e tyre në politikën e ardhshme të bashkisë.

Ky tur do të ishte i vështirë për vetë faktin për të bindur për të edukuar qytetarinë, politikën e zhvillimit të qytetit, për t’i lënë mbrapa një herë e mirë hedhjen e mbeturinave nga ballkoni a çrregullime të tjera të arsyes njerëzore të këtij lloji. Do të harxhoja një pjesë të mirë të kohës dhe do të bëja të pamundurën për të imponuar tek qytetarët rregullin dhe politikat e qytetit modern.

3- Turi i tretë është drejt asaj që kemi në fakt në dorë në politik bërjen e bashkisë për t’i dhënë qytetit progresin dhe zhvillimin.

Ky tur do të ishte drejt “unit” tim, drejt ndërgjegjes së këshilltarëve bashkiakë a nëpunësve të tjerë për të bërë betimin moral ndaj qytetarëve dhe betimin ligjor ndaj kushtetutës si detyrimet më të larta që kemi.

Si fillim platformën time do e nisja me një plan urbanistik me rregullimin dhe pastrimin e qytetit, me rrugët dhe trotualet kanalizimet dhe me gjelbërimin, të bëheshin në mënyrën më të shpejtë të mundshme që “shtëpia jonë” e përbashkët të paktën të jetë e pastër, e rregulluar dhe perceptimi për qytetarin të shkonin në të njëjtën vijë me perceptimin e qytetit. Një qytet i rregulluar plot gjelbërim e ngjyra ka ndikimin e vet në psikikën e qytetarit drejt së bukurës, që përkthehet në punë dhe optimizëm për qytetin tënd.

Një “shtëpi” e pa sistemuar, me llum, baltë e gropa nuk vizitohet, përkundrazi “familjarët” e saj përçmohen kudo që të shkojnë dhe gjithashtu llumi, balta, pluhuri, sjellin të shëmtuarën në psikikën e njeriut duke ushqyer parazitizmin, pesimizmin e moskokëçarjen me qytetin tënd.

Të ndërtosh e të mirëmbash qytetin është politika më e mirë sociale me anë të shërbimeve hapen dhe vendet e punës. Muzeumet , panairët , qendrat sportive e kulturore janë një afirmim drejt kulturës së një qyteti dhe si një nektar për vizitorët e huaj.

Të mos biem në pesimizëm pasi nuk kemi një Eifel, një Koloseum apo kështjellë të lashtë, kjo do të thotë të investosh në qytetin tënd për kulturën, për teatrin, kinemanë dhe arsimin bashkëkohor .

Nuk kam një rekomandim të saktë për sistemin e taksave pasi atë do e vendosë ekonomia e qytetit, me atë ç’ka është në gjendje të paguajë qytetari duke gjetur mesataren e artë me kërkesën e bashkisë dhe me atë që ofron tregu.

Në qoftë se do të isha kryetar i një bashkie të madhe do propozoja një taksë të re për makinat që hyjnë në qendër të qytetit dhe kjo do të sillte 3 të mira.

1. Rritje të ardhurash për bashkinë

2. Ulje të trafikut në qendër

3. Ulje të ndotjes

Si përfundim për të shpalosur një platformë të mirë bashkiake do duheshin fjali e ditë tëra për t'i shkruajtur, por e rëndësishmja e çdo lloj platforme është vullneti i kryetarit të bashkisë për të lënë një gjurmë në zhvillimin e qytetit. Këtij vullneti duke i shtuar dhe politikën e bashkisë në krahasim të qytetarit në respekt të ligjit do e rriste produktivitetin e do na afronin akoma më shumë me Europën, sidomos pas plotësimit të dy kërkesave të dy "tureve" të para: të decentralizimit që do thoshte se zhvillimi të ecë në të njëjtin kah dhe jo si një lojë ping-pongu ndërmjet pushtetesh e kompetencash dhe të ndërgjegjes së qytetarit kur ky i fundit të kuptojë se nuk egziston nocioni qytet European pa ndihmën e tyre.

Elson Bruka

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Drejtësisë

4. Sikur të isha Kryetar Bashkie

Sot është një ditë me shi, ai ka nisur herët dhe duket se e ka marrë shtruar. Eci nëpër bulevardin e qytetit tim të vogël krejt të lagur nga shiu dhe pastaj futem nëpër rrugicat e ngushta krejt të boshatisura. Jam vetëm, nuk ka kalimtarë që nxitojnë për diku, nuk ka fëmijë që luajnë e as pensionistë me kutitë e shahut e të dominove nëpër lulishte. Shoqëri më bën shiu dhe kur shoh rrotull meje syri më zë postera të mëdhenj, shumëngjyrësh me slogane dhe me disa fytyra të stampuara në to. Më buzëqeshin, duket sikur diçka duan të më thonë dhe sikur diçka kërkojnë, vështrimi i tyre është premtues dhe njëkohësisht tërheqës. Dua ta largoj vështrimin prej tyre, por nuk mundem, ja ku po i shoh sërish, por këtë herë të lagur nga pikat e shiut, po i del boja e posterave, po humbet shkëlqimi, po fshihen shkronjat, po humbet kuptimi i sloganit. Sa keq që përfunduan kështu, dukeshin aq të bukur, si në një ëndërr.

Vazhdoj të eci, më pëlqen të shoh qytetin tim në shi, duket si i dorëzuar, sikur po dridhet nga të ftohtit që sjell era, sikur po përpiqet të gjej një strehë larg shiut. Sikur të mundja të bëja diçka për të... çfarë mund të bëja?! Mendoj me veten time: "Sikur të isha kryetare e bashkisë së qytetit tim, unë do të bëja shumë gjëra të mira dhe në dobi të bashkëqytetarëve të mi, do të plotësoja nevojat dhe dëshirat e tyre." Pastaj kuptoj se ka diçka që nuk shkon në këtë mendim. Si mund ta di unë paraprakisht se cilat janë nevojat dhe dëshirat e bashkëqytetarëve të mi? Kush më jep mua të drejtën për të caktuar se cilat janë gjëra e mira dhe cilat janë më pak të mira për qytetin dhe banorët e tij? A nuk duhet të jenë vetë qytetarët ata që të përcaktojnë prioritetet e tyre, të parashatrojnë kërkesat për plotësimin e nevojave dhe të caktojnë se çfarë është e mirë e çfarë është e keqe për ta?

Një kryetar bashkie vërtet është udhëheqësi i bashkësisë vendore dhe së bashku me Këshillin Bashkiak përcakton politikat kryesore dhe merr vendimet për të gjithë qytetin, por ai nuk është MESIA, që ka zbritur në tokë i pajisur me dijen absolute për të qeverisur, sa do vizionar dhe i zoti të jetë. Nëse prioritetet dhe politikat përcaktohen në mënyrë të njëanshme nga kryetari dhe vendimet që prekin të gjithë qytetin merren nga një grup i vogël njerëzish atëherë demokracia është e rrezikuar.

Sikur të isha kryetare e bashkisë së qytetit tim shqetësimi im i parë do të ishte si të shmangja problemet e sipërpërmendura që rrjedhin nga ky model i demokracisë përfaqësuese dhe të gjeja një rrugë për t'i përfshirë qytetarët në vendimmarrje. Vizioni im për të ardhmen e komunitetit do të ishte si t'i përfshija qytetarët në proceset vendimmarrëse dhe si të bëja zërin e tyre të dëgjueshëm në qeverisjen vendore. Meqenëse alokimi i burimeve ekonomike qëndron në themel të çdo projekti apo vendimi rreth përmirësimit të qeverisjes në nivel vendor, unë si udhëheqës dhe shërbyes i komunitetit do të përcaktoja si prioritet kryesor të qeverisjes planifikimin dhe vënien në zbatim të Buxhetimit me Pjesëmarrje. Buxheti me pjesëmarrje është një proces demokratik i vendimmarrjes dhe i deliberimit, në të cilin qytetarët vendosin përmes komunikimit si të alokojnë pjesë të buxhetit bashkiak. Tiparet kryesore të Buxhetimit me Pjesëmarrje janë:

- Identifikimi i prioriteteve nga anëtarët e komunitetit.
- Komunikimi me synim arritjen e vendimmarrjes.
- Zgjedhja e delegatëve të qytetarëve.
- Shërbime trajnuese për delegatët e mini-rajoneve brenda bashkisë.
- Takime publike dhe fushata informuese.
- Deliberim mes autoriteteve lokale dhe qytetarëve.
- Mbledhje me dyer të hapura.
- Votimi për të marrë vendimin.
- Vendimmarrja
- Kontrolli.

Përmes Buxhetimit me Pjesëmarrje unë, si kryetare e bashkisë, synoj të rris nivelin e demokratizimit të qeverisjes së qytetit tim, përmes përfshirjes së qytetarëve. Tanimë nuk është kryetari që i vetëm përcakton alokimin e burimeve, por vetë qytetarët vendosin për alokimin e taksave të tyre në bazë të prioriteteve dhe nevojave të tyre të përcaktuara nga vetë ata. Buxhetimi është shumë i rëndësishëm si proces për këto arsye:

Së pari, shmang apatinë qytetare dhe rrit nivelin e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje duke i bërë ata qytetarë aktiv, të angazhuar dhe llogarikërkues. Përmes tij vendimmarrja afrohet më pranë atyre që do të pësojnë impaktin e saj direkt duke i bërë politikat më publike dhe transparente.

Së dyti, është një proces komunikimi drejt arritjes së një vendimi në fushat kryesore si: investime në infrastrukturën lokale, transporti publik, shëndetësia dhe ndihma sociale, zhvillimi ekonomik, taksat, arsimi, sporti etj. Tanimë qytetarët vendosin vetë në lidhje me nevojat dhe shqetësimet e tyre.

Së treti, ul nivelin e defiçitit demokratik. Është e vërtetë që qytetarët duan më shumë rrugë të asfaltuara, shkolla, shërbime cilësore e të tjera të ngjashme. Këto të fundit nuk caktohen njëanshmërisht nga drejtuesit lokal, por janë vetë qytetarët që vendosin për plotësimin e nevojave dhe përcaktimin e prioriteteve. Askush nuk zotëron të drejtën absolute për të vendosur për të tjerët pa marrë në konsideratë vullnetin e tyre dhe askush nuk mund të caktojë arbitrarisht se ç'është e mire dhe ç'është e keqe për bashkësinë, qoftë ky edhe kryetari i bashkisë. Nëse një person gëzon monopolin e arsyes dhe vendimmarrjes atëherë demokracia ka humbur premisat e saj kryesore. Pikërisht këtë synon të evitohet kjo politikë e mënyrës së buxhetimit.

Së katërti, përmes Buxhetimit me Pjesëmarrje arrihet një nivel më i lartë i drejtësisë sociale duke përmirësuar politikat dhe duke alokuar burimet si dhe krijohen mundësitë për reformimin e administratës.

Përmes implementimit të një politike të tillë të Buxhetimit me Pjesëmarrje evidentohet roli i kryetarit të bashkisë si udhëheqës vizionar dhe i përkushtuar ndaj komunitetit të cilit i shërben. Gjithashtu mundësohet përmirësimi i shërbimeve dhe zbatimi i politikave më të prekshme për qytetarët. Për më tepër Buxhetimi me Pjesëmarrje mundëson rritjen e angazhimit qytetar në vendimmarrje dhe përmirëson cilësinë e qeverisjes.

Duke i menduar të gjitha këto arritje të përfytyroj sesi do të jetë konfigurimi i strukturave vendore qeverisëse, sesi do të ndryshojë ngadalë roli i qytetarit në qeverisje, sesi ai do të ndihet pjesë e marrjes së vendimeve dhe sesi realiteti i bashkësisë sonë do të përmirësohet me kalimin e kohës. Jam ende duke ecur nëpër rrugët e qytetit tim, por tanimë shiu ka pushuar, kanë dalë rrezet e para të diellit. Eci dhe shoh që rreth meje ka gjallëri, ndiej lëvizje, njerëz që rendin drejt punës, nxënës që rendin drejt shkollës, fëmijë që luajnë e ja ku gjendem së bashku me bashkëqytetarët e mi me pamje nga bashkia e qytetit tonë, vështrimi jonë është drejtuar andej nga ku shiu ka pushuar dhe nga ku tani po shkëlqen ylberi shumëgjyrësh.

Blerjana Bino

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Shkencave Sociale

Dega Shkenca Politike

5.

Të drejtosh një institucion apo qoftë dhe një organizatë është një detyrë shumë e vështirë sepse kërkon përshtetshmëri, përgjegjshmëri, ndershmëri dhe një sërë rekuizitësh të tjera, por ajo që është më e rëndësishme: duhet të kesh studiuar një plan të qartë menaxhimi që do të orientojë drejt suksesit. Sikur të isha Kryetare Bashkie do të ndryshoja shumë aspekte të drejtimit të paraardhësve të mi, të cilët janë treguar të paaftë për të plotësuar dhe drejtuar me efektivitet. Fillimisht duhet përcaktuar kuptimi i fjalës aq të përdorur: menaxhim.

Menaxhimi është të punosh me dhe nëpërmjet njerëzve të tjerë për të realizuar objektivat e organizatës dhe të pjestarëve të saj. Çdo menaxher planifikon, organizon, rekruton, koordinon, motivon, udhëheq dhe kontrollon.

Kompetencat personale për një menaxher të sukseshëm janë:

- **Udhëheqja** - aftësi për të influencuar tek të tjerët dhe për të kryer detyrat
- **Vetë objektiviteti** - aftësi për të vlerësuar vetveten me realitet
- **Mendimi analitik** - aftësi për të interpretuar dhe shpjeguar modele në informacion
- **Fleksibilitet në sjellje** - aftësi për të modifikuar sjelljen personale për të arritur qëllimet
- **Komunikim me gojë** - aftësi për të shprehur idetë qartë në prezantimet gojore
- **Komunikim me shkrim** - aftësi për të shprehur idetë qartë me shkrim
- **Impakt personal** - aftësi për të krijuar një përshtypje të mirë dhe të ngulitësh konfidencë
- **Rezistencë ndaj stresit** - aftësi për të realizuar nën kushte stresuese
- **Tolerancë për paqartësi** - aftësi për të realizuar në situata të paqarta

Një person mund të konsiderohet menaxher jo se i tillë është titulli i tij, por sepse puna e tij konsiston në funksione menaxheriale, të cilat përmenden më poshtë:

- **Planifikimi.** Ky funksion qëndron në planifikimin e ngjarjeve të ardhshme dhe në përcaktimin e veprimtarive më efektive të organizatës.
- **Organizimi.** Ky funksion qëndron në mënyrat se si vendoset organizimi struktural dhe se si autoriteti dhe përgjegjësitë i janë dhënë menaxherëve të ndryshëm në një proces të quajtur delegim.
- **Komandimi.** Ky funksion tregon se si menaxherët drejtojnë punonjësit.
- **Koordinimi.** Ky funksion përfshin aktivitetet e përcaktuara që të krijojnë një marrëdhënie midis gjithë përpjekjeve të organizatës për të përmbushur një qëllim të përbashkët.
- **Kontrollimi.** Ky funksion përcakton se si menaxherët e vlerësojnë performancën brenda organizatës në lidhje me planet dhe objektivat e saj.

Vetëm pasi të kisha plotësuar rekuizitet e sipërpërmendura, unë do të filloja punën time si Kryetare Bashkie. Në periudhën e parë të qeverisjes sime do të kontrolloja nëse puna e paraardhësit tim ishte kryer me efektivitet dhe do të përqipeshja të ndreqja gabimet e tij dhe unë personalisht të mos i përsëritja. Reforma e parë në një institucion është zgjedhja e një stafi kompetent. Kjo nuk do të thotë absolutisht largimin nga postet e punës për politizimin e personit në fjalë, por do të thotë mbajtja e një stafi të kualifikuar dhe me prodhimtari më të lartë në krahasim me të tjerët.

- Së pari, do të fillonte ndarja e punës. Puna ndahet në detyra të veçanta dhe midis individëve apo grupeve të punës, që të specializohen në një detyre specifike duke çuar në specializimin e punës.
- Së dyti, duhet të zbatohet patjetër nënshtrimi i individit, pra qëllimi dhe interesi i institucionit është më i rëndësishëm se qëllimet apo interesat personale.
- Së treti, zbatimi i rreptë i disiplinës, pra aplikimi i dënimit për dështime të mundshme. Kjo është gjithashtu një mënyrë mjaft efektive për të evituar korrupsionin.
- Së katërti, duhet të ekzistojë barazia në staf. Kështu, punonjësit duhet ta ndiejnë veten se trajtohen me barazi dhe drejtësi.
- Së pesti, menaxhimi i mirë do të thotë dhe iniciativë. Punonjësit duhen inkujuar për këtë dhe atyre u duhet lënë “dorë e lirë” për risitë që sjellin në punën e tyre.
- Së fundmi, shpërblimi, i cili duhet të vendoset sipas një formule të përgjithshme. Punonjësit do të merrnin pagën e tyre në bazë të kualifikimeve të tyre, kërkesave dhe ofertave nga institucionet e tjera për punë dhe natyrisht nga niveli i arritur i prodhimit.

Mbasi reforma në staf do të kishte përfunduar dhe unë vërtet, me një staf të tillë mund të arrija të gjitha objektivat e mia, do të filloja të shqyrtoja të gjitha premtimet e mbajtura gjatë fushatës elektorale dhe me mjetet të cilat më janë vendosur në dispozicion do të mundohesha t’i përmbushja ato. Sigurisht që problemet më të rëndësishme që shqetësojnë qytetarët, kanë prioritet. Por si mund të kuptohet se cilat janë problemet që shqetësojnë qytetarët?

Përgjigja është mjaft e thjeshtë: nëpërmjet anketimit. Për çdo minibashki të vecantë do të përgatiten anketa në të cilat qytetarët mund të shprehin lirisht problemet që i shqetësojnë dhe pse jo edhe opinionet e tyre në lidhje me mënyrën e qeverisjes sonë.

Pas një anketimi të suksesshëm, sigurisht do të kalohet në masa konkrete, në përmirësimin e jetës së qytetarit sepse **detyra kryesore e një Kryetari Bashkie është t’i shërbejë të gjithë kombit dhe jo vetëm një partie**. Gjithçka e planifikuar do të kryhet në bazë të fondeve dhe mjeteve të tjera të vendosura në dispozicion, të cilat duhet të përdoren me efikasitet dhe kursim. Duke kaluar në masa konkrete, mendoj problemet e mëposhtme do të ishin më shqetësuese:

- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve. Rrugët, ndoshta janë problemi kryesor që shqetëson qytetarët. Nuk mund të pretendohet rehabilitimi i objekteve të tjera, nëse rrugët në të cilat ne ecim dhe kalojmë përditë janë në gjëndje të mjerueshme.
- Ndriçimi i mjediseve publike. Është një masë mjaft e nevojshme, sepse në fund të fundit nuk mund të qarkullosh natën i qetë dhe i lënë në mëshirë të makinave që kalojnë për të të ndriçuar disi rrugën. Pajisja me drita e të gjitha rrugëve të Tiranës, jo vetëm në qendrat kryesore, por edhe në periferi, do të ulte ndjeshëm kriminalitetin: përdhunimet, vrasjet dhe vjedhjet në rrugicat e errëta.

- Grumbullimi dhe largimi i mbeturinave. Një masë e tillë do të ulte disi shkallën e ndotjes që karakterizon vendin tonë. Mendoj që është e nevojshme pajisja me kosha për mbeturinat në rrugët kryesore, në këtë mënyrë qytetari do të ndërgjegjësohet për veprimin që bën dhe gjithashtu shtimi i numrit të koshave të mëdhenj nëpër lagje. Sigurisht është e nevojshme që largimi i tyre nga mjediset publike të kryhet çdo ditë, por kjo do të kërkonte mjete financiare të larta, kështu që një ide interesante është dhe nisma vullnetare. Qytetarët një herë në muaj mund të mblidhen e të punojmë së bashku për një ambient më të pastër.
- Funksionimi i transportit publik urban. Kjo masë konsiston në qarkullimin e autobuzave, të cilët sigurojnë zhvendosje më të lehtë të qytetarëve. Numri i mjeteve të qarkullimit urban duhet të jetë i konsiderueshëm, në mënyrë që të gjithë qytetarët të kenë mundësi të përfitojnë nga ky shërbim. Është patjetër e nevojshme që me anë të tabelave apo sinjalizimeve të dallohet qartë qëndrimi i autobusit, sepse jo të gjithë janë të informuar për vendndodhjen e tyre dhe shpesh presin në vende të gabuara.
- Gjelbërimi dhe mirëmbajtja e lulishteve. Duket mjaft qartë që qytetet shqiptare janë të varfëra për sa i përket gjelbërimit, veçanërisht qytetet e mëdha. Shtimi i gjelbërimit dhe ndërtimi i lulishteve të reja do të ulte ndjeshëm nivelin e ndotjes së shkaktuar nga makinat dhe do të krijonte mundësi të reja argëtimi për qytetarët. Mbjellja e bimëve të reja dhe mirëmbajtja e mjediseve të tilla, mund të organizohet edhe në mënyrë vullnetare nga të gjithë qytetarët.

Përveç detyrave të zakonshme dhe obligimeve të tij, një udhëheqës duhet të sjellë edhe risi dhe duhet të ketë vizion. Për këtë është nevojshme që në staf të punojnë njerëz kreativë dhe të vetëmotivuar për të arritur diçka të bukur dhe për ta ndarë me të tjerët, pse jo dhe vetë kryetari mund të ofrojë risi. Një nga risitë që unë si Kryetare Bashkie do të sillja është argëtimi. Do mundohesha të bëja diçka ndryshe për të rinjtë sesa kafja e përditshme nga blloku, diçka të re për më të vegjëlit sesa humbja e kohës në lojërat elektronike dhe diçka më tepër për më të moshuarit sesa qëndrimi në stola dhe një lojë shahu me shokët. Do të krijoja qendra të posaçme ku të gjithë do të gjenin mënyra të reja argëtimi dhe do të mbushnin kohën e tyre të lirë me aktivitete të reja interesante dhe jo me monotoninë e zakonshme. Nuk është aspak e nevojshme një ndërtesë e re për një qendër të tillë, sepse qytetet tona kanë plot të tilla, por do të mjaftonte një ambient i madh i marrë me qira, i gjelbëruar dhe mikpritës. Të vegjëlit mund të organizonin sporte të ndryshme ose konkurse midis njeri-tjetrit, adoleshentët mund të diskutonin për problemet që i shqetësojnë, të debatonin dhe pse jo të organizonin dhe ndonjë festë të vogël me muzikën që u pëlqen. Ndërsa më të moshuarit mund të luanin shah, në një mjedis më të qetë, të diskutonin dhe të zinin shoqëri të reja për të ulur sadopak vetminë e tyre.

Ndoshta të gjitha masat e sipërpërmendura do të kërkojnë një kohë mjaft të gjatë për tu realizuar dhe fonde mjaft të mëdha, por e rëndësishme është dëshira e mirë për të bërë diçka ndryshe dhe për të përmirësuar jetën e bashkëqytetarëve të tu. Koha është e pafund dhe mjetet materiale mund të gjenden edhe nga sponsorë. Në momentin e parë që kërkesat e mia nuk do të realizoheshin dhe qytetarët do të ishin të pakënaqur, unë do të jepja dorëheqjen, sepse një kryetar i mirë di jo vetëm të udhëheqë, por edhe të dorëzohet përballë pamundësisë.

Sikur të isha Kryetare Bashkie do të ndriçoja jetën e bashkëqytetarëve të mi...

Jeta Hasanaj

6.

Është e vërtetë se të kesh mbi vete drejtimin e bashkisë më të madhe të Shqipërisë, atë të metropolit tiranas, sjell me vete punë dhe përgjegjësi ashtu si kënaqësinë e të shërbyerit qytetarëve të tu dhe qytetit tënd, për një të ardhme të begatë dhe shumë më të mirë se e tashmja. Të gjitha mund të arrihen, nuk ka asgjë të pamundur kur ke dëshirën e mirë, vullnetin dhe frymën e bashkëpunimit me të gjithë aktorët dhe sidomos qytetarët, të cilët të kanë ofruar besimin dhe votën e tyre dhe presin me të drejtë rezultatet e punës tënde të përditshme.

Unë si kryetare e bashkisë së Tiranës kam vizionin dhe strategjinë time, se si Tirana të shndërrohet në një mjedis europian dhe modern, gjithmonë duke ruajtur traditat dhe themelet e histories, që përbëjnë një pjesë të mirë të vlerave të qytetit. Vizioni im është i qartë për të ndërtuar një Tiranë me më shumë mundësi për të rinjtë, më shumë mundësi për të moshuarit, më shumë mundësi për burrat dhe gratë qytetare të Tiranës, ku mjedisi, ushqimi, infrastruktura, institucionet arsimore dhe edukative, shëndeti publik dhe të gjithë shërbimet tona të jenë në cilësinë më të lartë, që do të përmirësojnë dhe lehtësojnë jetën e çdo qytetari të Tiranës duke e bërë Tiranën shtëpinë e përbashkët e të gjithë qytetarëve.

Së pari në Tiranë duhet të shtohen 3 shkolla të reja 9- vjecare dhe gjithashtu 2 shkolla të mesme në mënyrë të tillë që numri i nxënësve nëpër klasa të ulët ndjeshëm duke siguruar nivel më të lartë në mësimnxënie dhe në mësimdhënie. Kjo do të realizohet në kuadrin e funksioneve të përbashkëta me qeverisjen qendrore dhe me modalitetet përkatëse organizative dhe kohore. Në objektet ekzistuese duhet të ketë sistem ngrohjeje dhe ndriçimi gjatë gjithë kohës duke instaluar aparaturat e nevojshme, që këto të mos jenë të varura vetëm nga energjia elektrike, por edhe me mënyra të tjera alternative të energjisë. Gjithashtu duhet të shtohet një shërbim i ri i bashkisë, ku çdo fund muaji punonjës të bashkisë shkojnë dhe bëjnë inspektim për kushtet higjieno-sanitare të shkollave, sidomos ambjeteve të tualetit që lënë për të dëshiruar në shumë raste dhe mund të bëhen objekt i infektimit me sëmundje të ndryshme tek nxënësit.

Duhet të nis një projekt me tematikë: “E ardhmja mbështetet tek e shkuara”, ku të rinjtë e kryeqytetit njihen me monumentet kulturore, objektet tradicionale, këngët, vallet, gatimet, historinë e Tiranës. Në këtë mënyrë ata bëhen më të përgjegjshëm për vlerat e kësaj kulture dhe për ruajtjen e saj brez pas brezit.

Proçesi i dhënies së bursave duhet të ndryshojë patjetër karakterin e tij përjashtues për arsye se ofrohen bursa vetëm për studentët që i kanë të gjitha 10 (dhjetë), jo se kjo është gabim, përkundrazi por të ketë një formë tjetër. Sepse nxënësi qoftë për një 9 (nëntë) të vetme nuk përfiton asgjë, në këtë mënyrë ai stresohet, dhe nuk sigurohet një mirëritje psikologjike e tij. Atëherë ideja ime është që nxënësit me të gjitha 10-të marrin bursë të plotë, me një 9-të të marrin gjysëm burse dhe me dy 9-ta të marrin çerek burse. Sepse të gjithë e dimë që një 9-të mund të merret dhe aksidentalisht, dhe për arsye të tjera por nuk tregon më pak nivel në përgatitje në këtë mënyrë stimuli do të jetë më i drejtë.

Zhvillimi i një konkursi vjetor letraro-artistik për shkollat e Tiranës ku fituesit i sponsorizohet nga bashkia botimi i një libri do të jetë pjesë e programit për të rinjtë. Gjithashtu do të organizohen në mënyrë kolektive klasat mësimore që të marrin pjesë si spektatorë me çmime simbolike në shfaqje artistike, teatrale, sportive etj. Në këtë mënyrë bota shpirtërore dhe angazhimi i tyre ditor nuk do të jetë aq i varfër.

Hapja e një kompleksi sportiv falas për të rinjtë me prioritet zonat periferike do të jetë një projekt që do të realizohet me mbështetjen e organizatave të ndryshme, dhe fondacionet bamirëse të cilët do të kenë dyert hapur për bashkëpunim në Bashkinë e Tiranës.

Së dyti, duhet të hapet për të moshuarit e Tiranës, të cilët nuk kanë gjëndje të mirë financiare, një azil falas dhe një muncë publike e cila të ofrojë ushqim falas dhe me cilësi të mirë, e menaxhuar nga bashkia për këta të moshuar. Gjithashtu në zyrën e gjendjes civile do të krijohet një sportel vetëm për ta. Patjetër që duhen përmisuar kushtet në shumë aspekte por preka atë që është funksion i drejtpërdrejtë i bashkisë.

Së treti, përsa i përket ndihmës ekonomike për familjet në nevojë, do të lehtësoj dokumentacionin kërkues për marrjen e ndihmës, duke kursyer në këtë mënyrë kohë dhe para për sigurimin e tyre nga qytetarët. Patjetër që krahas saj duhet të rris procesin e verifikimit në mënyrë që të marrin ata që nuk kanë nevojë dhe të mos marrin ata që kanë nevojë. Është e nevojshme edhe rritja e shumës që ata përfitojnë nga ndihma ekonomike.

Së katërti, është një çështje që lidhet me dy nga kompetencat bashkiake, atë të mjedisit dhe atë të varrezave që në projektin tim kanë një ndërthurje në një aspekt. Fusha e Sharrës është bërë një mbledhës i pafundëm i mbeturinave, të cilat jo vetëm që ndikojnë në ajrin dhe shëndetin e Kombinatit por të gjithë Tiranës sepse ajri nuk njih kufinj administrativ. Boshatisja e menjëhershme e tyre është detyrim kundrejt shëndetit publik. Duke qenë se kohët e fundit kemi hasur në planifikimin e vendeve për në varreza duke qenë se nuk ka më vende. Me këtë boshatisje të fushës së Sharrës ne fitojmë atje vende për parcela të reja për banesën e fundit të qytetarëve të Tiranës. Në këtë mënyrë eliminojmë dy probleme në një projekt të përbashkët.

Në vazhdimësi të çështjes së varrezave, shuma që paguan bashkia për varrimin e një të ndjeri është jashtëzakonisht shumë e papërfillshme në krahasim me nevojat e parave që një banor harxhon për të patur një varrim me kushtet më minimale dinjitoze për njeriun e familjes. Një nga idetë e mia do të jetë bashkëpunimi me Institutin e Sigurimeve Shoqërore në mënyrë të tillë që të bëhet një rregullim, që një pjesë e derdhjeve për sigurime në fund të jetës së qytetarit të shkojë për nderimin e tij të fundit. Kjo do të vendoset nga një marrëveshje e përbashkët. Ka edhe njerëz që kanë paguar çdo vit sigurime dhe ndahen nga jeta pa përfituar qoftë edhe një pension nga derdhjet e tyre të një jete të tërë.

Gjithashtu do të shtoj konteinierët e mbeturinave jo vetëm në rrugët kryesore, por në çdo rrugë të Tiranës. Në Tiranë do të aplikohet procesi i riciklimit të mbeturinave dhe në këtë mënyrë ne mund të përfitojmë më shumë edhe nga mbetjet tona. Eficienca duhet të rritet, kjo edhe me anë të kontrolleve të punonjësve të bashkisë së Tiranës, që punojnë në sektorin e mbledhjes së mbeturinave. Ky proces duhet të jetë i përditshëm dhe të përmbajë në vetvete edhe ndarjen e llojeve të ndryshme të mbeturinave.

Së pesti, kërkohet vënia në funksionim eficient e rezervuarit të Bovillës në mënyrë që Tirana të ketë ujë 24 orë dhe të mos varet nga energjia elektrike ashtu si varet sot nga pompat. Gjithashtu duhet të bëhet ndarja e ujrave të zeza nga ato të bardha dhe ndryshimi i tubave të ujrave të bardha kur ato janë të amortizuara dhe nuk e kryejnë më me efektivitet dhe pastërti procesin e qarkullimit të ujrave.

Përsa i përket kolektorëve, ata nuk mund të jenë kurrsesi të përfshirë brenda një projekti ndërtues që bashkia e Tiranës mund të japë sepse kjo gjë dëmton rëndë mirëfunksionin e gjithë procesit të ujrave të bardha dhe të zeza në rast nevojë.

Së gjashti, një nga problemet e tjera që duhet të zgjidhet është transporti urban. Shikohet një mbingarkesë dhe një funksionim me probleme i tij. Shtimi i numrave të autobuzave nuk do të sillte ndonjë përmirësim dhe për trafikun e madh që ekziston zgjidhja për mua është ndërtimi i një korsie të vecantë vetëm për transportin urban. Në këtë mënyrë autobuzat do të kthehen në një shërbim efektiv për transportin e qytetarëve, për të arritur në kohën e duhur dhe në vendin e duhur.

Duke qenë se jemi tek transporti, përveç rregullimit të të gjithë infrastrukturës Tiranase, një proces që ka filluar dhe kuptohet që së shpejti do të përfundojë duke shënuar një hap të rëndësishëm në përmirësimin e jetesës në përgjithësi në Tiranë. Ideja ime që duhet të marrë jetë sa më shpejt është krijimi i një nënkalimi në kyqëzimin e qytetit të nxënësve ku del për në autostradë.

Së shtati, kërkohet prishja e banesave të romëve tek fundi i Lanës në mënyrë që kushtet skandaloze në të cilat ata jetojnë dhe prishja e imazhit të një qyteti europian të marrë fund njëherë e përgjithmonë pa harruar higjenën e munguar në to dhe prababilitetin e madh që të shndërrohet në vatër të sëmundjeve të ndryshme. Në vend të tyre të jepet një leje për ndërtimin e një kompleksi rezidencial ku nuk do të mungojnë këndet e lojrave, lokalet dhe ambjente të tjera. Përsa i përket çështjes se ku do të shkojnë romët, ata do të strehon në banesa publike që do të ndërtohen nga bashkia e Tiranës për ta dhe për shtresa të tjera që si banesën e tyre kanë rrugën dhe urat tiranase.

Së teti, përsa i përket ndriçimit të qytetit duhet që linja e ndriçimit të mos jetë siç është tani në varësi të zonave ku ndodhet, por në bashkëpunim me KESH-in të krijohet një linjë e veçantë në të cilën nuk do të ketë për asnjë moment ndërprerje të energjisë elektrike. Duhet të kalohen linjat ajrore të telefonit, energjisë në linja nëntokësore. Të dyja do të kryhen në bashkëpunim me qeverisjen qendrore.

Së nënti, duke kaluar në një kuadër çështje të tjera që lidhen më afër me ekonominë. Projekti im është krijimi i bursës së Tiranës, si një institucion ekonomik-financiar mjaft i rëndësishëm për menaxhimin e formave të reja të biznesit dhe bashkëpunimit mes njëri-tjetrit. Kështu afrohet qytetari më pranë jetës dhe fitimit ekonomik sepse në integrimin që synojmë të arrijmë nuk ka metropol pa të paktën një bursë.

Së dhjeti, do të ketë ulje të ndjeshme të kërkesave formale në lidhje me projektet e ndryshme të biznesit, dhe rritje të numrit të subvencioneve. Gjithashtu është e rëndësishme të organizohet çdo muaj një minipanair nga bashkia ku të gjitha bizneset bëjnë të njohur shërbimet e tyre, me përfaqësues të tyre dhe fletëpalosje dhe njëherë në tre muaj me vetë produktet të paraqitura.

Së njëmbëdhjeti, një tjetër problem është ai i tregjeve të hapura, të cilëve u nevojitet një rikonstruktim për kushte më të mira tregtimi. Gjithashtu do të kërkoj bërjen e

kontrollit më të shpeshtë për mënyrën se si tregtojnë, cilësinë dhe masën duke qenë një masë e domosdoshme për mbrojtjen e konsumatorëve dhe rritjen e ndëshkimit për ata që nuk i zbatojnë normat e vendosura.

Së dymbëdhjeti, projekti im ka hapjen e një qendre për kafshët e braktisur, të cilat enden në rrugët e Tiranës, gjë që nuk është e mirë as për qytetarët as për kafshët, që nuk e kanë mjedisin e tyre në rrugët e një qyteti. Mbasi të mblidhen atje kurohen nga shërbimi veteriner pranë bashkisë dhe në këtë mënyrë çdo qytetar mund të vijë dhe të blejë atje një kafshë shtëpiakë në qoftë se kjo është dëshira e tij.

Së trembëdhjeti, një nga ambjentet më të veçanta të Tiranës dhe i vetmi i këtij lloji, kopshti zologjik, është në gjëndje realisht të mjerueshme, jo vetëm për numrin e kafshëve që ndodhen atje, por edhe për kushtet në tërësi të funksionimit të tij. Plani im përfshin një rikonstruksion të mjedisit, ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për rritjen e tyre dhe shtimin e numrit duke e shndërruar si çdo kopsht tjetër në perëndim, ku dhe turistë qytetarëve të Tiranës gjejnë një vend interesant për të vizituar.

Së katërbëdhjeti, ky plan i imi nuk mund të realizohet vetëm me vullnetin dhe angazhimin e plotë të bashkisë të Tiranës, por mund të zbatohet në kuadër të funksioneve të përbashkëta dhe atyre të deleguara dhe përfshin rikonstruktimin e linjës së trenave që nisin nga Tirana për një destinacion të caktuar. Kjo do të thotë shumë jo vetëm për transportin Tiranas, por transportin e Shqipërisë në përgjithësi. Gjithashtu ndërtimi i një treni elektrik do të rriste shumë efikasitetin.

Më duhet të shtoj, që çështjet të cilat nuk kanë një strategji në këtë projekt për një qeverisje të sukseshme dhe të frytshme vendore janë ato për të cilat unë kam gjykuar se kanë gjetur zgjidhjet e duhura gjatë këtyre viteve dhe ato të cilat janë në zgjidhje e sipër. Unë si kryetare bashkie, një nga parimet e punës sime do të kem vlerësimin e drejtë të punës që kanë bërë paraardhësit e mi për bashkinë e Tiranës dhe shtimin e mëtejshëm të "tullave" në ndërtimin e Tiranës Europiane.

Ky është një nga parimet, por jo i vetmi i cili do të ndihmojë dhe lehtësojë punën për kryeqytetin sepse kjo strategji që të kthehet në realitet do të mbështetet mbi parime dhe me besim në punën e kryer. I rëndësishëm është bashkëpunimin brenda bashkisë, por edhe bashkëpunimi me të gjithë aktorët e tjerë. Kjo lidhet dhe me zgjedhjen se si dhe në çfarë periudhe kohore do të zbatohen projektet, për të mos penguar njëri-tjetrin dhe realizimin sipas prioriteve që pak a shumë ruan listën të cilën unë e paraqita më lart.

Rritja e transparencës së çdo procesi duke e bërë çdo veprim të njohur për median vizive dhe të shkruar, gjithashtu për qytetarët, është e rëndësishme për një qeverisje të mirë.

Lufta kundër korrupsionit brenda sektorëve të bashkisë që unë drejtoj do të vazhdojë dhe kjo do të kryhet duke forcuar kontrollin e brendshëm dhe duke kërkuar një relacion të detajuar për kontrollet që kanë bërë dhe rezultatet e sugjerimet përkatëse për çdo çështje. Gjithashtu do i kushtoj vëmendje dhe do tregohem e gatshme për çdo informacion për kontrollin e jashtëm duke e parë edhe këtë si faktor të rëndësishëm kundër korrupsionit.

Dhe së fundmi, por jo nga rëndësia është përfshirja e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe ky parim duhet të qëndrojë në themel të çdo qeverisjeje të

mirë vendore, që udhëhiqet nga parimi i afersisë për sensibilitetet qytetare duke i shndërruar ato në vepra konkrete (parimi i subsidiaritetit).

Kjo do të reflektohet në hapjen e një zyre ku qytetarët do të paraqesin mendimet, projektet dhe problemet konkrete për rregullimin e Tiranës, të cilat do të vlerësohen maksimalisht. Gjithashtu ankesat e tyre për punën e administratës bashkiake do të merren parasysh dhe do të gjejnë zgjidhje në kuadrin e eleminimit të korrupsionit dhe konfliktit të interesave të punonjësve.

Në vazhdimësi, do të zhvillohet çdo muaj një anketim për të parë pakënaqësitë dhe problemet e qytetarëve. Kjo do të arrihet me bashkëpunimin me organizatat jo qeveritare dhe Fakultetin e Shkencave Sociale. Rezultatet e anketimeve do të studiohen, do të merren masat zgjidhëse dhe do të ruhen si etalone matëse për më vonë për punën e bashkisë dhe kërkesat qytetare.

Qytetarët gjithashtu do të kenë të gjithë shërbimet që kanë pasur deri sot, normalisht me angazhimin tonë për të rritur efikasitetin dhe shpejtësinë e të gjitha veprimeve, që ata kërkojnë nga bashkia e tyre, si institucioni përfaqësues më afër tyre.

E gjithë kjo nuk është gjë tjetër vetëm një projekt jo shumë i detajuar por duhet më shumë punë për drejtimin e bashkisë së Tiranës dhe arritjen e rezultateve më të mira të mundshme. Jam e ndergjegjshme se gjithçka varet mbi të gjitha nga vullneti, aftësia, organizimi dhe besimi në të gjithë procesin si një i tërë.

Ina Zhupa

Fakulteti i Shkencave Sociale

Tiranë

7. PËR NJË QEVERISJE TË MIRË VENDORE: SIKUR TË ISHA KRYETAR BASHKIE...

Të jesh apo të mos jesh! Kjo është çështja. Kanë thënë bashkëqytetarët e kontinentit tonë të vjetër Anglez disa qindrvjeçarë më parë.

Kjo pyetje shekspiriane vazhdon të jetë tejet aktuale edhe në ditët tona postmoderne dhe çështja në fjalë mund të sublumohej në sensin pikëpyetës: Të jesh apo jo Kryetar Bashkie?

Kryetar Bashkie në Mijëvjeçarin e Ri të Shqiptarëve, prijësa të botëkuptimeve mesjetare, të këtyre atletëve të dëshirës a po aq kundravajtës e atentatorë të vetvetes.

Për të qenë në rolin e administratorit të mbarëvajtjes qytetare në një qendër çfarëdo urbane të hapësirës shqiptare dhe për më tepër i një nyjeje të rëndësishme të konvergimit të një popullsie të konsiderueshme nevojitet një njohje e thellë dhe e detajuar e situatës dhe e tematikave të gjithanshme, që përbëjnë tërësinë e të përditshmes bashkëqytetare.

Mbyllja në Kristalin e qelqtë të “Pushtetit” nuk mund kurrsesi të çojë larg dhe mandatet e shtyra qoftë edhe në infinitet nuk do të jenë asnjëherë indikatorët realë të suksesit të politikave bashkiake.

I zgjedhuri në gradën më të lartë në administratën bashkiake, i cili për rrjedhojë pritet edhe të drejtojë në mënyrë që t’i ndryshojë gjërat për mirë, për në kahun e duhur, del që i ka pritshmëritë mëse të qarta para vetes në momentin kur ndenjësja e të parit të vendit qytetit në këtë rast është gati të ngrohet prej tij.

Fushata zgjedhore në kushte shqiptare njihet dhe jo rrallë vendosin në proporcion të lartë të tjera fakte veçmas programit konkret dhe personalitetit të “konkurrentëve” garues.

Pastaj dihet që: Të fitosh luftën është më e lehtë sesa të administrosh paqen.

Për të mos përfunduar si shumë “Ngadhënjyes” që kanë dështuar pikërisht në administrimin e postbetejës, kërkohet impenjim konstant në realizimin e programit parazgjedhor, azhornim fluent mbi zhvillimin e ngjarjeve në komunitet ditë pas dite dhe përgatitje për t’u përballur me çdo të papritur që qyteti të cilin banorët me votën e tyre ia kanë besuar këtij drejtuesi ofron.

Kjo do të thotë sërish që kontakti i vazhdueshëm me shqetësimet të cilët mendojnë qytetarët është një element i domosdoshëm i një politike koherente bashkiake.

Nuk është se kam parasysh të famshmën “gju më gju me popullin”, por një informim mbi ato që vërtet shqetësojnë banorët, për mungesat dhe minuset, për shërbimet e paofruara dhe keqpërdorimet, për arbitraritetin e mundshëm të nëpunësve dhe implementimin e zhdrejtë të projekteve bashkiake.

Sistemi Bashki-Banor dërrmohet pakthyesmërisht kur retë ndajnë njërin komponentët e kësaj lidhjeje të pandashme nga tjetri.

Është e qartë që projektet potenciale të fushatës zgjedhore kanë afatet e tyre dhe realizimi mundësisht në kohë i këtyre të fundit përbën një hallkë të një rëndësie domethënëse në mbarëvajtjen e politikave zhvilluese të administratës bashkiake,

por azhornimi i tyre me nevojat ditore të qytetit është një avantazh maksimal.

Një qendër e banuar ndryshon gjatë secilës ditë që kalon dhe aq më shumë bëhet e nevojshme koherenca realizuese një apo disa vite pas instalimit të drejtuesit të ri të institucionit në fjalë.

Një qytet është më i madh se një brez pemësh të mbjella apo se një rrugë e shtruar sado mirë, ai është në mundin e përditshëm të banorëve të tij për të kapërcyer përditshmërinë vështirësisht të përballueshme shqiptare, në baltën dhe gropat e kudondodhura, në ndotjen e pamatë ambientale, në trafikun e pakontrollueshëm, në cilësinë skarco të punimeve, në shpërdorimet e çfarëdolloji e kudo.

Fokusimi në implementimin cilësor dhe jo sasior të projekteve të financuara nga Bashkia është një pikë kardinale në një mirëfunksionim të mundshëm të këtij institucioni publik.

Një asfaltim që zgjidh njëkohësisht problemet e trafikut, zbut mbiqarkullimin në arteriet e qytetit, siguron qytetarin shofer a këmbësor, sidoqoftë taksapagues, për pacënueshmërinë e shëndetit të tij si fizik, si mendor dhe jo me më pak rëndësi, arrin të mos çahet e plasaritet për disa vjet, kjo po që vlen më tepër se shumë rrugica Televizivo-Elektorale.

Qyteti ka nevojë për veprim konkret të studiuar që të shërojë plagët që vërtetë qelbëzojnë organizimin e qendrës urbane.

Vitet dhe eksperiencia jetike e qytetarit janë ato që tregojnë sa një investim ka qenë fasadë apo në të kundërt ka pasur realisht efektivitet të prekshëm në komunitet.

Qyteti nevojitet të kihet parasysh që është një dhe unik në shumëtrajtshmërinë e përbërësve të tij, i bashkuar në ndasitë që e kanë formësuar si një instalim i banuar.

Është e qartë që do të ketë pashmangshmërisht zona të ashtuquajtura “të privilegjuara”, që do thithin për shkak të pozicionimit të tyre në kuadrin qytetar më tepër investime dhe këto janë ambientet qendrore me më shumë aktivitet kulturor, biznesi apo ku përqendrohen institucionet nacionale qeritare, sportive, shoqërore.

Është shumë më e udhës që çdo investim të jetë i mirëstudiuar, transparent për qytetarët që potencialisht do të jenë përfituesit e tij dhe e fundit por jo nga rëndësia, të jetë i plotë. Çdo iniciativë bashkiake nevojitet të jetë e plotësuar në secilin komponent të implementimit të saj me qëllim që t'i japë rajonit qytetar përthithës të investimit një zhvillim komplementar, që të përfshijë të gjithë nevojat e banorëve.

Nuk do ish e tepërt të shtoja që është mëse i nevojshëm rakordimi i veprimeve me të tjera shërbime publike për mospërplasje iniciativash, si famëkeqet dëmtime të pafundme të rrugëve që vijnë si pasojë e kablllove e tubacioneve që kohë pas kohe bëhen shkak i riçarjeve të asfaltit të porsashtruar.

Një investim bëhet një herë, është cilësor, e dëshmon veten në kohë, është transparent, fondet për të janë në dizpozicion të të interesuarve, ky investim i shërben realisht dhe madje nevojitet t'i facilitojë komunitetit dhe qytetit jetesën, sjell përmirësim të ndjeshëm të shërbimit të bashkisë kundrejt qytetarit, që në terren do të thotë që banori ka përfituar drejtpërdrejt nga kjo sipërmarrje.

Një bashki që punon për të shërbyer, plotësuar nevojat, përmirësuar dhe ngritur nivelin e jetesës së qytetarit të saj rrjedhimisht ka sukses dhe shpesh sukcesi është ekuivalent me një rimandatim.

Në atdheun tonë njihen mirë praktikat e 6-mujorëve revolucionarë nëpër institucione të ndryshme, ku nën efektin e pasigurisë së ruajtjes së postit uria për gllabërime korruptive arrin kulme të pamendueshme.

Një administratë e mirëperzgjedhur, e mirëmotivuar, e mirëdrejtuar, e mirëfokusuar në zbatimin e projekteve bashkiake, një administratë e mirëkontrolluar po aq sa dhe e mirë stimuluar për të kontribuar në punë, pra një administratë e suksesshme në shërbim të bashkëqytetarëve ka shumë shanse të gjejë rikonfirmim nga vota në zgjedhje.

Do të ishte jo pak e udhës që një pikë e pakthyeshme e fushatës elektorale të ishte edhe angazhimi permanent i nje firme kontrolluese të bilanceve që të atashohej pranë kandidatit më pas të zgjedhur, që çdo vit qeverisjeje vendore të bënte revizionin e institucionit dhe të paraqiste rezultatet për publikun e gjerë.

Çdo investim, projekt a vendim do të kalonte në sitën e kësaj firme dhe i gjithë procesi do ishte i hapur me pjesëmarrjen edhe të vëzhguesve të tjerë po të ishte nevoja.

Transparenca nuk ka çmim, korrupsioni nuk ka kufinj të masave për ta luftuar dhe besimi i qytetarit është i shenjtë.

Secili shërbim që bashkia ofron ka si qëllim qytetarin por në eksperiencën tonë gati 17-vjeçare pluraliste kemi hasur në injorimin total të interesave dhe zërit të tij.

Shpesh projektet kryhen, përfundohen dhe prezantohen duke iu imponuar banorit dhe pa e kaluar aspak largësisht në mendje për t'i marrë atij qoftë edhe formalisht mendimin lidhur me temën në fjalë që supozueshmërisht atë e prek direkt.

Nuk dua të shkoj aq larg sa të propozoj referendimet tejet demokratike të bashkësisë helvetike por nga koncepti i tyre origjinal leksione edhe mund të nxirren.

Ajo që ka rëndësi është që qytetari të këtë peshë në vendimmarrje, të thotë fjalën e tij dhe institucioni bashkiak këtë ta ketë në konsideratë të vecantë, madje prioritare.

Edhe një rruginë e largët periferike kur të shtrohet, më parë banorët vendas nevojitet të jenë dëgjuar dhe madje t'u jepet mundësia të mbikqyrin mbarëvajtjen e punimeve duke pasur të drejtë vetoje në rastin e vënies re të abuzimeve në investim.

Qyteti nuk do të jetë shija unike e të zgjedhurit të tij me gradën më të lartë, por fryt i shijes së përgjithshme të qytetarëve të tij, që jo përherë janë një element unik në çështje shijesh e finesash lidhur me zhvillimin e qytetit dhe lagjeve të tyre.

Duke kaluar më konkretisht në çështje edhe më të prekshme elementi mjedisor nevojitet të zërë medoemos një sferë qendrore të interesit bashkiak.

Dhe këtu investimet konkrete, cilësore, të plota, të mirëstudiuara, që përmirësojnë gjendjen e pashpresë të trafikut bëhen edhe më akute duke parë burimin parësor të ndotjes që ky përbën.

Parqet, lulishtet dhe zonat e gjelbëruara publike nevojitet të konsiderohen të rëndësishme së veçantë dhe hapësirat e gjelbra të vlerësohen dhe të synohet shtimi dhe jo më thjesht ruajtja e tyre, aq më keq reduktimi i mundshëm.

Është madje e mundur që sidomos kur bëhet fjalë për kryeqytetin, situata mjedisore të konsiderohet si shpërthyesë si edhe është de facto dhe de jure të shpallet së paku nga ana e Bashkisë gjendja e "jashtëzakonshme" mjedisore në qytet.

Corpus delicti i krimit mjedisor nuk është e vështirë të gjendet: Trafiku, lëndët djegëse dhe automjetet jociësore si dhe ndërtimtaria e shfrenuar.

Mënyra për t'u përballuar me të ekziston, nevojitet të ekzistojë po aq edhe dëshira për t'a bërë!

Gjendja e "jashtëzakonshme" ambientale në qytet do i jepte bashkisë tregues për t'u përballuar me fenomenin edhe jashtë kapaciteteve të tij, por gjithashtu do i jepte edhe qytetit kredon e duhur për t'a zbritur edhe qeverinë qendrore që edhe ajo të përballlet me këtë shqetësim madhor, jo pak jehonë ky akt do kishte edhe tek donatorët e ndryshëm ndërkombëtarë që do të sensibilizoheshin dukshëm nga një veprim kaq i fortë i administratës bashkiake.

Trafiku mund të zbutet me investime më konkrete që e largojnë më së fundi unazën nga qendra, zgjerojnë kryqëzimet e mbipopulluara, që jo rastësisht përbëjnë zonat më të ndotura dhe i bëjnë firmat ndërtimore që veprimet t'i përqendrojnë natën kur banorët nuk qarkullojnë në qytet.

Nuk janë vetëm këto zgjidhjet por së pari një fokusim në këtë çështje thelbësore të qytetit që prek drejtpërsëdrejti çdo pjesëtar të komunitetit dhe një angazhim me rreze sa më të gjerë përfshirjeje.

Ka një kategori personash që rregullisht vuajnë në lidhje me transportin urban, këta janë pensionistët.

Shpesh është folur dhe ka patur iniciativa të veçanta për t'u mundësuar atyre një transport falas por dëshira ka rënë në ujë.

Bashkia dihet që disponon mundësinë për të liçencuar kompani private që kryejnë këtë transport. Një zgjidhje e thjeshtë do ishte që kusht për liçencimin të ishte që kategori si veteranët, pensionistët, invalidët të udhëtojnë falas.

Kështu në vizionin tim funksionon një Bashki moderne, që e ka të qartë funksionin e saj kundrejt bashkëqytetarëve, e cila ka një projekt të saj konkret zhvillimi për qytetin, e cila i ka dyert e hapura për këdo, e cila jeton mes komunitetit dhe informohet përditë për shqetësimet e tij, një bashki të cilën banori e njeh dhe nuk e koncepton si një objekt të largët abstrakt, por si një partner në zhvillimin e qytetit.

Bashkia është rregullatori i ekuilibrave të brishta të qytetit, është institucioni iniciues i projektit zhvillues të së tashmes dhe hedhësja e piketave për një qytet modern të së ardhmes kur synohet që me anë të punës së nisur që tani kushtet e jetesës për banorin të përmirësohen dhe ku ambienti vital i komunitetit të jetë transformuar në atë që ëndërrojmë, por që në sajë të punës konkrete ditë pas dite mund të arrijmë në një simbiozë të pandashme funksionale bashki-komunitet.

Qyteti është i të gjithëve, e ardhmja po ashtu, bashkia dhe kryetari i saj nuk janë veçse një ingranazh në realizimin e një projekti të madh, që synon t'a çojë banorin dhe modus vivendi-n e tij tek e ardhmja.

Sikur të isha kryetar bashkie me siguri kjo do të ishte filozofia që do të më drejtonte në rrugën time.

Elvi Caka

Tiranë

8. PËR NJË QEVERISJE TË MIRË VENDORE: SIKUR TË ISHA KRYETARE BASHKIE NË ELBASAN

Sikur të isha kryetare bashkie në qytetin tim të lindjes Elbasanin, vëmendja ime do të përqendrohej në disa çështje, të cilat unë i konsideroj shumë të rëndësishme për çdo bashki në mënyrë që të funksionojë mirë. Pikat kryesore të zhvillimit të strategjisë sime si kryetare bashkie do të ishin: menaxhimi i drejtë i buxhetit bashkiak, fuqizimi i sektorit privat, sipërmarrjes së lirë në ofrimin e shërbimeve dhe decentralizimi i pushtetit.

Kushtetuta dhe ligjet më të rëndësishme të shtetit shqiptar në parim bëjnë ndarjen e kompetencave qeverisëse ndërmjet pushtetit qendror dhe atij vendor, ndarje kjo e cila lë shumë pikëpyetje nga pas dhe prodhon abuzime të mëtejshme dhe probleme të pazgjidhura nga ekzekutivi në nivel qendror dhe vendor.

Pra nëse zgjidhim delegimin e përgjegjësive dhe vetë madhësinë e shtrirjes së shtetit në ofrimin e shërbimeve, mallrave apo në ndërhyrjet e tij në ekonomi, problemet që ka një pjesë e mirë e shoqërisë shqiptare sot, do të merrnin rrugën e zgjidhjes. Aktualisht, pushteti qendror ka shumë nga përgjegjësitë, madje edhe detyrat që ai vendor dhe veçanërisht sektori privat do t'i kryenin me më shumë efektshmëri.

Në këtë mënyrë nga procesi i decentralizimit do të përfitonte mjaft bashkia e cila do të merrte nën përgjegjësinë e saj ato shërbime që vuajnë shumë nga mungesa e investimeve nga pushteti qendror si për shembull arsimit, shëndetësia dhe mbrojtja e mjedisit.

Të fillojmë me radhë. Decentralizimi është primar në projektin tim, jo vetëm si shkak i dështimit të politikave qendrore në fushat e përmendura, por edhe si nevojë e uljes së kostos dhe rritjes së cilësisë së ofrimit të shërbimeve.

Do të jetë detyrë e pushteti vendor të investojë në arsimin publik, por ndërkohë do të ketë mjaft lehtësime për fuqizimin e arsimit privat, i cili tanimë ka filluar të ofrojë shërbimet e tij në perputhje me kërkesat gjithmonë në rritje të tregut. Demokracia nuk mund të pranojë shprehje të tilla të tipit “një masë për të tërë”, ku konsumatorët u binden limiteve, kufizimeve të shërbimeve të ofruara nga një burim i vetëm. Ata duhet të jenë të lirë të zgjedhin cilësinë e kërkuar që përputhet me nevojat e tregut dhe vetë qellimet e kërkesat e tyre.

Ndërkohë arsimit parauniversitar, i cili do të menaxhohet/mbikqyret nga bashkia do t'i përshtatet edhe ai tregut dhe do të ketë autonominë e tij për të zgjedhur biznesin privat apo donatorët e ndryshëm që do të përmbushin nevojat e tij (investime në strukturë, laboratore, uniforma, etj.) Një nga stimujt që do të japë bashkia për të nxitur arritjet e bashkëqytetarëve do të jepen bursat që do t'u jepen nxënësve më të mirë të qytetit.

I njëjti projekt vlen edhe për shëndetësinë. Elbasani vuan nga degradimi i këtij shërbimi i cili për shkak të të qenit shtetëror dhe nën qeverisjen qendrore vuan mungesën dhe keqmenaxhimin e fondeve, rrit koston në buxhetin e shtetit dhe ofron shërbim me cilësi të ulët. Investimet e kryera deri tani kanë ardhur nga donatorë të

huaj, pra është më se e qartë se qendrori nuk mund të zgjidhë problemet. Zgjidhja e vetme është kalimi i shërbimit nën mbikqyrjen e pushtetit vendor dhe ashtu si edhe në fushën e arsimit, mbështetja e sektorit privat. Një pjesë e shëndetësisë ka arritur të integrohet plotësisht në ekonominë e tregut. Stomatologjia është evidenca konkrete e suksesit të sipërmarrjes së lirë dhe prova se shëndetësia, ashtu si edhe çdo shërbim tjetër cilësor ka nevojë për konkurrencë që të zhvillohet dhe të përmbushë nevojat e klientit. Sigurisht që nuk mund të pretendohet kalimi i menjëhershëm nga shtetëror në privat, por është e sigurtë se drejt atij rezultati do të shkojmë.

Për sa i përket politikave të ambjentit, Elbasani është përsëri prova më e mirë e dështimit të politikave qendrore në këtë drejtim. Përvec kësaj, bashkia është lënë tërësisht jashtë këtij procesi, duke lënë çdo përgjegjësi në duart e një nëpunësi të vetëm në prefekturë, gjë që e bën të pamundur mbikqyrjen e zbatimit të ligjeve për respektimin e ambjentit. Decentralizimi do të sjellë formimin e një komiteti me specialistë të fushës nën kompetencat e bashkisë, i cili do të kontrollojë situatën dhe do të ketë pushtet në vendosjen e taksave apo gjobave/sanksioneve kundrejt atyre subjekteve të cilat shkelin ligjet e mbrojtjes së mjedisit dhe kontratat e nënshkruara edhe me pushtetin vendor. Pastrimi i qytetit, shërbim i cili ka nisur t'u ofrohet, do t'i kalojë edhe ky sektorit privat i cili do të konkurrojë në bashki për të pasur të drejtën e ofrimit të këtij shërbimi qytetarëve të Elbasanit. Do të jenë pikërisht këto kompani komplekse pastrimi/mirëmbajtjeje, që do t'i kthejnë Elbasanit lulet, parqet publike dhe mirëmbajtjen e monumenteve të kulturës.

Ndër problemet më të prekshme të popullsisë mbetet procesi i regjistrimit civil. Ky proces do të kryhet në një kohë të shkurtër nëpërmjet kompjuterizimit të të gjitha zyrave të gjendjes civile. Kostoja financiare e projektit është lehtësisht e përballueshme nga buxheti bashkiak pasi dhe numri i këtyre zyrave është i vogël. Regjistrimi më në fund do të bëjë të mundur studimin e popullsisë, veçanërisht, do të ndihmojë në rishpërndarjen e drejtë të hartës së përkrahjes sociale, duke e përmirësuar ndjeshëm shërbimin dhe duke shmangur abuzimet e shumta dhe humbjet e mëdha që vinin si shkak i keqmenaxhimit të fondeve të përcaktuara nga buxheti.

Një ndër projektet më të rëndësishme të mandatit do të jetë përpjekja për miratimin e ligjit të sigurimit të shëndetit dhe pronës së çdo shtetasi në kompani private të sigurimit. Kjo do të shënonte një ndryshim tërësisht të nevojshëm dhe mjaft efektiv. Më në fund qytetarët nuk do të varehin kaq shumë nga shërbimet e administratës, të cilat përvec faktit të kostos tepër të lartë dhe të papërballueshme që i faturojnë buxhetit shtetëror (nga harxhimet për çdo vizitë mjekësore të qytetarit deri tek dëmshpërblimi për dëmtimin e shtëpisë në rast të një fatkeqësie natyrore), përballen edhe me shërbime jocilësore dhe shumë herë pre e burokracive të vonuara.

Elbasani, aktualisht ka tre ambjente sportive, stadiumi "Ruzhdi Bizhuta", pallati i sportit "Tomorr Sinani" dhe fusha e vjetër e sportit, të treja këto janë nën menaxhimin e bashkisë. Fakt është se asnjë nga këto ambjente nuk përmbush as standardet minimale të kërkuara ja pse ato do të kalojnë nën menaxhimin e kompanive private, të cilat do të ofrojnë shërbimin dhe do të kontraktohen nga bashkia. Shembujt kanë treguar se përfshirja e sektorit privat në dhënien e shërbimeve nuk bën gjë tjetër veçse përmirëson situatën. Kompanitë detyrohen të ofrojnë shërbime me cilësi gjithmonë e më të larta në mënyrë që të zgjasin kontratat me bashkinë dhe të ruajnë kështu vendin e tyre të punës. Sallat bashkëkohore sportive do të tërheqin kompeticione

kombëtare dhe ndërkombëtare, si rrjedhim, fuqizim të skuadrave vendase, rritje të numrit të fansave dhe shumë më shumë të ardhura në buxhetet përkarëse si të klubeve edhe të vetë bashkisë.

Fatmirësisht, sektori privat ofron me sukses shërbime të tilla si: transporti urban, furnizimi me ujë të pijshëm dhe shërbimi funeral i cili e ka shpëtuar bashkinë nga “turpi” i të ofruarit të shumave indinjuese për mbulimin e kostos financiare të procedurave zakonore në respekt të fatkeqesisë së ndodhur.

Bashkia që unë do të drejtoj do të ketë prioritet hartimin dhe miratimin e planit rregullues të qytetit, në bazë të të cilit do të jepen lejet e ndërtimit subjekteve të ndryshme si dhe fillimi i investimeve si nga bashkia ashtu edhe nga kompanitë private, të ndërtimit të rrugëve kryesore dhe dytësore, duke afruar qytetin me tregjet e tjera dhe duke mënjanuar efektin “bulevard” dhe qendërsor të politikave të ndërmarra.

Arritja më e madhe në infrastrukturë do të jetë ndërtimi i rrugës Ellbasan – Tiranë me tunel dhe sistemimi i shtratit të ujërave të lumit Shkumbin. Investime që do të përfshijnë fonde dhe donatorë të ndryshëm dhe që do të merren përsipër nga kompanitë që do të dalin fituese në tenderat ndërkombëtare (për nga rëndësia e investimeve) që do të zhvillojë bashkia. Vlen të përmendet se afrimi me Tiranën do të hapë prespektiva të reja për zhvillimin e mbarë rajonit.

Politikat e ndërmarra nga bashkia do të mbështesin ndër të tjera zhvillimin e bizneseve të vogla duke liberalizuar mjaft dhënien e liçencave, duke shmangur burokracitë e panevojshme dhe duke ulur taksat për bizneset e reja. Këto politika do të krijojnë një ambient optimal për zhvillimin e iniciativës së lirë, afrimin e investitorëve vendas e të huaj, si rrjedhim uljen e ndjeshme të papunësisë.

Përsa i përket strukturës së brendshme funksionuese të vetë bashkisë së Elbasanit, edhe ajo do të zbatojë politikat e decentralizimit të pushtetit nga hegjemonia e sotme e kryetarit në departamente të caktuara dhe drejtuesit e tyre, të cilët do të ndajnë dhe balancojnë përgjegjësitë, detyrimet dhe pushtetin, që sot gëzon vetëm kryetari i saj. Ndarja do të jetë në tre sektorë: Punë publike, Financë dhe Burime njerëzore. Ideja e kësaj është jo vetëm decentralizimi i pushtetit brenda qeverisjes vendore por edhe ndarja e punëve politike nga ato menaxhuese. Një ndarje e tillë garanton zhvillimin e pavarur dhe të suksesshëm të programit të qeverisjes vendore edhe në raste krizash politike të përcjella nga lart apo edhe brenda për brenda bashkisë.

Pra për ta mbyllur, bashkia e Elbasanit nuk do të merret me ndërtimin e pallateve, por do të liçencojë firmat e ndërtimit; nuk do të nxisë rritjen e përkrahjes sociale, por do të mbështesë iniciativën e lirë private, e cila do të na bëjë më të pavarur nga tendenca e natyrës sonë njerëzore, gjithmonë në pritje të qeverisjes qendrore për të na zgjidhur probleme të cilat ne vetë kemi aftësi dhe mundësi t’i zgjidhim me kosto shumë më të ulët dhe cilësi më të lartë.

Iliada Korçari

Elbasan

9. PËR NJË QEVERISJE TË MIRË VENDORE SIKUR TË ISHA KRYETAR BASHKIE ...

Sistemet e qeverisjes gjithnjë vihen përpara disa “sfidash” të zhvillimi. Me rënien e Murit të Berlinit psikologjia e qeverive të Europës Lindore dhe Qendrore filloi të ndryshojë duke u përshtatur me “psikologjinë” e ekonomisë së tregut. Qeveritë, në këtë mënyrë bëhen ofrues të atyre shërbimeve që konsumatorët (qytetarët) kërkojnë dhe që nuk mund të ofrohen nga sektorë të tjerë. Meqenëse kërkesat janë në zhvillim të vazhdueshëm qeveritë reformojnë shërbimet e tyre.

Mendoj se “sëmundjet shërohen duke luftuar shkaqet dhe jo pasojat”, që në vetvete përben dhe vizionin tim. Strategjia ka të bëjë me dy aspekte kryesore, rritja e pjesëmarrjes në vendim-marrje dhe informatizimi sa më i shpejtë i shoqërisë.

Informimi publik

Në ditët e sotme, niveli i burokracisë është relativisht i lartë, dhe një ndër ankesat e qytetarëve është se mënyra e funksionimit të qeverisjes është shumë e “largët”. Shpesh, kjo e bën një qytetar të ndihet i “paaftë” për t’u vënë në kontakt me politikbërësit që ai ka zgjedhur. Për më tepër, volumi i informacionit të nxjerrë nga nivelet e qeverisjes është i tillë, që kërkon një përpjekje shumë të madhe për ta ndjekur. Për këtë, mendoj se duhet të ketë disa pika informacioni (të cilat mund praktikisht të zbatohen me kosto minimale). Këto pika, të cilat do të ndodheshin në vende publikisht të aksesueshme, do të shërbejnë si pika shpërndarjeje informacioni. Gjithashtu mund të shërbenin si qendra për pagesat e taksave dhe ndër funksionet më të rëndësishme do të ishte ofrimi i shërbimit të internetit, për të marrë dhe dërguar mesazhe me institucione publike. Kjo është ajo që do të shërbente për këshillimin specifik të qytetarëve. Për të nxitur punësimin rinor, mund që studentët të bënin një konkurs, për të qenë “menaxherë” të këtyre departamenteve, por për një periudhë të përcaktuar kohore (jo më shumë se tre muaj).

Parandalimi i konflikteve ndër-vendore

Mund të ndodhë, që gjatë ushtrimit të kompetencave, të ketë një përplasje politikash vendore me ato qendrore dhe anasjelltas. Për këtë, mendoj se duhet të ekzistojë e drejta e “Njoftimeve të Drejtpërdrejta të Paralajmërimit” (NDP), që praktikisht është si një karton i verdhë gjatë një ndeshje futbolli. Pra, kur organet e nivelit vendor mendojnë se vendimet që vijnë nga një organ i nivelit më të lartë çenojnë interesat e tyre, ata mund të dërgojnë NDP-në, e cila do e detyronte organin e nivelit më të lartë, që ose të jepte një material të gjatë shtesë ku shpjegohet vendimi i tij dhe përse nuk mund të konsiderohet në kundërshtim me nivelin më poshtë ose kjo NDP mund të çojë në rishqyrtim të menjëhershëm të vendimit. NDP funksionon në të dyja kahet. Kjo do të shërbente për të evituar proceset gjyqësore, të cilat kanë jo vetëm kosto monetare, por edhe kosto kohore.

Transparencë institucionale

Mendoj gjithashtu, se të gjitha organet nën varësinë direkte të njërive vendore, të kenë në krye të tyre një person të zgjedhur me votim nga punonjësit e atij organizmi. Funkzioni kryesor i tij do të ishte monitorimi i funksionimit të organit që e ka zgjedhur. Duke pasur akses të plotë në dokumentat e organit, ai do të ketë një lidhje direkte me pikat e informacionit dhe mund të lehtësojë mënyrën e shpërndarjes së informacionit. Në këtë mënyrë, do të ketë një shpërndarje të specializuar të informacionit dhe do të ketë kontroll mbi punën e kryer nga një organ. Faktikisht, ekziston mundësia që personi i zgjedhur të mos e kryejë ashtu siç duhet punën e tij “funksioni i rojes”, por për ta kontrolluar atë mund të caktohet kryetari i njësisë vendore, që do marrë në një farë mënyre edhe rolin e “rojes së rojes”. Personi i zgjedhur, përveç funksionit të “rojes”, mund të shërbejë edhe si një ombudsman i specializuar përballë publikut të gjerë.

Rritja e pjesëmarrjes në vendim-marrje

Në lidhje me problemet ekonomike, mendoj se do të ishte mirë, organizimi i një nisme (referendumi) ku të jenë vetë qytetarët që përcaktojnë mënyrën e parapëlqyer të shpërndarjes së shpenzimeve publike. Kjo nuk do të thotë që do të vendosin qytetarët se si do të shpërndahet buxheti i parashikuar, pasi ky është një proces delikat që ka si prioritet nevojat relative të një njësie vendore. Natyrisht që do të kishte apriori një fond rezervë për rastet e fatkeqësive natyrore, emergjenca kombëtare etj.

Kësaj nisme (referendumi) mund t'i jepej edhe një aspekt tjetër. Qytetarët, mund të aprovin apo jo një projekt – buxhet vendor dhe njëkohësisht të votonin për ato prioritete që ata mendonin.

Problemi i edukimit, jo gjithnjë mund të zgjidhet nga një institucion i specializuar. Rishikimi i teksteve mësimore është një zgjidhje afatshkurtër. Njerëzit kanë prirjen të kenë një pamje të kufizuar të objekteve “politike,” për t'i katandisur çështjet politike në “propagandë politike”, për të mos qenë të ndërgjegjshëm për politika, programe, ide, parime, çështje, debate mbi çështje dhe mënyra për t'u përballur me probleme aktuale. Për pasojë, janë të prirur për të patur një vizion përkeqësues për politikën.

Unë besoj që një përjasje më e mirë do të ishte që qytetarët të edukoheshin për pjesëmarrje reale në politikë – sikurse ajo ekziston në të vërtetë dhe jo siç duhet të jetë. Kjo do të kërkonte që studentët, në çaste të ndryshme gjatë edukimit të tyre, të vendoseshin në kontakt të drejtpërdrejtë me përfaqësues, që veprojnë në rolet e tyre të zakonshme qeverisëse. Theksi duhet të vendoset mbi “të mësuarit përmes përvojës” në vend të “të mësuarit nga manualët”. Nxënësit më të rinj mund të caktohen për të shërbyer për një apo dy ditë si “ndihmës” për politikanë vendorë apo aktivistë në parti, shoqata apo lëvizje.

Ani Koxhaku

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Ekonomisë

Tiranë

10.

“Është sa e guximshme, aq edhe ngazëllyese të kuptosh se “e ardhmja” qëndron jo në forcën e liderëve karizmatikë, por në duart e shtetasve të përgjegjshëm.

Qytetarët e mi të Tiranës sot më ka dhënë stafetën për t'i qeverisur. Është intrigues fakti që unë kam në dorë të ardhmen e qytetit tim. Të gjithë më kanë besuar dhe unë duhet të bëj patjetër dicka për të përmbushur qëllimin dhe vizionet e mia për këtë qytet.

Shtetet e sotme moderne sa vijnë e fokusohen më shumë ndaj qeverisjes vendore, e cila ka një rol efektiv ndaj komunitetit.

Është privilegj, nder, arritje, por edhe sakrificë të jesh lider i metropolit Shqiptar-Tiranës. “Duke qënë se ju bashkëqytetarë më dhatë çelsat e Tiranës, unë do t’ju hap portat e një qyteti që ju gjithnjë keni dëshiruar.”- Shumë kush e thotë këtë me fjalë, unë kam rastin ta shpreh këtë me vepra.

Personaliteti i një individi vlerësohet fillimisht në faktin se sa qytetar, nuk mund të kete qytet pa qytetarë, qytet pa qytet.

Përpara meje shtrihet qyteti im, qyteti ku çdo ditë kanë rënduar hapat e paraardhësve tanë, të prindërve tanë e sot së bashku me hapat e prindërve tanë kanë filluar edhe hapat tanë të cekin bulevardet dhe rrugët e këtij qyteti.

Në një rikthim në kohë, pashë veten time foshnjë, e shtrirë në një konsultore që në një shtet tjetër të botës do t’i vihej në mur kalendari i viteve ‘60, e njëjta konsultore edhe sot..., pajisje të amortizuara, ambjente të vjetra, e aq më tepër me nëna të reja të painformuara. Personaliteti i një individi krijohet që në momentin kur ai lind dhe në ambjentin ku ai rritet, arsimohet dhe edukohet.

Kapin vlerat minimale shpenzimet që duhen për specializimet dhe restaurimet e konsultoreve për lagjet përkatëse. Të bëhesh prind në metropol dhe pa e ditur çfarë do të thotë i tillë është ironike. Sot prindërit duhet ti largohen jetesës “primitive”, duhet t’i nënshtrohen konsultimeve dhe trajnimeve për planifikimin familjar si dhe të jenë të përgjegjshëm si prindër dhe si ti mbrojnë fëmijët e tyre nga sëmundje të ndryshme.

Ky fëmi do të rritet dhe nuk dua të ketë të njëjtin fat me mua që park lojrash dija parkun e liqenit dhe stola dija gurët e lagjes sim. Shëtitja me gjyshen për mua ka qenë deri tek dyqani i embëlsirave, nuk dija çfarë ishte një stol, një park.

Çdo lagje, çdo komunë sikurse me iniciativën e kryetarëve të saj, sikurse me një takse 50 lekëshe për familje në muaj, do mund të kishte brenda vitit një stol dhe një park më shumë, një jetë më tepër. Jeta qytetare nuk është thjesht një park në lagje, në spital apo në shkollë, e duke qenë tek kjo e fundit, hapat e parë drejt qytetarisë hidhen në shkollë. Është ironike të shohësh ambjentet ku edukohen qytetarët dhe personalitetet e një kombi. Duhet të heqim dorë duke u marrë taksa nxënësve për ekskursione, është koha që çdo nxënës të paguajë një taksë modeste mujore prej 50 lekësh në mënyrë që të përmirësohet ambjenti ku studiojnë.

Këta nxënës do të rriten, do të zgjedhin rrugë të caktuara, e duke ngelur brenda konceptit rrugë, jo të gjithë kanë fatin të jetojnë në qendër të Tiranës, dikush jeton në periferi, por punën e ka në qendër. Ai është i detyruar të paraqitet në punë me vonesë, i veshur

zyrtar por me motive moderne me njolla balte në këpucë e veshje. Pse? Qytetin nuk e bën vetëm qendra, rrugët e së cilës të çojnë në periferi. Qyteti është mishërimi i një shtëpie ku çdo dhomë dhe cep i saj ka vlerën e vet, e sikur një nga këta elementë të mungojë, atëherë nuk do të quhej shtëpi, e njëjta gjë ndodh edhe me qytetin. Të gjithë premtojnë shumë rrugë të reja, të rikonstruara, të shtruara. Çdo lagje ka një investitor, çdo lagje ka minimumi një qytetar. Kryetarë mos i bëni miq këta të fundit për interesat tuaja personale, por për interesat e qytetit tuaj. Nëse nuk do gjeni mbështetje të gjithë së bashku do punojmë për të arritur të bëjmë dicka të vlefshme, duke mos lejuar të na zërë gjumi në kolltukun e zyrës dhe të futemi në ëndërrime se ku do donim të ishim duke e pirë kafën në atë moment apo sa shifra pas zeros do të kishte llogaria jonë bankare.

Diku në një stol ka ngelur një gjyshe, e pastrehë ku për çati ka qiellin e për shtëpi natyrën. Bisnesmenë të dashur, qytetarë të nderuar, fëmijë të rritur kontribuoni për prindërit tuaj, për ata që sot ju jeni. Azili është fjalë shumë prekëse, mua më kujton persona të moshuar, që rrinë në shpresën e kujdestarëve për një pjatë gjellë të ndenjtur e flenë në një krevat “burgu” sikur të ishin të dënuar që ju sollën në jetë. Është koha të mos vazhdojmë në “rrjedhën e ujit të turbullt”.

Sa të rinj janë të punësuar? E sa të tillë frekuentojnë kafet në cdo orë ? Sa të rinj kanë shpirt vullnetari dhe sa të rinj dinë çfarë është vullnetarizmi dhe çfarë përfitojnë prej tij? Vullnetarizmi është kulturë qytetare. Do të krijohet zyra e vullnetarëve të rinj në bashki, të cilët përveç se do kontribuojnë në procesin e mbajtjes pastër të qytetit do të motivohen që të përfshihen edhe në evenimente akoma më të rëndësishme si qytetaria aktive, përfshirja sociale, lidhshipi, sipërmarrja. Këshilltarët e mi më të afërt përveç profesionistëve të talentuar dhe të zotë, do të jenë edhe një grup të rinjsh të cilët do të jenë zëri i të gjithë të rinjve të Tiranës. Ata do të punojnë dhe do të mendojnë për një jetë aktive për të rinjtë shqiptarë. Në çdo zyrë të bashkisë do të ketë hapësirë për të punësuar sikurse edhe si vullnetarë të rinjtë.

Kjo organogramë do jetë në çdo minibashki të qytetit tim, ku do të ketë akoma më shumë hapësira për qytetarët dhe për pakënaqësitë apo problemet që ata hasin. Secila minibashki do ketë politikat e saj, por gjithnjë në kuadër të përmirësimit të jetës së banorëve të saj. Për të mos harruar edhe qendrat e këshillimit të karrierës pranë bashkisë ku do jenë të mirëpritur profesorë e studentë që të jenë bashkëpuntorët tanë.

Shumë lehtësira do të ketë për transportin publik, ku personat e moshuar, invalidët dhe studentët nuk do të paguajnë. Në çdo stacion autobuzi do ketë nga një tryezë të vogël informacioni ku të rinjtë do të jenë punonjësit që do të ofrojnë guida të qytetit të Tiranës Tirana do jetë liderja e rrjetit të bashkive të gjithë Shqipërisë e antare e rrjeteve të bashkisë së Europës.

Unë nuk to të kem sukses që në fillim për çdo gjë që synoj. Në fakt, sa më shumë të tentoj, aq më të mëdha janë shanset që të humbas. Humbës ose jo, unë dhe ti bashkëqytetar do të vazhdojmë të jemi fitimtarë “Optimizmi është luks, pesimizmi nuk shkon përpara, unë jam thjesht realiste”.

Mirësevini në Tiranë!

Erveina Bashuri

Universiteti i Tiranë

Fakulteti i Drejtësisë

11.

“Ne duhet të bëhemi ndryshimi që duam të shohim,” thoshte Mahatma Gandhi. Filozofia e Gandit mund të qeverisë gjithsecilin individ apo bashkësi njerëzish kudo në botë. Nëse duam të ndryshojmë veten, njerëzit përreth nesh, shkollën ku studiojmë, bibliotekën ku marrim dije, organizatat e ndryshme ku veprojmë ne mund t’ia arrijmë kësaj nëse kemi vullnetin dhe vizionin e duhur.

Qytetarët duhet të jenë pushteti i bashkisë. Bashkëbisedimi me ta duhet të jetë një forum i lirë pjesë e të cilit është kushdo që e ndien veten pjesëtar të këtij komuniteti. Qytetarët do të mundën t’i drejtohen në çdo kohë prej shtëpive të tyre shërbëtorëve të tyre në administratën e bashkisë nëpërmjet një numri telefoni në dispozicion të tyre. Qytetarët do të kenë forumet e tyre të shkëmbimit të ideve në radion e bashkisë.

Çdo aktivitet, punë, fond i përdorur, vendim i marrë do të bëhet publik dhe do të argumentohet para qytetarëve. Televizioni vendor do të japë gjithmonë programe që sqarojnë qytetarët për procedurat e zgjidhjes së problemeve të tyre. Qytetarët do të kenë mundësinë të bëhen pjesë e zgjidhjeve që do të kërkohen në televizionin lokal. Qytetarët do të kenë zërin e tyre në Forumin Qytetar pjesë e të cilit do të jetë një përfaqësues i çdo lagjeje i cili tre herë në muaj do t’u përgjigjet qytetarëve. Bashkia duhet të shkojë te qytetarët!

Administrata e bashkisë do të ketë specialistët më të mirë sepse metropoli është zemra e këtij vendi dhe duhet të rrahë me ritmin e kohëve moderne. Do të ftohen të punojnë bashkë me ne studentët e diplomuar në shkollat perëndimore. Ata kanë marrë medalje për rezultate e shkëlqyera në vendet ku kanë studiuar. Ne do t’i ftojme të marrin Medaljen e Qytetarit në atdheun e tyre. Do të ftohen të punojnë specialistët më të mirë të vendit, ata të cilët e dinë se kush janë plagët sociale të këtij qyteti, si ka qenë e shkuara dhe si do të jetë e ardhmja.

Administrata e bashkisë do të përmirësojë kapacitetet dhe aftësitë e veta nëpërmjet bashkëpunimit dhe shkëmbimit të vazhdueshëm të përvojave me bashkitë homologe perëndimore sidomos me ato bashki të cilat kanë problematikë të ngjashme sociale. Kësisoj ajo do të jetë efektive në kryerjen e punëve të përditshme dhe do të sigurojë nivelin më të lartë të ndershmërisë dhe integritetit në qeverisjen vendore. Marrëdhënia midis meje dhe administratës që do të drejtoj do të jetë më së pari e mbështetur në profesionalizmin dhe efektivitetin e punës. Marrëdhënia mes administratës së bashkisë dhe qytetarëve do të jetë e pandërprerë, mbështetur në ligjet në fuqi, e hapur, e drejtë, transparente.

Korrupsioni në administratë do të luftohet me anë të përsosjes së legjisllacionit dhe ndërgjegjësimit të publikut mbi atë se çfarë përgjegjësish penale kanë të gjithë ata që e mbështesin atë. Zyrat e administratës do të jenë të monitoruara me kamera. Autobusët dhe mjediset publike do të jenë të monitoruara me kamera përgjuese për të cilët të gjithë do të jenë në dijeni.

Nuk mund të jetosh si qytetar normal në një mjedis të ndotur. Bashkia do të marrë masa të menjëhershme për të gjelbëruar edhe më shumë qytetin. Sheshet publike

duhet të jenë të gjelbërta. Ne do të ndërgjegjësojmë çdo qytetar që të mbjellë një pemë dhe nëse kjo nuk do të jetë e mundur do të mbjellim një pemë për çdo qytetar. Një ditë në muaj do t'u kërkohet të gjitha shkollave në bashkëpunim me drejtoritë e tyre dhe Ministrinë e Arsimit të jetë Dita e Gjelbërimit të Qytetit ose thënë ndryshe dita e vullnetarizmit për gjelbëruar qytetin përkrah punonjësve të bashkisë. Kjo do të bëhet duke nisur nga vendi ku gjithsecili prej nesh jeton.

Transporti publik do të ndryshojë. Me rrugë më të mira transporti publik do të jetë më i shpejtë. Do të shtohet numri i autobusëve me qëllim që qytetarët të mos presin nëpër stacione. Do të përmirësohet transporti urban dhe ndërrurban duke përmirësuar infrastrukturën rrugore. Pa infrastrukturë moderne rrugore nuk do të ketë transport efektiv publik. Do të zgjidhet një herë e përgjithmonë çështja e transportit urban duke ndërtuar një linjë transporti trami që do të rrisë shpejtësinë e transportit urban.

Gjendja e institucioneve arsimore në qytetit tonë do të ndryshojë menjëherë. Do të lëvrohen fonde për përmirësimin e çerdheve publike, kopshteve, shkollave nëntëvjeçare, shkollave të mesme në të cilat nxënësit do të kenë qeveritë e tyre, që do të japin mendimet e tyre në lidhje me vendimet që marrin drejtoritë e shkollave. Bashkia do të mbështesë të gjitha iniciativat studentore që kanë të bëjnë me interesat e qytetarëve.

Bashkia do të stimulojë nxënësit dhe studentët më të mirë me bursa studimi. Bashkia do të dialogojë dhe të marrë mendimin e tyre në lidhje me politikat kulturore. Bashkia do të përkrahë arsimin jopublik si promovues i konkurrencës në një shoqëri të hapur. Do të ketë rikonstruktiv të institucioneve shëndetësore publike dhe do të rritet cilësia e shërbimit. Bashkia do të ofrojë shërbime sociale për fëmijët jetimë, çerdhet, pensionistët, individët me aftësi të kufizuara, të moshuarit.

Do të ulë nivelin e papunësisë duke hapur vende të reja pune në frontin e rehabilitimit dhe ndërtimit të rrugës. Bashkia do të informojë vazhdimisht qytetarët për vendet e reja të punës nëpërmjet medias vendore. Pensionistët do të kenë lehtësira në transportin rrugor dhe kujdes të vazhdueshëm nëpërmjet projekteve në ndihmë të tyre. Bashkia do të identifikojë nevojat për strehim. Do të hartojë programe për strehimin duke siguruar sheshet e ndërtimit dhe administruar bazën e të dhënave për familjet e pastreha.

Policia bashkiake do të ketë si detyrë të saj pos përgjegjësisë të tjera edhe sigurimin e shkollave që ato të mos bëhen vatra të nxitjes dhe ushtrimit të dhunës dhe veseve por vatra të iluminimit me dije dhe kultivimit të virtytit. Në shkollat dhe universitetet e qytetit të gjithë do të jenë të sigurtë. Atyre do tu ofrohen botime për të njohur historinë e tij, traditat, historinë, pasurinë materiale dhe shpirtërore.

Themeli i çdo shteti është edukimi i të rinjve. Në shkollat dhe universitetet përgatiten qytetarët e ardhmërisë, "ata që për nga jeta e tyre të jenë të moralshëm (të pakorruptueshëm), për nga karakteri të jenë të panjollësor dhe për nga dijet të jenë të shkëlqyer". (Plutarku). Ne do të krijojmë mjedise shkollore ku qytetarët e ardhshëm të shfaqin potencialin e tyre më të mirë të mundshëm. Lumi i Lanës do të shndërrohet në një pikë turistike me ura moderne ku do të ketw librari dhe dyqane lulesh në të dyja anët e tij.

Është e vështirë të grumbullosh shumë të mira brenda një kohe të shkurtër, por është e lehtë ti shkatërrosh ato brenda një dite. Administrimi i fondeve të bashkisë

do të jetë transparent. Bashkia do të jetë e gatshme në çdo kohë të japë llogari për investimet publike dhe mënyrën e administrimit të taksave të qytetarëve.

Do të zhvillojë demokracinë vendore dhe do të inkurajojë qytetarët të marrin pjesë aktivisht në zhvillimin e komuniteteve të tyre. Do të ofrojë bashkëpunim me komunitetin. Do të kryejë rolin e menaxhuesit, i cili mbron interesat e komuniteteve lokale dhe përdor në mënyrë sa më të mirë burimet që disponon. Do të marrë vendime transparente dhe të sigurojë realizimin e shërbimeve vendore të një cilësie të lartë.

Unë kam një ëndërr! Dua ta ndryshoj qytetin tim. Qyteti duhet të rilindë. Të rilindë si një qytet evropian, metropol evropian ku jetojnë qytetarë evropianë. Nuk do të pranoj të fle mbi dafinat e asaj që do të arrijmë por do të rend bashkë me ju për të kapur ritmin modern të nevojës së përditshme për ndryshim. Ne do të identifikohemi me atë që do të bëjmë dhe jo me atë që do premtojmë se mund të bëjmë. Qytetarët duhet të na besojnë. Do të trokasim cdo ditë në zemrat e tyre duke ju shërbyer. Nëse do të isha kryetar bashkie lajtmotivi im do të ishte "Qytetarët janë pjesa më e rëndësishme e një bashkësie; qytetarët janë udhëheqësit e vërtetë. Vetëm me ta ne mund të bëhemi ndryshimi që duam të shohim.

Granit Zela

12.

Ditët e fushatës elektorale për zgjedhjet e pushtetit vendor janë ditë me një inflacion të lartë idesh dhe projektesh të hedhura nga kandidatët për kryetarë bashkie. Janë ditë të ngopura me retorikë, premtime dhe deri fyerje për palën kundërshtare. E thënë më thjeshtë, janë ditët kur politikanët i kanë vërtet punët pisk. Dhe duke qenë përballë një trysnie kaq të madhe ofertash, çdokush mund t'i ushtrojë vetes kushtoren "sikur të isha kryetar bashkie...". Çfarë do të bëja për bashkinë dhe qytetin nën përgjegjësinë time? Nëse këtë kushtore do t'ia shtroja vetes sime, do të gëlltitesha disa herë para se të artikuloja ndonjë ide.

Bashkitë tona vuajnë nga një gamë e gjerë problemesh duke filluar që nga mosefiçenca e deri tek korrupsioni. Për rrjedhojë kjo problematikë pasqyrohet në jetët tona duke ulur cilësinë e tyre. Do të bënim një gabim shumë të madh nëse zgjidhjen e çdo problemi do ta shqyrtonim veçmas dhe të shkëputur nga tërësia. Tërë problemet që hasim në jetën e përditshme dhe që janë pasoja të keq qeverisjes vendore duhen parë si pjella të afërta apo të largëta të tre dukurive. Pa u zhdukur këto tre dukuri që gjenerojnë problematikë, nuk do të kemi gjë në vijë. Të listuara, jo sipas rëndësisë, do të ishin:

1. politizimi ekstrem që i bëhet figurës së kryebashkiakut.
2. paaftësia e administratës vendore
3. lënia e këshillit bashkiak nën hijen e mosinteresimit dhe indiferenca e publikut për vendimmarrjen lokale.

Të renditura kështu nuk është se të thonë ndonjë gjë të madhe, por le t'i marrim me rradhë:

1. Politizimi ekstrem që i bëhet figurës së kryebashkiakut.

Një pjesë e mirë e shqetësimeve dhe problemeve të ditës që lakohen në bisedat familjare ose shoqërore kanë të bëjnë me qeverisjen vendore. Përgjithësisht këto biseda janë shumë të skematizuara. Fillojnë si biseda me karakter social-ekonomik dhe degjenerojnë në vazhdim në një debat mirëfilli politik. Në qendër të tyre kemi kryebashkiakun që konsiderohet ose levë e pushtetit qendror ose armik i betuar i tij. Fatkeqësia e madhe është se kjo mënyrë e të menduari mbrapsht nuk vjen si pasojë e një perceptimi të mangët të publikut, por realisht gjërat kështu funksionojnë. Kur pushteti qendror ka të njëjtën ngjyrë me kryebashkiakun, ky i fundit konsiderohet një benjamin dhe një zgjatje administrative e të parit. Kur "për fatin e keq" pushteti qendror nuk ka të njëjtën ngjyrë me kryebashkiakun, të dyja palët i shpallin luftë njera-tjetrës dhe fillon kalvari i mosmarrëveshjeve. Ky mekanizëm e cënon funksionimin e qeverisjes vendore që në ditën e parë të ekzistencës së saj. Si përkthehet ky mekanizëm në jetët tona? Në rastin e parë do të kemi një pushtet vendor që megjithëse gëzon një buxhet nga qendra më të majmë se "simotrat armike" është i larguar nga interesat dhe nevojat aktuale të qytetarëve. Veprimet e saj nuk kanë

ende për qëllim zgjidhjen e problemeve të qytetarëve, por janë thjesht dhe vetëm pasojë e urdhrave nga lart. Në rastin e dytë gjërat shkojnë edhe më keq. Në këtë rast do kemi një pushtet vednor me një buxhet më të varfër se “simotrat benjamine” dhe që ndjen në çdo hap presionin bllokues të ekzekutivit. Pasojat e tërë kësaj janë mëse të kuptueshme.

Por cila është zgjidhja dhe si arrihet ajo? Pyetja është retorike. Duhet të fillohet që kryebashkiaku të shihet për atë që është. Një përfaqësues i qytetarëve dhe i mandatar për të zgjidhur hallet e tyre. As ekzekutivi s’duhet ta shohë kryebashkiakun një gurë shahu që duhet marrë dhe as kryebashkiaku s’duhet ta shohë ekzekutivin si një armik. Ata duhet ta shohin njeri-tjetrin si partnerë të nevojshëm dhe të pashmangshëm. Kjo e gjitha arrihet vetëm me mirëkuptim dhe apolitizëm nga të dyja anët. Ndonëse ekzekutivi ka hisen më të madhe në këtë mes edhe kryebashkiaku duhet të ofrojë sa më shumë bashkëpunim.

Një zgjidhje akoma më e plotë do të ishte thellimi i procesit të decentralizimit, por që është një proces politik dhe kuptohet që është jashtë tagrit të kryebashkiakut.

2. Paaftësia e administrates vendore

Pozita e kryetarit të bashkisë është me të vërtetë goxha e vështirë. Kjo edhe për karakterin e saj dualist. Ai duhet të jetë një vizionar dhe një menaxher i mirë, një planifikues dhe një administrator i zoti. Kur i mungon një nga këto cilësi, ai qytet është në telashe. Natyrisht që këto cilësi jo domosdoshmërisht duhet të shkrihen tek një njeri. Këtu hyn në lojë stafi i ngushtë, këshilltarët dhe teknikienët që mban pranë vetes. Për shkak të një keqpërzgjedhjeje të stafit të ngushtë i tërë institucioni në fjalë mund të kalojë në kolaps. Prandaj kriteret e vetme që duhet të ndiqen në përzgjedhjen e tyre duhet të jenë zotësia dhe përkushtimi në punë. Çdo kriter tjetër i ndjekur do të ishte garanci për dështim. (Më mirë një armik i zgjuar sesa një mik budalla.) Dy kriteret e sipërpërmendura llogjikisht nuk vlejnë vetëm për stafin e ngushtë, por për të gjithë administratën. Lakmuesit e vetëm të përdorur për përzgjedhjen e cilido punonjës duhet të jenë sërish zotësia dhe përkushtimi. Ndjekja e kriterëve si partishmëria dhe miqësia sjellin në mënyrë të pashmangshme dukuritë e mosefincencës, papërgjegjshmërisë dhe korrupsionit.

3. Lënia e këshillit bashkiak nën hijen e mosinteresimit dhe indiferenca e publikut për vendimmarrjen lokale.

Gjerësisht, sytë e opinionit publik tek qeverisja vendore arrijnë të shquajnë vetëm figurën e kryetarit të bashkisë. Ky handicap bie në kurrizin e institucionit më të rëndësishëm të qeverisjes vendore, këshillit bashkiak.

Ligji në fuqi përcakton dy funksione kryesore për këshillin bashkiak. Këshilli miraton vendimet e ekzekutivit dhe mbikqyr aktivitetet e ekzekutivit dhe administratës. Ai përcakton strukturën organizative dhe administrative të komunave dhe bashkive, strukturën e institucioneve buxhetore nën autoritetin e bashkisë apo komunës, si dhe numrin e punonjësve dhe kriteret e punësimit të tyre. Këshilli, ndër të tjera, vendos taksat dhe tarifatat vendore, miraton dhe amendon buxhetin e bashkisë. Ka një sërë kompetencash të tjera të këshillit bashkiak që mbeten më së shumti në

planin teorik si pasojë e një decentralizimi të pamjaftueshëm. Pra edhe pse është organi legjislativ që përcakton jetën e një qyteti dhe duhet të mbrojë interesat e komunitetit, ai është i lënë krejt në hijen e mosintersimit.

Tokevili shprehet: "Demokracia shërohet vetëm me demokraci". Çdo fenomen negativ që shfaqet në shoqëri është një sinjal për më shumë demokraci, për më shumë vendimmarrje direkte të qytetarëve. Çdo institucion që gjendet në krizë, si një nga masat që duhet të marrë, duhet të rrisë aksesin e publikut.

Në anën tjetër, ajo çka na intereson, është se nuk mund të flitet për qeverisje demokratike në pushtetin vendor pa një këshill përfaqësues dhe funksional. Për nga vetë natyra dhe misioni që ka këshilli është institucioni ideal nëpërmjet të cilit mund të rritet pjesëmarrja qytetare, transparencja dhe përgjegjshmëria në vendimmarrje. Në këtë institucion zhvillohet dhe institucionalizohet marrëdhënia midis qytetarëve dhe pushtetit vendor.

Duke ndjekur një llogjikë zinxhir kuptohet se ilaçi i problemeve nëpër qytetet tona është demokratizimi i pushtetit vendor dhe për rrjedhojë dalja nga "ngujimi" i këshillit bashkiak.

Natyrisht kjo nuk është e lehtë dhe është e pamundur të gjesh një zgjidhje të vetme. Megjithatë masat që duhen marrë për këtë qëllim duhet të përqëndrohen në dy drejtime kryesore. Nga njëra anë duhet synuar përmirësimi i funksionimit të këshillit bashkiak dhe nga ana tjetër duhet përmirësuar marrëdhënia e tij me qytetarët.

Ndërgjegjësimi, Informimi dhe Përfshirja Qytetare

- Qytetarëve të thjeshtë mund t'i shpërndahen versione të thjeshtëzuara të Ligjit mbi Funkcionimin dhe Organizimin e Qeverisjes Lokale si dhe shpjegime skematike të strukturave të qeverisjes vendore.
- Seanca dëgjimore dhe këshilluese duhet të organizohen me komunitetet vendore nga ana e autoriteteve vendore përpara se këto të fundit të marrin vendime me rëndësi të dorës së parë për komunitetin. Seanca të tilla mund të organizohen nëpërmjet komisioneve përkatëse.

Këshillat bashkiakë duhet të botojnë dhe shpërndajnë botimet e tyre për komunitetet vendore. Këto botime duhet të përmbajnë vendimet e këshillave bashkiakë, raportet mbi kontrollet e bëra nga këshilli mbi punën e administratës vendore e kështu me rradhë.

Ekziston edhe një numër i madh rekomandimesh përsa i përket përmirësimit të legjisllacionit, por që nuk po i përmendim sepse dalin jashtë tagrit të kryebashkiakut.

Pra këto ishin disa ide, që mendoj se do të vlenin, në përmirësimin e jetëve në qytetet tona.

REALD KETA

FAKULTETI I DREJTËSISË

13.

Bota është plot çudira por çudia më e madhe jemi ne njerëzit. Ne e mbajmë veten për qeniet më të arrira të këtij planeti, jemi xhevahirët e tij, kurora të qenieve të gjalla, jemi ëngjëj të një "purgatori" dantesk. Shpesh ndihemi dhe veprojmë si Sizifi, ngjitemi dhe zbresim nga "mali", që thonë se u ndërtua për vuajtjet tona, për punët tona që nuk kanë rezultat. Ashtu të kacavjerrë pas malit të pushtetit, ne mbajmë gjallë "Mitin e Sizifit" dhe përforcojmë gjithmonë e më shumë absurdin që përfshin ngahera "botën tonë të çudirave".

Sidoqë ta quajmë ne veten tonë përsëri mbetemi "kafshë politike" që mundohemi me çdo kusht të vëmë veten tonë mbi gjithçka dhe të jemi padyshim qendra ku universi vjen rrotull pa pushim. Jemi individë që priremi për të jetuar sëbashku megjithëse shpesh themi se njeriu për njeriun është ujë. Kjo nuk është e vërtetë nëse do të kemi parasysh faktin se njeriu pa njeriun nuk do të mund të jetonte.

Këto qenie kaq të çuditshme dhe inteligjente që kanë në vetvete një dritë të pashlyer "ndërgjegje" janë të prirura që të jenë të lira por njëkohësisht edhe të "varura" nga ai që i drejton, nga lideri i tyre. Që në kohë të lashta kur njerëzit filluan të kuptonin se çfarë ishte e mirë dhe çfarë ishte e keqe, ata filluan edhe të ndienin nevojën e një udhëheqësi të zotë që të mund t'i drejtonte dhe t'i shpëtonte në njëfarë mënyre nga sulmet që u kanoseshin. Ky drejtues sado i zoti që të ishte kishte një nevojë të pashlyer për bashkëpunimin e të gjithë atyre që kishte nën drejtim. Ne jemi qenie që e duam lirinë dhe e vëmë atë mbi çdo gjë. Ne jemi nga ata qenie që për lirinë kemi derdhur gjak, kemi bërë sa e sa luftëra dhe më në fund kur është arritur janë thurur lavdet më të bujshme. Të gjithë kemi lindur të lirë, të barabartë dhe sot gjithmonë e më shumë po punohet që të mund të kuptohet se deri ku arrin kufiri i lirisë së një individi që të mos kalojë në kufirin e tjetrit. Është e vështirë të qeverisësh "xhevahirët" e kësaj bote, por mënyra më e lehtë për të qeverisur një qytet i cili ka qenë i lirë, është t'ua besosh qeverisjen qytetarëve të tij.

Roli i lidershipit duhet të vihet re në mënyrën se si ai arrin të krijojë vizionin dhe strategjinë e tij por që gjithmonë të jetë në përputhje me interesat e shumicës së qytetarëve. Zëri i sovranit, popullit është zëri më i fuqishëm që duhet të kumbojë dhe të dëgjohet në çdo hap të veprimtarisë së udhëheqësit apo në rastin e realitetit tonë të kryebashkiakut.

Kryebashkiaku është ai person që duhet të zgjidhet në atë post jo për shkak të "fatit", por për në sajë të zotësisë së tij.

Sikur të isha kryebashkiake do të doja ta kisha fituar atë post në bazë të sjelljeve të mia. Mbase do të ishte një mënyrë fitimi me vështirësi, por do të arrija ta mbaja me lehtësi.

Në ditët e sotme bëhet një "luftë" e madhe për të prezantuar kush e kush më mirë programin e tij. Kjo "luftë" nuk ka ndryshuar për vite e vite të tëra, ne kemi dëgjuar dhe dëgjojmë po ato premtime, po ato fjalë të bukura që shpesh na janë bërë si refren i një të shkuare që përsëritet. I shohim kryebashkiakët tanë nëpër fushata dhe pasi marrin postin ne shpesh merakosemi për ekzistencën e tyre. Jetojmë në shekullin "kozmiq" ku bota është zmadhuar për faktin se sytë e të gjithë shteteve të fuqishme janë drejtuar edhe nga qielli, jo vetëm në këtë botë të magjishme që përbën një grimcëz të universit.

Kjo për realitetin tonë është diçka utopike sepse ne jemi akoma larg edhe me botën, megjithëse në vendin e “shqiponjave” ekzistojnë aq botë sa njerëz ka!

Shpesh për realitetin tonë duket i vështirë, madje i paarritshëm fakti që të mund të ndryshojmë, të kërkojmë një mënyrë të re qeverisjeje, të japim një vizion të ri ku të gjithë së bashku të bashkëpunojmë për të shpënë në vend amanetin e të parëve tanë, të rilindasve, që i dhanë emër vendit të “shqiponjave”.

Kush dëshiron të vendosë rregulla të reja, ka si armiq të gjithë ata që kanë fituar privilegje nga pushteti i vjetër, kurse ata që presin të përfitojnë nga institucionet e reja, do të bëhen vetëm mbrojtës të vakët. Është për të ardhur keq kur mendon se edhe në vendin tonë mund të jetë një realitet i tillë, ku të sjellësh të renë do të thotë të përballësh ashpër me brezin e “vjetër”. Më tepër të çudit indiferenca e njerëzve apo frika e tyre, mungesa e kurajos për të zgjedhur ndryshimin, të renë që do të çojë më pas në mirëqenien e përgjithshme. Duket sikur shqiptarët janë mësuar me refrenin e vjetër të politikanëve dhe kanë një besim të pakët për propozimet e reja. Vendi ynë sot ka nevojë për vizionet e reja dhe jo vetëm për premtime boshe. Është për tu çuditur se megjithëse premtimet e vjetra nuk realizohen, dhe pasojat e tyre nuk bëhen të prekshme, populli përsëri brohoret nëpër mitingje, përsëri i sheh me “adhurim” posterat e varura nëpër mure, edhe kur e di se ai në poster nuk ka mbajtur asnjë premtim. Kësaj i thonë t'i kesh fituar zemrën “turmës” sepse vetëm turma mund të brohorasë në një arenë ku luajnë “gladiatorët” modernë.

Por në vendin e shqiponjave populli që është sovran jo gjithmonë e ka mbështetur “lojën e arenave”. Në vendin e Naimit dhe të Kadaresë padyshim që ka edhe nga ata që dallojnë nga turma dhe ngrenë ktyet duke kërkuar të drejtat e tyre. Ata kanë nevojë për një qeverisje më të mirë dhe për një vërtetësi në premtimet që u bëhen.

Çdo kryebashkiak duhet që patjetër të marrë edhe mendimin e tyre për të qeverisur dhe sëbashku të punojnë për një të mirë të përgjithshme, për arritjen e standarteve të larta dhe kënaqësisë për pjesën më të madhe.

Sikur të isha kryebashkiake një rëndësi të madhe do t'i kushtoja transparencës dhe padyshim edhe etikës. Mendoj që gjëja më e rëndësishme për një politikan apo për një fushatë elektorale është zbatimi me përpikmëri i një kodi etik. Në ditët e sotme fatkeqësisht është vënë re një mungesë pothuajse totale e etikës nga ana e politikanëve. Duket sikur mënyra e të sjellurit është gjëja më e thjeshtë përpara gjithë atyre problemeve madhore që ka sot vendi ynë por duhet kuptuar se problemet tona nuk mund të zgjidhen kurrsesi nga njerëz që kanë “probleme” me rregullimin e vetë imazhit të tyre.

Përpara zgjedhëzve të mi pasi të shpalosja mënyrën time të të sjellurit do të shpalosja edhe programin tim. Populli ka shumë nevojë të dijë se me kë ka të bëjë.

Nëse do të flisja për atë çka pret populli nga unë do të përmendja “refrenin” e njohur: ujë, drita, punë, rrugë, trotuare, përmirësim i shërbimit shëndetsor, shkolla...

Por këtë refren nuk do ta thoja si të gjithë paraardhësit e mi, do të “kompozoja” një të ri që të gjithë të mbeteshin të kënaqur. E reja do të konsistonte në faktin se premtimet e bëra nuk do të ishin utopike vetëm e vetëm për të fituar zemrën zgjedhësve, por do të shoqëroheshin me pasqyrimin e një programi konkret, i cili do të kërkonte një angazhim total nga ana ime dhe një bashkëpunim të zgjedhësve të mi. Atyre do tu bëhej e ditur se lumin nuk ta kaloja unë e vetme me premtime boshe, por të gjithë bashkë do të ndërtonim anijen me vela të bardha që të na dërgonte të

sigurtë drejt ëndrrës së përbashkët. Ëndrra jonë e përbashkët do të ishte realizimi i të gjithë pikësnyimeve tona dhe kjo do të arrihej vetëm me anë të kurajos, sinqeritetit dhe ndershmërisë sime.

Çdo deklaratë e imja do të kishte në përmbajtje argumente logjike, largpamësi dhe do të karakterizohej nga një sjellje dinjitoze që do t'i bënte të mundur publikut të njihje sa më mirë lideren e tij. Duke qenë edhe vetë një qytetare e komunitetit ku do të kandidoja do të isha më se e njohur me faktin se mungesa e shërbimeve kishte sjellë një pakënaqësi të madhe për banorët. Që ky fakt t'i përkasë së shkuarës duhet hartuar një strategji e mirë dhe fondet e vëna në dispozicion duhen shpenzuar me korrektësi.

Asgjë nuk është e përealizueshme kur mirëadministrimi qëndron në qendër të gjithçkaje dhe shoqërohet nga një bashkëpunim me qytetarët. Mendoj se nuk ka potencial më të fuqishëm sesa vetë qytetarët, të cilëve duke iu kërkuar pjesëmarrje aktive në vendimmarrje.

Një ambient i pastër është në radhë të parë një detyrë e çdo qytetari të ndërgjegjshëm, i cili ka të drejtë që të kërkojë nga bashkia rregullimin e rrugëve, të parqeve, të shesheve publike, të trotuareve dhe të dijë t'i mirëmbajë të mirat që pushteti vendor do t'i siguronte në mënyrë transparente. Sidoqoftë përgjegjësia është mbi kryebashkiakun, është ai që u votua dhe po ai duhet që në përputhje me ligjin dhe me premtimet e bëra të veprojë në të mirë të qytetarëve. Është për të ardhur keq kur dëgjon se në rastin e një fatkeqësie nuk gjenden disa pëllëmbë vend për të siguruar banesën e fundit. Një gjë e tillë vjen krejtësisht nga mungesa e administrimit nga ana e bashkisë dhe për ta zgjidhur do të mjaftonte vetëm një kujdes dhe një vëmendje më e madhe nga ana e atyre personave që janë caktuar të merren me këtë lloj shërbimi.

Në vendin e shqiponjave të cilit natyra i ka falur gjelbërimin dhe hijeshinë nuk do të ishte aspak e vështirë të ndërtoje dhe të mirëmbajë një park apo një lulishte ku qytetarët të mund të kalonin sa më mirë kohën e çmuar. Por që të gjitha këto të mos mbesin vetëm premtime fushate duhet që përveç kontributit të qytetarëve që është me të vërtetë i rëndësishëm duhet edhe një shfrytëzim në maksimum i fondeve nga ana e bashkisë dhe një transparencë për çdo hap të hedhur.

Jetojmë në një shtet ku demokracia duket akoma si një pjesë delikate kristali, gati e thyeshme dhe e pluhurosur nga sëmundja e vjetër-korrupsioni. Lufta kundër korrupsionit do të ishte padyshim një ndër shtyllat që do të mbështeteshin për të vendosur në vend parimin e shtetit të së drejtës. Lufta kundër korrupsionit do të ishte një luftë kundër diçkaje historike që ka egzistuar në çdo sistem dhe në çdo shtet por që nuk mund të themi se është diçka që nuk mund t'ia ulim dozat. Korrupsioni, ky virus i kohëve tona ka shërim vetëm me punë të ndershme dhe në përputhje me ligjet nga ana e kryebashkiakut. Mos falja dhe të sjellurit korrekt me të gjitha rastet ku haset një gjë e tillë do të sillte ullje të numrit të njerëzve të korruptuar. Jo frika, por sigurimi i një pushteti që është konform ligjeve, që nuk lejon shkelje dhe që vetë nuk është i korruptuar do të sillte mbase ndërgjegjësimin e punojësve të administratës dhe të gjithë atyre që janë të prirur nga "virusi" korrupsion se një gjë e tillë nuk mund të ndodhë më, sepse mungojnë mbështetësit e dikurshëm që mund të kenë qenë edhe vetë të korruptuar. Lufta kundër korrupsionit mbase do të ngjajë me një luftë shekullore, por që gjithsesi me një bashkëpunim të dyanshëm si nga qytetarët edhe nga bashkia, mund të arrihet të ulen ndjeshëm rastet korruptive. Denoncimi i qytetarëve për çdo rast të parregullt do t'i sillte një ndihmesë të madhe bashkisë dhe kryebashkiakut në realizimin e synimeve të tyre. Një gjë e tillë do të arrihej

vetëm në ato raste kur në krye të bashkisë është një person i denjë që ka parime dhe është i prirur ta mbështesë me tërë mënd iniciativën kundër “virusit” tashmë të diagnostifikuar korrupsion.

Unë si kryebashkiake do të kisha si parim në vetvete thënien e Kantit: “Qielli me yje mbi mua, ligji (shtetëror por edhe moral) brenda meje”.

Vetë shteti shqiptar e ka filluar jetën e tij, përmes ligjeve për organizimin e pushtetit vendor, madje pena e rilindasit tonë Sami Frashëri qysh në vitin 1899, ka shprehur parimin modern të decentralizimit duke thënë: “M’i i lumtur i vendeve në botë është ay tek ndjehetë fort pakë dor’ e qeverisë”. Kjo thënie befasuese e tij është tashmë një lajtmotiv i çdo qeverisjeje vendore dhe një shprehje filozofike shumë përparimtare për kohën kur u shkrua. Duke pasur një qeverisje të tillë ne si qytetarë do të kemi mundësi të qeverisemi nga afër dhe jo nga larg dhe si të tillë do të kemi më shumë mundësi të shprehim mendimin tonë të lirë.

Po të isha kryebashkiake sikundër edhe e kam cilësuar, do t’i kushtoja një rëndësi të madhe pjesëmarrjes në vendimmarrje të qytetarëve. Informimi dhe pjesëmarrja aktive janë gjëra që do ta forconin edhe më tepër konceptin e demokracisë në vendin tonë. Duke u mbështetur në parimin e vetqeverisjes vendore mënyra më e mirë për ta kryer me sukses një gjë të tillë do të ishte bashkëpunimi i vazhdueshëm me qytetarët. Zëri i tyre është i detyrueshëm për tu dëgjuar dhe është, ai zë që do të çonte drejt suksesit çdo kryebashkiak. Kryebashkiaku është ai person që u zgjodh nga qytetarët për të drejtuar dhe për të miradministruar kërkesat e tyre.

Machiaveli për një rast të tillë do të kishte thënë: “Të gjithë e dinë se sa e lëvdueshme është për një sundimtar që të mbajë fjalën e dhënë e të jetojë me nder, pa qënë dinak e gënjeshtar. Megjithatë, përvoja e ditëve tona ka treguar se ata që kanë arritur të përmbushin dëshirat e tyre, e kanë bërë duke mos i mbajtur premtimet e dhëna dhe duke mashtruar njerëzit. Një sundimtar i mençur nuk mund dhe nuk duhet ta mbajë fjalën e dhënë, kur ajo bie ndesh me interesat e tij dhe kur shkaqet që e detyruan të jepte fjalën nuk do të ishin më në fuqi”. Ashtu si në kohën e Machiavelit edhe në ditët tona flitet akoma më tepër për premtimet e dhëna dhe për mbajtjen e tyre.

Edhe unë si kushdo tjetër u duk se dhashë premtime, thashë fjalë por që do t’i përmbushja me përpikmëri, sepse premtimet e mia ishin besa ime, gjë që shqiptari shpresoj të mos ta ketë harruar, se ajo gjithmonë i ka dhënë nder kur ishte në një shoqëri pa shtet. Sot që shteti themi se egziston unë do ti mbaja premtimet e mia sepse unë do të zgjidhja ata interesa që të mos ishin vetëm të miat por të gjithë shoqërisë ku do të bëja pjesë. Në këtë rast Machiaveli do të më përgjigjej duke më thënë: “Të jesh i mirë për të gjith, do të thotë të jesh i keq për vete!” Kjo nuk do të ishte e vërtetë nëse unë do të mund të arrija të siguroja mbështetjen e gjithë qytetarëve me të cillët do të punonim për një interes të përbashkët në të mirë të komunitetit.

Edhe unë në radhë të parë do të isha një qytetare me të drejta dhe detyrime, që si gjithë të tjerët do të përpiqesha të kontribuoja në interesat e përbashkëta pa u penguar nga “deliri” i të qënës drejtueses e tyre.

Do të mbaja si refren në mendjen time disa vargje që presidenti martir Abraham Linkoln i donte shumë:

*Përse njeriu është kryelartë?
Si re e shpejtm , meteor i zjarrtë,
Si dritë vetëtin, si valë na vëngon,
Nga jeta në pushim, në varr kalon...*

Është njeriu ai që bën çuditë më të mëdha, që kërkon të qeveriset dhe të qeverisë dhe përsëri unë e quaj atë qenia më e pësosur, për të cilën ia vlen të çahen qiejt e kozmosit dhe t'i falet e gjithë madhështia e universit.

Edhe shqiptarët janë njerëz me një potencial të tillë që meritojnë padyshim më të mirën ndaj unë do tu thosha qytetarëve të mi: **“Qytetarët e mi të dashur, po takohemi në një kohë sfidash të mëdha, në një kohë e cila para nesh shtron probleme të mëdha dhe të ndërlikuara, por edhe mundësi të shkëlqyera. Kjo është koha e ndryshimeve, të cilës askush nuk mund t'i kundërvihet.”**

Edlira Osmani

Universiteti “Marin Barleti”

Fakulteti i Shkencave Humane

Dega Drejtësi

BIBLIOGRAFIA

- **PRINCI-Niccolo Machiaveli** (shtëpia botuese UEGEN, Tiranë 2003).
- **E Drejta kushtetuese-Aurela Anastasi** (shtëpia botuese Pegi, Tiranë 2004) faqe.226.
- **Bill Klinton-Empedocle Maffia** (Botimi,Tiranë 1994).
- **Strofë nga poezia-“Kotësia njerëzore”William Knox.** (përkthim i F.S.Nolit).

14.

Kryetari i bashkisë konsiderohet si “thembra e Akilit” për një qeverisje të mirë të një njësie vendore, ai luan rolin kryesor në formësimin, organizimin, sistemimin dhe implementimin e vullnetit politik të popullit. Mirëqenia dhe zhvillimi i një njësie vendore është përgjegjësi e atij që quhet “Qytetari i parë”.

Të gjithë individët e një komuniteti dëshirojnë të njëjtën gjë, një mirëqenie të rregullt dhe të mirë, kjo nuk do të thotë që të na jepet e përsosura por të paktën tiparet më të nevojshme për një jetesë të mirë, e cila nuk duhet të diskutohet, pasi tashmë jemi në shekullin e XXI dhe me keqardhje pranojmë se Shqipëria është i vetmi vend i cili vuan nga këto elementë negativë. Përgjegjësinë për këto mungesa e mbajnë mbi shpatulla shumë faktorë duke nisur që nga historia dhe për të përfunduar tek udhëheqësit tanë jo efektiv, por përgjegjësinë më të madhe e mbajnë ata që janë më afër komunitetit përkatësisht udhëheqësit e pushtetit vendor, lidhur me kompetencat që kanë në zotërim dhe mundësitë që ata kanë në dorë pasi jo e gjithë përgjegjësia është e tyre.

Qyteti nga i cili unë vij është një qytet shumë i bukur, me një natyrë marramendëse dhe nëse do të isha kryetare e këtij qyteti, përkatësisht Vlorës do të më duhej t’i përvishesha punës shumë seriozisht sepse puna e kryetarëve të mëparshëm ka lënë shumë për të dëshiruar.

Tiparet e udhëheqjes, planet dhe kriteret mbi të cilat do të dëshiroja të udhëhiqja vendin tim janë si vijon:

Së pari do të isha një lider karizmatik, gjithmonë e qeshur, gjithmonë e gatshme për të ndihmuar të gjithë pjesëtarët e komunitetit tim pa dallim shtrese apo feje dhe gjithmonë e hapur ndaj kritikave, do të bëja të mundur që të rritej transparenca, besueshmëria dhe shmangja e një lideri autoritar dhe të sertë, do të krijoja një popullaritet shumë të madh nëpërmjet reklamave, posterave, koncerteve, bamirësive dhe shumë elementëve të tjerë. Do të krijoja një marrëdhënie të veçantë me anëtarët e këshillit që do të më ndihmonin në punën time dhe në realizimin e synimeve tona, të krijohej një marrëdhënie besnike dhe e mirë sepse që aty nisin hapat e parë për të treguar se je një njeri ideal dhe se partia jote është ajo më seriozja.

Së dyti hapi i parë që do të ndërmerrija në punën time do të ishte paraqitja e një programi paraprak jo përfundimtar, ku të përfshiheshin të gjitha idetë, të ndara nëpër pika dhe klauzola të veçanta ku të trajtoheshin imtësisht të gjitha lagjet e qytetit, çdo rrugë, çdo shkollë, çdo spital etj, dhe atë se çfarë veprimtarish do të ndërmerreshin pasi të ishte përfunduar programi, do të fillohej shpërndarja e programit në çdo institucion në çdo universitet deri sa të arrinte edhe në shtëpitë e qytetarëve të thjeshtë, aty ata do të ishin të lutur që nëpërmjet numrave të tel, adresave të e-mailit dhe mundësive të tjera të kontaktimit, të mund të jepnin sugjerime, ide, të bënin kritika, të ndryshonin apo të shtonin çdo gjë për të cilën ne nuk do të ishim në dijeni. Midis të tjerash në program do të theksoheshin ato gjëra që kishin probabilitet më shumë për tu realizuar, dhe alternativat e tjera që do të realizoheshin vetëm po të

kishim fonde të mjaftueshme, kjo bëhet që të mos mashtrohet elektorati, për të qënë të sinqertë me ata që në fillim, dhe nëqoftëse dikush të akuzon si mashtues ke fakte të cilat mund t'i paraqesësh dhe të jesh në rregull me veten dhe popullin tënd.

Së treti pasi të kisha stukturuar idetë dhe pasi të kisha stukturuar edhe një herë programin do të filloja me hapin tjetër atë të vënies në zbatim idetë. Nëpërmjet buxhetit, i cili do të përbëhej nga taksat të cilat i ka në status pushteti vendor dhe marrja e fondeve nga qeveria qendrore për realizimin e politikave të saj, do të filloja të bëja ndarjen e tij për realizimin e programit. Pra, për ato elementë të cilat ishin të sigurta për tu realizuar do të fillonte menjëherë puna, për të tjerat të cilat ishin të rëndësishme por që nuk kishte fonde të mjaftueshme, në fillim do t'i kërkoja ndihmë pushtetit qendror. Nëse as pushteti qendror nuk do të më ndihmonte atëherë do të ndiqja një politikë të tillë e cila besoj se do të kishte efekt: Do të njoftoja komunitetin për hapat që kishim ndërmarrë për shembull rregullimi i një rruge, rregullimi i një spitali etj. Pasi tu tregoja se deri në çfarë pike kishim arritur dhe planet më të afërta për tu realizuar do të shkoja tek ata të cilët prekeshin drejtpërdrejt, do t'u sugjeroja një ide, që të më ndihmonin që një pjesë të fondeve ta vija unë ndërsa tjetrën ata nëpërmjet kontributit minimal të çdo familjeje. Nëse ata do të ishin dakort do të nisej menjëherë puna në të kundërt, do të lihej për më vonë pasi të krijoheshin mundësitë. Përgjegjësinë për të gjitha do ta kisha unë, për ecurinë e punës për sigurimin e skuadrave, mjeteve të nevojshme, etj.

Meqenëse Vlora është një vend turistik atëherë pikë e veçantë do të ishte zhvillimi i turizmit si në bregdet ashtu edhe në vende malore siç është Llogaraja, por në fillim është e rëndësishme ndërmarrja e disa nismave shumë të nevojshme. E një rëndësie parësore është pastrimi i gjithë qytetit, jo vetëm i rrugëve kryesore por edhe lagjeve më të thella, duke i kushtuar një interes qytetit në përgjithësi. Vazhdojmë më tej me pastrimin e plazhit në të gjithë hapësirën e tij duke filluar që nga plazhi i vjetër i cili nuk përdoret për mos kushtimin e rëndësisë dhe mos pastrimin e tij, pastaj të vijojmë me përpunimim e rërës, krijimin e një trotuari për kalim, i cili të lejojë një hapësirë të madhe ndërmjet rërës dhe detit. Gjithashtu vendosja e dritave në buzë të trotuarit, pastaj mbjellja e disa pemëve dhe krijimi i një lulishte të vogël. Pra është e rëndësishme që të mos nënvlerësohet çdo hapësirë e detit dhe sidomos e atij të plazhit të vjetër, të cilit nëse i kushtohet një interes i veçantë mund të mbledhë dyfishin e turistëve.

Hap tjetër i rëndësishëm është krijimi i lulishteve të mëdha në të gjithë territorin për pushimin e qytetarëve, katër lulishte të ndara në katër pika, një në plazhin e vjetër, një në ujin e ftohtë, një tek fusha e aviacionit dhe i katërti është rregullimi i atij ekzistues tek aulona, shpërndarja e parqeve në këtë mënyrë krijon një zhvillim të të gjithë qytetit në përgjithësi në mënyrë që individët t'i kenë më afër dhe të krijohej më shumë mundësi për gjallëri të qytetit e cila është një nga pikat kryesore për të cilën jam shumë e interesuar.

Pastaj do të vijojmë me rregullimin e rrugëve, vendosja e dritave në të gjitha lagjet, rregullimi i spitaleve shkollave. Krijimi i sa më shumë koncerteve dhe meqenëse Vlora ka një shkollë artistike do të ndihmoja që studentët më të talentuar të zhvillonin koncerte të ndryshme dhe ekspozita të cilat do t'u interesonte si studentëve, të cilët afimohen dhe individëve në mënyrë që të argëtohen. Do të festoja të gjitha festat e mëdha nëpërmjet koncerteve dhe lojërave të ndryshme për t'i shndërruar në një

traditë. Do dëshiroja të bija dakort me zotëruesit e dyqaneve në rrugët kryesore për të mbajtur ndezur dritat gjatë natës. Kryesore do ishte modifikimi i fasadës së qytetit, ljerja e të gjithë pallateve pa përjashtim në ngjyra të ngrohta dhe te ndezura që të krijohej një harmoni e tillë e këndshme për syrin e të gjithëve. Të ketë një projekt për pazarin dhe krijimin e kinemasë dhe shumë elementëve të tjerë të rëndësishëm që kërkojnë një analizë më të hollësishme.

Pra, si përfundim mund të shtoj se vetëm lideri me dëshirë të madhe mund të ndihmojë popullin dhe të fitojë përmes punës që kryen. Synimi i çdo lideri është që të arrijë në pushtet vetëm për të realizuar synimet vetjake të fitojë sa më shumë në kurriz të popullit, kjo është një ide që dua ta kundërshtoj në mënyrë të fortë, unë nuk kërkoj një lider që të shquhet për një moral, dhembshuri dhe dashuri të lartë pasi ne jemi të vetëdijshëm që dicka e tillë nuk ekziston, por të jetë një lider që të fitojë por deri në atë masë sa të mos çënojë të dobët dhe ata që kanë vërtet nevojë. Nëse unë do të isha lideri i pushtetit vendor do të përpiqesha të bëja diçka më shumë për popullin që më ka zgjedhur dhe që ka besim tek unë, do zbatoja programin me përpikmëri, dhe do mundohesha që të rrisja mirëqënien për të gjithë.

JONIDA TRUSHI

UNIVERSITETI I TIRANES

FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE

DEGA SHKENCA POLITIKE

15.

Kryetari i bashkisë është figura qendrore dhe më e lartë e administratës bashkiake dhe për rrjedhojë veprimtaria e tij politike prek spektrin e gjerë të publikut, të të qeverisurve, inspiron krijimin e një lidhjeve më të drejtpërdrejtë dhe më konkrete midis tyre. Pra, ushtrimin e pushtetit vendor do ta konsideroja si një marrëdhënie midis publikut dhe kryetarit të bashkisë, ku një rol të rëndësishëm duhet të luajë ky i fundit.

Kryetari i bashkisë duhet të jetë një person i cili zotëron “armët e forta” për të krijuar një vizion të qartë, i cili do të përbëjë bazën teorike të veprimtarisë së tij dhe për të përdorur strategji korrespondente dhe efektive për të zbatuar qëllimet e tij. Kryetari i bashkisë duhet të jetë një lider i cili karakterizohet nga:

- Një motiv i fuqishëm për përgjegjësi dhe përbushje detyre
- Konsistim në ndjekjen e qëllimeve
- Origjinalitet dhe praktikitet në zgjidhjen e problemeve
- Motiv shtytës për të ushtruar iniciativa të reja
- Tendencë për të importuar modele perëndimore të qeverisjeve vendore të suksesshme
- Përqëndrimi veçanërisht në çështje që lidhen drejtpërsëdrejti me brezin e ri, i cili konsiderohet si e ardhmja e kombit.

Ndërsa nëse do t'i referohesha rastit shqiptar, kryetari i bashkisë, mbi të gjitha duhet të karakterizohet nga praktikiteti dhe origjinaliteti në zgjidhjen e problemeve nisur nga vetë natyra e këtyre të fundit e cila është e lidhur ngushtë me planin jetik.

Por për një qeverisje efektive vendore nuk mjafton vetëm vizioni i liderit për një menaxhim politik sa më të mirë por mbi të gjitha strategjitë që ai duhet të përdorë. Pra, duhet të ketë menduar për realizimin e premtimeve dhe detyrave të tij dhe veçanërisht duhet të njohë dhe disponojë mjetet që nevojiten për realizimin e tyre. Duke pasur të qarta këto dy koncepte dhe duke qenë i pajisur me vullnetin e mirë për të punuar realisht, ai do të jetë i suksesshem në veprimtarinë e tij.

Fushat në të cilat do të shtrihet kjo veprimtari duhet të jenë të larmishme pasi edhe vetë nevojat dhe interesat e publikut karakterizohen nga larmia, diversiteti dhe ndryshueshmëria. Kryetari i bashkisë duhet të ndjekë një politikë vendore koherente me nevojat e njejzve dhe veçanërisht me problemet e saj. Një kryetar bashkie një rëndësi specifike duhet t'u kushtojë fushave që lidhen me problemet më emergjente të shoqërisë dhe që kanë pasoja të theksuara në jetën e saj.

Në modelin shqiptar të qeverisjes vendore një kryetar bashkie do të ishte “ideal” atëherë kur ai do të fokusohet në çështje të tilla si; përmirësimi i ndriçimit rrugor, i furnizimit me ujë të pijshëm, i transportit urban etj të cilat janë shndërruar në problemet më të rëndësishme dhe jetike të shoqërisë.

Shtylla kryesore që mendoj se duhet të mbështetet një kryetar bashkie është evidentimi i rasteve korruptive dhe metodat për shmangjen e tyre, sepse korrupsioni ka qenë pikërisht ngërçi që ka shkaktuar probleme jo vetëm në veprimtarinë bashkiake por në të gjitha institucionet e aspektit qeverisës në tërësi. Pra, e vendos theksin në një luftë kundër korrupsionit dhe e konsideroj si gjenezën e një veprimtarie vendore sa më të suksesshme. Duke u përqëndruar në ato fusha të organizimit shoqëror të cilat paraqiten si më problematike dhe që kërkojnë një zgjidhje sa më të shpejtë si dhe duke shmangur mbi të gjitha aktet korruptive, besoj se një kryetar bashkie do të jetë më i arrire në synimet e tij.

Nisur nga kjo situatë konsideroj si të rëndësishme karakterizimin e kryetarit të bashkisë nga praktikiteti por, ai duhet të jetë edhe i hapur dhe bashkëpunues me votëbesuesin e tij, komunitetin. E një rëndësie të veçantë është edhe pjesëmarrja e individëve në proceset e qeverisjes në kuptimin e një bashkëpunimi midis qytetarëve dhe kryetarit të bashkisë, në planin e paraqitjes së drejtpërdrejtë të nevojave dhe interesave. Një qeverisje vendore bëhet demokratike atëherë kur qytetarit i jepet mundësia e pjesëmarrjes dhe paraqitjes së opinioneve të tij në strukturat përkatëse bashkiake. Pra, qeverisjen vendore do ta konsideroja si një marrëveshje dhe bashkëpunim midis individëve dhe kryetarit të bashkisë në mënyrë që i ky i fundit të jetë sa më pranë njerëzve.

Si përfundim, një kryetar bashkie duke pasur një vizion të qartë në lidhje me qëllimet dhe objektivat që synon të arrijë, duke përcaktuar mirë fushat që do të shtrijë aktivitetin e tij, duke hartuar platformat dhe strategjitë e nevojshme, duke njohur dhe zotëruar mjetet, burimet financiare dhe njerëzore dhe mbi të gjitha duke punuar pa korrupsion, me transparencë dhe në bashkëpunim me komunitetin do të arrijë t'i japë një përgjigje pozitive votës së zgjedhësve të tij.

Nertila Konomi

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Shkencave Sociale

Dega Shkenca Politike

16.

Të jesh në krye të bashkisë, përfaqësues i një qyteti, i mijëra njerëzve, i mijëra zërave do të thotë përveçse krenari edhe përgjegjësi mbi vetvete. Detyra që çdo kryetar bashkie i ka vënë vetes, në rastin më të mirë, është që të jetë një përfaqësues i zërave të mbytur, të sjellë ndryshim, të sjellë progres, të sjellë zhvillim.

Të kesh simpatinë e një qyteti të tërë do të thotë punë, solidaritet dhe bashkëpunim. Qeverisja e përkryer vendore nuk ekziston, jo vetëm këtu në Shqipëri por edhe në vendet më të zhvilluara sepse e mira është një labirinth pa fund. Që të përpiqesh ta arrish atë, të futesh në labirinthin e së mirës, së progresit do të thotë më shumë se ta arrish atë dhe ndoshta një ditë do ta kuptosh se synimi yt nuk është aq larg realizimit. Ne jetojmë në këtë vend dhe nëse do të vëmë re shumë kryetarë bashkie janë larguar direkt mbas 3 vjeçarit të qeverisjes së tyre, të tjerë vazhdojnë ta përsërisin mandatin e tyre.

Lind pyetja “PSE” ?

Përgjigjja është shumë e thjeshtë. Ky është rezultati i punës së këtij lidërshipi. Kjo është nota që ai ka marrë nga vetë qytetarët e vendit që ai administron. Roli i lidërshiptit konsiston tek vizioni që ai ka dhe tek strategjia që ai përdor për të bërë realitet vizionin e tij sepse nëse ekziston thjesht vizioni ai mbetet një ëndërr në mendjen e një njeriu që ëndërron. Strategjitë që një lider mund të përdorë janë të ndryshme sepse secili është unik dhe secila strategji ka një lloj enigme.

Ne kemi fatin e mirë të dimë se cilat janë rrugët e sakta, rrugët në të cilat duhet të ecim, të mos përsërisim gabimet që i kanë bërë më parë kombet e tjera më të zhvilluara se nëse studiohet thjesht ky fakt ne mund të ecim përpara me hapa gjigandë.

Mënyra më e mirë që një lider të jetë i pëlqyeshëm, i pranueshëm, dhe të rizgjidhet është që gjatë mandatit të tij të ketë jo vetëm marrëdhënie shumë të mira me qytetarët po edhe të bashkëpunojë me ta. Për gjërat që mund të duken të parëndësishme apo për ato me më shumë rëndësi mënyra më e mirë është që të ketë nga një përfaqësues nga çdo lagje që të marrë pjesë në një mbledhje, qoftë edhe për të dhënë një mendim.

Që një lider të jetë i pranueshëm nga komuniteti duhet të plotësojë së pari disa kushte morale, që ndoshta nuk do të ndikojnë në punën e tij drejtpërsëdrejti po që janë të domosdoshme që të pranohet dhe të zgjidhet nga shumica.

Secili zgjedh më të mirin, atë që ai mendon se do të sjellë progres ekonomik, social apo kulturor. Diçka tjetër që kam vënë re është se pjesëmarrja e grave në poste të tilla është shumë e vogël. Pjesëmarrja e grave do të sjellë më shumë progres meqenëse gratë janë më pak të prirura drej korrupsionit, gjë që urrehet nga populli dhe sjell pakënaqësi.

Me fjalë të tjera për minimizimin e korrupsionit për rritjen e transparencës dhe sinqeritetit shërben rritja e pjesëmarrjes së gruas në politikë.

Diçka që rrit vlerat e një lideri është përmirësimi i shërbimeve. Detyra parësore e çdo lideri është përmirësimi i atyre shërbimeve që ndikojnë drejtpërsëdrejti në jetën e qytetarëve. Një rol të madh duhen të zënë rrugët dhe përmirësimi i infrastrukturës së tyre.

Çelësi për një qeverisje të mirë qëndron gjithashtu në bashkëpunimin e leadershipit me komunitetin. Nëse dëgjohej zëri i popullit atëherë pakënaqësia do të minimizohet, gjë që faktëzohet nga ideja e iluministit Zhan Zhak Ruso “Pushteti buron dhe i përket vetëm popullit”

Andja Shehu

17.

E bukur, e vjetër , e rikonstruktuar me qindra herë , e mbipopulluar ...është pikërisht kjo ndërtesë që më del përpara syve në cdo fillim dite. Shumë njerëz shoh që hyjnë dhe dalin prej zyrave të kësaj ndërtese. Disa me letra në duar dhe disa me duar “në xhep”, disa të zemëruar dhe disa të tjerë të lodhur nga radhët e stërzgjatura për të kryer një veprim.

Shumë herë e kam menduar se nga vjen emri që ky institucion ka marrë, mos vallë nga fjala “bashkim”...jo, mos ndoshta e ka marrë emrin nga një kafshë e quajtur “breshkë”...ndoshta. Megjithëse emrat nuk kanë shumë afërsi me njëri tjetrin, janë menytrat e funksionimit ato të cilat e bëjnë ngjashmerinë më të madhe.

Kam dëgjuar që breshka ecën shumë ngadalë...por nuk besoj se ka ngadalësi më të madhe se sa burokracia e këtij institucioni. Është për tu habitur fakti që një letër kërkon 2-3 javë për të shkuar nga kati i parë në katin e dytë! A thua i bëhet autopsia dhe mjeko-analiza?! Sikur një ditë të kisha mundësinë të ngrija zërin tim, dhe zëri im të dëgjohej, do ia vlente edhe të bërtisja përpara këtij institucioni si i marrë, por duke e ditur që një letër kërkon 2-3 javë, atëherë zëri im, që në shumicën e rasteve e merr era, do të kërkonte më shumë se sa një jetë për të shkuar në veshin e duhur.

Qytetin tim mund ta quaj dhe qytetin e disniveleve,ku krahas ndërtesave superluksoze gjen dhe njerëz pa shtëpi, qyteti ku X5-sat janë të pa numërueshme. Qyteti ku kazinotë shtrihen në të gjithë bulevardin dhe sa herë që i shikoj pankartat e tyre të reklamuar më duket sikur në to lexoj “Mirë se erdhët, ju humbisni ne fitojmë”. Qyteti ku krahas një dyqani këpucësh firmato në “Bulevardin Kryesor”,mund të gjesh dhe një kasap që pret mish (dy tulla bëjnë diferencën e artikujve që shiten) ,mos të flasim pastaj për rininë, që duket sikur ka bërë një abonim të përjetshëm me kafenetë.

Por çfarë mund të bëjë një “breshkë” që ka 16 vjet dhe nuk po përfundon rrugën e saj. Asgjë, sepse asnjë nuk i kërkon llogari asaj firme apo atyre vartësve të cilët kanë për kompetencë të kujdesen për taksapaguesit. Qytetari në çdo vend të botës është baza e komunitetit, është një “leje” apo “miratim” i ndryshimit dhe sigurisht, personi përpara të cilit duhet të “jepet llogari”. Ndërsa në vendin tonë, gjithmonë kur vijnë votimet, qytetari i thuhet “Çfarë kërkon, do të të plotësohet pasi të japësh votën”, dhe më pas i thuhet “Çfarë kërkove, nuk ke për ta marrë, mjafton që dhe votën”! Kjo është një padrejtësi që më bën të irritohem sa herë e shoh kryetarin e bashkisë të hypë në makinën e tij superlluksoze , dhe pak me tutje shoh babain tim që përdor të njëjtat “rrota” për 50 vjet. Kryetari i bashkisë është njeriu më i pasur, biznesmeni më i sukseshëm, pronari i gjysmës së qytetit, ka kënd lojërash apo kompleks sportiv personal dhe rinia e qytetit nuk ka asgjë.

Dikush mund të thotë që rinia ka bukurinë apo freskinë e moshës...por jo! Jua them unë! Rinia , e vetmja gjë që ka, është KOHA! Por edhe këtë pasuri po e përdor pa kriter! Koha është i vetmi element që ikën dhe s’vjen më dhe midis “asnjë” alternativave rinia preferon ta humbasë atë në kafe duke harruar që ky çast, ky minut, ky sekond është i pa kthyeshëm. “Shpesh na duket vetja si pensionista”

shprehet një adoleshent kur i përmend kafenenë,dhe të mendosh që kështu është pjesa më e madhe e rinisë.

Në perëndim jeta organizohet në shumë qendra, në periferi, e zona rurale, kurse tek ne është ajo “Vollga” e famshme që gjithë jeta zhvillohet aty, habitesh kur shikon vajza dhe djem të veshur njësoj, a thua vallë të kenë humbur identitetin e tyre? Rrallë herë shikon dikë që të jetë i personalizuar si në veshje dhe në mendime, të tërë janë pjesë e pandashme e të ashtuquajturës “turmë” ku identiteti humbet. Përse të mos e organizojë bashkia jetën rinore?

Unë jetoj në qytetin e njerëzve që përpiqen të bëjnë 3-pikësha me plehrat nga kati i peste, sikur të jetë finalja e “NBA”. Preçizioni i tyre për të arritur “koshin” do ta detyronte Michael Jordan që për hir të profesionalizmit dhe konkurrencës të futej në ligën Shqiptare të basketbollit,jo për gjë por do të kishte rivalë të fortë .Qyteti, ku vidhen akoma kapakët e pusetave për tu shkrirë për hekur .Sa e sa njerëz mund të kenë rënë në puseta, sidomos netëve pa drita.

Ajo që më mundon më shumë është pyetja : Për çfarë jetojnë këta njerëz, përse nuk e ngrenë zërin e tyre, përse nuk bashkohen me mua, me ty?! Dhe nga një kronikë e shkëputur nga lajmet gjatë një mbasdite me drita, mësova se shqiptarët jetojnë për POLITIKEN. Ajo zë një vend të rëndësishëm. Tek ne, politikë bëhet tek bari i lagjes, në punë, në rrugë duke ecur, tek dyqani i bukës duke krijuar një simbiozë politikë-individ.

Por mirë mor njerëz, kaq e lartë është mirëqënia juaj sa vetëm politika ju mungon?!

Njerëzit presin ditët e fushatave për të shtruar rrugën përpara rrugicës së tyre. Ata presin ditët e fushatave për tu ardhur uji nëpër rubineta dhe për të parë njeri-tjetrin mirë në dritë. Përse vallë jemi kështu? Vallë nuk duam më shumë dinjitet për veten tonë? Ne duhet t'i japim një shans vetes tone. Ky është qyteti im: i bukur, i lodhur, gri dhe shumëngjyrësh, qyteti i zhurmshëm që nuk pushon kurrë, një metropol i Shqipërisë perëndimore i cili me pak vullnet politik dhe qytetar gjithashtu mund të bëhet nesër i denjë për të ardhmen tone, gjithmonë nëse ne do duam që një gjë e tillë të ndodhë. Shpresa vdes e fundit për ty qyteti im dhe kjo shpresë ekziston. Më prit mua se do vij një ditë...!

Mariol Spaho

Durrës

18.

Pas një fushate elektorale intensive, ja sot qëndron i ulur në atë karrige i “veshur” me një status që ju jep nder dhe përgjegjësi. Vëmendja ime dhe e gjithë qytetarëve sot është drejtuar mbi ju me shpresë se ndoshta rruga e lagjes do të asfaltohet apo do të hiqen ato “malet “ me mbeturina para pallatit dhe do të zëvendësohen me një lulishte.

Të jesh kryetar bashkie, të jesh një lider dhe për më tepër i suksesshëm nuk është dhe aq e thjeshtë sa ç’është nëpër ato “komentet dhe analizat” që bëhen nëpër muhabete kafeneje.

Së pari unë vlerësoj vizionin, idetë si dhe strategjitë më efektive për ti vënë në jetë ato ide por edhe gatishmërinë dhe të qënit i hapur ndaj sugjerimeve, ideve të reja, këshillave dhe kritikave.

Së dyti, një lider duhet të ketë aftësi bashkëpunuese dhe stil demokratik drejtimi të institucionit .

Së treti ju Zoti kryetar duhet të jeni i zoti të fitoni besimin e qytetarëve duke qenë së pari shembull i një njeriu që bën një jetë të moralshme, një njeriu që është human dhe i hapur ndaj kërkesave të qytetarëve. Imazhi që duhet të krijoni nuk është ai i atij njeriu të ulur pas një taovline plot me shkresa, që është gjithë ditën i zënë duke zgjidhur problemet në letra por ju të gjendeni atje ku egziston problemi, të ndani hallet bashkë me ata banorë por dhe të jepni shpresë dhe jo vetëm kaq.

Ndërkohë le të përqëndrohemi në veprime konkrete. Çfarë do të ishte një nga gjërat e para që do të bënit? Sigurisht krijimi i strukturës apo aparatit administrativ, që është instrumenti bazë i realizimit të të gjitha nismave bashkiake. Nëse ju jeni një lider që shihni përtej dallimeve partiake dhe ajo që ju intereson është një aparat nëpunësish të aftë, atëherë sëbashku me miratimin e këshillit, veproni në bazë të punësimit mbi parimin meritokratik. Kjo mund të realizohet duke shpallur konkurse apo kërkesa të caktuara që duhet të përmbushin kandidatet.

Bashkëpunëtorët tuaj për 4 vjet duhet të jenë kompetentë, me përvojë por pse jo dhe të rinj me vizione dhe të aftë. Në vazhdim për një qeverisje sa më të mirë vlerësoj transparencën dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në vendim-marrje. Zyra e ankesave të popullit duhet të kryejë sa më mire rolin dhe funksionin e caktuar duke qenë e gatshme për të pritur ankesa, sugjerime por edhe të sigurojë, që ato do të shqyrtohen dhe qytetarëve do t’u kthehet një përgjigje. Ndërkohë dhe qytetarët vetë mund të jenë aktivë duke marrë pjesë në mbledhje për çështje të rëndësishme si përshtetësi kur përcaktohet buxheti apo në shpalljen e tenderave.

Ata duhet të kenë të drejtë të informohen nga një zyrë e informacionit, e vendosur për këtë qëllim për gjithçka ndodh në bashki, si shpenzimet dhe investimet apo objektivat në vijim. Nëqoftëse është e pamundur për gjithë qytetarët atëherë këto informacione të jenë të disponueshme për mediat.

Ashtu si e cilësova, aftësitë bashkëpunuese janë të rëndësishme jo vetëm në kontekstin kryetar-këshill-apat administrativ, por dhe më gjerë. Në fillim do të vlerësoja bashkëpunimin me biznesin e vogël dhe të madh, pse jo nëpërmjet tavolinave të rrumbullakta të shprehen interesat dypalëshe dhe pikat e bashkëpunimit. Zhvillimi i qytetit ka një lidhje korrelative pozitive se nga ai varet punësimi në shkallë të gjerë, investime të ndryshme janë në funksion të estetikës së qytetit apo e rëndësishme është që biznesi mund të jete sponsori kryesor për nisma të ndryshme nga bashkia .

Diçka tjetër që do të këshilloja është ndërhyrja sa më e madhe e bashkisë, aq sa i lejojnë kompetencat për privatizimin e objekteve tashmë si relika të sistemit komunist por që mund të kthehen në objekte frytdhënëse nëqoftëse ndërhyet nga bizneset.

Do të vlerësoja marrëdhëniet e mira me bashkitë homologe të huaja. Kjo për shkëmbime reciproke eksperience si dhe mundësi prezantimi me vlerat e qyteteve tona si edhe mundësi për tu bërë ftesë për investime për çështje të ndryshme .

Nuk do të neglizhoja bashkëpunimin me OJF-të, që veprojnë në qytet për projekte dypalëshe si trajnime, shtëpi apo qendra për të pastrehët, rikonstruksione të objekteve të ndryshme etj. Gjithsesi bashkia nuk mund të jetë e varur nga bashkëpunimet për të realizuar përgjegjësitë, por sigurisht duhet të shfrytëzojë fondet e caktuara në mënyrë sa më transparente dhe efikase.

Nuk është shumë që të kërkojmë një qytet ku mund të ecësh i sigurt natën nga pusetat e hapura, gropat nga asfalti i cilësisë së dobët apo nga trotuaret pa ndriçim .

Nuk është shumë që të kërkojmë një qytet të pastër me gjelbërim dhe me shatërvanë që janë në funksionim pas një përgjumjeje të gjatë. Është mëse e drejtë që më e pakta që mund të bëhet për një njeri, që ikën nga kjo botë është t'i ofrojë banesën e tij të fundit pa një luftë për të gjetur atë copë vend .

Jo vetëm kaq por qyteti ka nevojë për aktivitete, gjallëri, frymëmarrje. Një nga sfidat kryesore është pikërisht stimulimi i talenteve të reja në çdo fushë. Mund të jenë efikase konkurset e shpeshta midis shkollave apo shpërblimi i vazhdueshëm i nxënësve më të mirë si stimul për më tej, kjo sigurisht në bashkëpunim me drejtorinë arsimore .

Rinia duhet të jetë në qendër të vëmendjes së programeve bashkiake duke hapur qendra sportive apo “kafe rinore” shumëfunktionale psh: internet kafe, ambjente argëtuese sportive dhe këto kundrejt çmimeve sa më të ulta dhe vetëm për nxënësit apo studentët. Sigurisht nuk mund të harrojmë dhe moshën e tretë. Edhe për ta mund të ngrihen qendra çlodhëse. Diçka mund të bëhet edhe për gratë shtëpiake si për shembull organizimi i panairëve të ndryshme me punime dore duke i ekspozuar dhe stimuluar .

.....
 “Sikur të isha Kryetar Bashkie”...Që një lider ka qënë i aftë apo i mirë gjithmonë e ka treguar vepra që ai ka lënë.

Përsa ju përket juve Zoti kryetar, Mark Aureli ka thënë: “Mos harxhoni kohë duke biseduar se si një drejtues i mirë duhet të jetë, BËHUNI I TILLË !”

Dikensa Topi

19.

Kryetari i Bashkisë, figurë e rëndësishme dhe përfaqësuese e një qyteti por që nuk duhet të mbetet thjesht në kuadrin e një figure përfaqësuese. Pritet shumë më tepër nga ana e të përzgjedhurit me gradën më të lartë të administratës bashkiake. Një figurë politike e rëndësishme, që përderisa zgjidhet prej populli pritet që t'i shërbejë këtij të fundit. Në menyrë që veprimtaria e Kryetarit të Bashkisë të jetë efektive dhe të ketë rezultate të kënaqshme pritet që ky i fundit të plotësojë disa kushte dhe të ketë disa kritere të caktuara: Gjëja e parë që më sjell ndërmend qenia në krye të këtij pozicioni është përgjegjësi që do të ndieja mbi supe. Një pozicion i tillë kërkon sa mundim aq edhe përgjegjësi ndaj atyre që të kanë besuar votën e tyre.

Vizioni im nëse do të isha Kryetare Bashkie do të ishte për një qytet më të pastër dhe për një luftë ndaj korrupsionit.

Pikë së pari, në mënyrë që të arrija synimin tim për një qytet më të pastër, do të ishte pajisja e qytetit me sa më shumë kosha plehrash përreth tij dhe kudesit që do të ushtrohej ndaj mbledhjes së mbeturinave. Pa dyshim që në mirëmbajtjen e një qyteti të pastër rol vendimtar kanë edhe qytetarët por kjo do të vijë thjesht si një rrjedhojë e krijimit të disa kushteve të përshtatshme.

Një pikë tjetër e rëndësishme do të ishte ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, trotuareve dhe shesheve publike. Në asnjë çast si kryetare bashkie nuk do të mjaftohesha vetëm me këtë gjë sepse ndërtime të tilla kanë nevojë të mirëmbahen nga bashkia dhe të investohet shpesh herë mbi to në mënyrë që të mos arrijmë në një degradim të parakohshëm të këtyre ambjenteve.

Diçka tjetër që vlen për t'u përmendur është krijimi i kushteve për të mirëpritur rolin e qytetarëve në vendim-marrje. Qytetarët janë personat e duhur të cilët mund të tregojnë se cilat janë nevojat më imediate për tu përmbushur. Ata mund të udhëzojnë në mënyrën e duhur duke qenë më tepër në kontakt me shqetësimet më problematike. Roli i qytetarit nuk duhet mënjanuar asnjëherë sepse lidhja midis këtyre dy "pushteteve" është një lidhje e përjetshme që ka ekzistuar dhe vazhdon ende të ekzistojë, ku qeveria është për njerëzit dhe njerëzit për qeverinë. Si Kryetare Bashkie do të bëja të mundur krijimin e ambjenteve të përshtatshme për mirëpritjen e qytetarëve si dhe do të caktoja oraret për ta sepse vetëm në këtë mënyrë do të eliminoja rradhët e gjata dhe të mundimshme të popullit shqiptar. Duke vendosur oraret për pritjen e qytetarëve dhe bërjen të mundur afrimin e tyre në instancat vendim-marrëse do të krijonja një lidhje më të ngushtë midis popullit tim dhe vetes sepse një qeverisje e mirë vjen si rezultat i bashkëpunimit të disa komponentëve.

Si përfundim do të konkludoja që ato çfarë përmenda me sipër janë vetëm fillimi i një qeverisjeje të mirë sepse shumë më tepër duhet të vijë më pas dhe është e rëndësishme që çdo hap i Kryetarit të Bashkisë duhet të karakterizohet nga pastërtia, fleksibiliteti, lufta ndaj korrupsionit, përgjegjshmëria, aftësia, ndershmëria etj. Janë të pafundme cilësitë dhe virtytet të cilat duhet të posedohen nga Kryetari i Bashkisë. Të përfaqëosh besimin e qytetarëve të tu është një nismë aspak e lehtë.

Entela Kaloti

Universiteti Aleksander Xhuvani

Elbasan

20.

Të jesh kryetar bashkie është një përgjegjësi e madhe, një betejë e vështirë ku nuk luftohet vetëm, por për dhe së bashku me qytetarët.

Nëse unë do të isha kryetare bashkie do të ndërtoja një metropol të vërtetë me ndërtesa të larta në qendër dhe me vila luksoze në periferi. Do të rregulloja parqet dhe lulishtet e këtu do të më duhej të më ndihmonin qytetarët për t'i mirëmbajtur ato.

Do të ndërtoja qendra argëtimi me sporte nga më të ndryshmet, gjithashtu edhe qendra ditore për më të moshuarit.

Do të riorganizoja varrezat e qytetit dhe gjithashtu një vëmendje të veçantë do t'i kushtoja mjedisit në mënyrë të tillë që bledhja e mbeturinave të bëhej më e shpeshtë. Do të krijoja fabrika riciklimi mbeturinash dhe përmes spoteve publicitare dhe broshurave do të informohen qytetarët për t'i ndarë në të riciklueshme dhe të pariciklueshme.

Kjo mënyrë informimi nuk do të ekzistojë vetëm për këtë qëllim, por edhe për çdo vendim të marrë në mënyrë të tillë që të gjithë të jenë në dijeni se ka hyrë në fuqi. Akoma më i rëndësishëm do të ishte ky informim përmes radios dhe televizionit përpara marrjes së vendimit, kështu që qytetarët të mund ta kritikojnë dhe të japin ide të tjera.

Për të gjitha punët që do të zhvilloj, do të kërkoj mbështetjen e stafit tim. I detë nga vetë ata do të ishin të dobishme duke marrë në konsideratë faktin që ata janë specialistë dhe njerëz të përgatitur që punojnë në administratën bashkiake.

Të jesh kryetar bashkie nuk mjafton për të rregulluar gjithë këto gjëra, nuk mjafton një, dy, as dhjetë mandate dhe as një jetë. Duhet që të gjithë njerëzit të jenë pak "kryetarë bashkie", që t'i njohin dhe t'i respektojnë detyrat dhe të drejtat e tyre dhe të tjerëve.

Stela Dhima

21.

Neve na duhet një lidrshp, kemi nevojë për një vizion të ri, që tu përshtatet të gjithë qytetarëve dhe jo vetëm disa prej tyre. Kemi nevojë për drejtues të aftë, që të mbrojnë interesat e qytetarëve.

Do të jem kryebashkiakja jo e pluhurit dhe e baltës, por e sipërfaqeve të asfaltuara. Do të rikonstruktohen të gjitha blloqet e banimit nga qendra në periferi duke e bërë periferinë pjesë të qendrës. Shtrimi, zgjerimi dhe gjelbërimi i rrugëve janë ndër pikat kryesore të strategjisë sime.

Nuk do të mungojnë parqet e lojrave për fëmijët, as lulishtet e gjelbëruara për moshën e thyer.

Bashkia do të marrë nismën për të bërë decentralizimin e ujit të pijshëm duke i paraqitur kryeministrit strategjinë e saj për të shtuar më shumë orë furnizimin e banorëve me ujë të pijshëm, kjo gjë do të funksionojë në mënyrë të barabartë si për qendrën edhe periferinë.

Do të shtohen shërbimet publike, si për shembull linjat e autobusave që do të mundësojnë në lehtësimin e transportit të qytetarëve. Derdhja dhe djegja e plehrave inerte do të bëhet jashtë qytetit, në një zonë larg qendrave të banimit në mënyrë që tymi të mos shkaktojë dëme mbi popullsinë.

Do të bëhet financimi me efikasitet i fondeve të bashkisë dhe menaxhimi i mirë i taksave duke i shndërruar ato në institucione për qytetin dhe banorët e tij.

Bashkia do të promovojë një projekt, i cili përfshin mbulimin e të gjithë vendit me nje rrjet interneti pa pagesë ku qytetarët mund të navigojnë duke siguruar aksesin në informacion për 24 orë. Do t'i afrojmë gjeneratës së re atë çka ajo ka nevojë për të përballuar sfidat e së ardhmes. Do të punojmë për shndërrimin e qytetit në një metropol, për një qytet me shanse të barabarta, për një qytet ku të dobëtit të mos ndihen të pambrojtur dhe të fortët të pakontrollueshëm, për një qytet ku pushteti të jetë i qytetarëve dhe qyteti të jetë i të gjithëve.

Ka shumë punë për të bërë në Shqipëri. Nisma e bashkisë do të jetë ajo forca e vogël që do të shndërrohet në një pemë të madhe mbi të gjithë Shqipërinë.

Ardita Cakaj

Fakulteti i Shkencave Sociale

Tiranë

